

KOLANA: DOKUMENTET E KISHËS KATOLIKE

1. Karta e të Drejtave të Familjes
2. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*)
3. Kisha nga Eukaristia (*Ecclesia de Eucharistia*)
4. Rerum Novarum
5. Paqja në Tokë (*Pacem in Terris*)
6. Hyji është dashuri (*Deus caritas est*)
7. Zhvillimi i popujve (*Populorum Progressio*)
8. Besimtarët laikë të Krishtit (*Christifideles laici*)
9. Sakramenti i dashurisë (*Sacramentum Caritatis*)
10. Lufta kundër korrupsionit
11. Dashuria në të Vërtetën (*Caritas in Veritate*)
12. Dinjiteti i gruas (*Mulieris Dignitatem*)
13. Fjala e Zotit (*Verbum Domini*)
14. Dhuratë dhe Mister (*Papa Gjon Pali II*)
15. Evangelii Nuntiandi (*Papa Pali VI*)
16. Novo Millenio Ineunte (*Papa Gjon Pali II*)
17. Besoj. Koment i shkurtër i Besojmës
Apostolike (*Imzot Angelo Massafra*)
18. Lumen Fidei – Drita e Fesë (*Papa Françesku*)
19. Porosia Apostolike – Evangelii Gaudium
(*Papa Françesku*)



POROSIA APOSTOLIKE
EVANGELII GAUDIUM

E ATIT TË SHENJTË
FRANÇESKUT

DREJTUAR IPESHKVIJVE,
KLERIKËVE, RREGULLTARËVE
DHE BESIMTARËVE LAIKË
MBI SHPALLJEN E UNGJILLIT
NE BOTËN E SOTME

Përktheu nga italishtja:
Leonard DOKA

*Redaktimi, kopertina
dhe realizimi grafik:*
Ferdinand NDOCAJ

© Copyright “Ylber”

ISBN 978-9928-4219-2-0

Doli nga shtypi:
Maj, 2014

1. GËZIMI I UNGJILLIT mbush zemrën dhe tërë jetën e atyre që takohen me Jezusin. Ata, që lëshohen në shëlbimin e Tij, çlirohen nga mëkati, trishtimi, zbrazëtia e brendshme dhe vetmia. Me Jezu Krishtin gjithmonë lind dhe rilind gëzimi. Në këtë “Porosi Apostolike”, dua t’u drejtohem besimtarëve të krishterë me ftesën për një etapë të re ungjillëzuese, të shënuar prej këtij gëzimi, duke u treguar shtigje për rrugëtimin e Kishës në vitet e ardhshme.

I. NJË GËZIM PËRHERË I RI,
NJË GËZIM QË NDAHET

2. Rreziku i madh në botën e sotme të pushtuar nga konsumizmi, është vetmia dhe ankthi që lindin nga një zemër e vetëkënaqur dhe lakmitare, të ndjekurit e ethshëm të kënaqësive të kota dhe një ndërgjegje e topitur. Sa herë që jeta jonë e brendshme zihet në kurthin e interesave dhe shqetësimeve vetjake, nuk ka më vend për të tjerët, sidomos për të varfrit. Zëri i Hyjit nuk dëgjohet

më, gëzimi i qetë i dashurisë së tij nuk ndjehet më dhe dëshira për të bërë mirë shuhet. Ky është një rrezik mjaft real edhe për besimtarët. Shumë bien pre e tij dhe pushtohen nga mëria, zemërimi dhe apatia. Por në këtë mënyrë nuk mund të jetohej një jetë dinjitoze dhe e përmbushur, sepse nuk është ajo çka Hyji dëshiron për ne e as nuk është jeta në Shpirtin që e ka burimin në Zemrën e Krishtit të ringjallur.

3. Unë i ftoj të gjithë të krishterët kudo që të jenë, për një takim të ri personal me Jezus Krishtin, ose së paku që të jenë të hapur për ta lënë që t'i takojë ata. Dhe ju kërkoj që ta bëni këtë çdo ditë. Të mos mendojë askush se kjo ftesë nuk është për të, duke qenë se “asnjë nuk përjashtohet nga gëzimi që sjell Zoti”¹. Zoti nuk i zhgënjën ata që e ndërmarrin këtë rrezik; kurdoherë që bëjmë një hap ndaj Jezusit, ne e kuptojmë se ai është tashmë aty, duke na pritur me krahë hapur. Tani është çasti për t'i thënë Jezusit: “Zot, kam lejuar që të mashtrohem; e kam refuzuar aq shumë dashurinë tënde, por ja ku kam ardhur sërish për të ripërtërirë besëlidhjen time me ty. Unë kam nevojë për ty. Më shpëto përsëri o Zot, më merr edhe një herë

¹ Porosia Apostolike *Gaudate Domino* e Palit VI-të

në krahët e tu shëlbues”. Sa mirë është të kthehesh te Ai sa herë që e ke humbur rrugën! Po e them përsëri: Hyji nuk lodhet kurrë së faluri ndërsa ne jemi ata që lodhemi duke kërkuar mëshirën e tij. Krishti, i cili na ka thënë që ta falim njëritjetrin “shtatëdhjetë herë shtatë” (Mt 18,22) na jep shembullin e tij, duke na falur shtatëdhjetë herë shtatë. Ai na mban vazhdimisht mbi supet e tij. Askush nuk mund të na zhveshë nga dinjiteti që na ka dhënë Ai me anë të kësaj dashurie të pakufishme dhe të pashtershme. Me një ëmbëlsi që nuk të zhgënjën kurrë, por që është gjithnjë në gjendje për të na rikthyer gëzimin, ai bën të mundur që ne të ngremë kryet lart dhe të fillojmë nga e para. Të mos largohemi nga ringjallja e Jezusit, të mos dorëzohemi kurrë, çfarëdo që të ndodhë. Asgjë mos na frymëzoftë më shumë sesa jeta e tij që na nxit të ecim përpara!

4. Librat e Besëlidhjes së Vjetër parashikonin se gëzimi i shpëtimit do të begatonte në kohët mesianike. Profeti Isaia e përshëndet me ngazëllim Mesinë e shumëpritur: “Ti e shtove gëzimin, e madhërove harenë” (Is 9,2). Ai i nxit ata që banojnë në Sion që t'i dalin përpara me këngë: “Brohoritni e këndonin lavde” (12,6). Profeti u thotë atyre që

e kanë parë nga larg që t'ua kumtojnë lajmin të tjerëve: Ngjitu mbi një mal të lartë, ti që i sjell sihariqin Sionit; ngrije me të gjithë fuqinë zërin tënd, ti që i sjell sihariqin Jeruzalemit!" (40,9). Mbarë krijimi merr pjesë në gëzimin e shpëtimit: "Gëzo, o qiell, galdo, o tokë, lavde, o male, ju këndon, sepse Zoti po e ngushëllon popullin e vet, po ka mëshirë për varfanjakët e vet!" (49,13). Zakaria, duke vështruar ditën e Zotit, e fton popullin që ta shpallin mbretin që vjen "i përvuajtur e në shpinë të gomarit": "Gëzo me gjithë shpirt, Bija e Sionit, galdo, Bija e Jeruzalemit! ja, mbreti yt, po vjen te ti: është i drejtë e Shpëtimtar" (Zak 9,9). Ftesa më ngazëlluese është ndoshta ajo e profetit Sofonia, që ia paraqet popullit Hyjin ndërsa po feston me harenë e shpëtimit. Mahnitem sa herë që e lexoj këtë tekst: "Në mesin tënd është Zoti, Hyji yt, trim mbi trima Shpëtimtar! Do të galdojë për ty hareshëm, i përmalluar nga dashuria, do të kërcejë për ty me gëzim porsi në ditë feste" (Sof 3,17,18). Ky është gëzimi që provojmë për çdo ditë, në mes të gjërave të rëndomta të jetës, në përgjigje të ftesës plot dashuri të Hyjit Atit tonë: "Biro, nëse ke, mos e lër veten keq... Mos ia moho vetes një ditë të lume" (Sir 14,11,14). Ç'dashuri e ëmbël atërore jehon në këto fjalë!

5. Ungjilli, ku rrezaton lavdishëm Kryqi i Krishtit, na fton vazhdimisht që të gëzohemi. Disa shembuj do të na mjaftojnë. "Gëzohu!" është përsëritja që i bën engjëlli Marisë (Lk 1,28). Vizita e Marisë te Elizabeta bën që Gjoni të kërcejë nga gëzimi në barkun e nënës së tij (krh. Lk 1,41). Në këngën e saj të lavdërimit, Maria shpall: "shpirti im me hare i brohorit Hyjit, Shëlbuesit tim" (Lk 1,47). Kur Jezusi filloi shërbesën e tij, Gjoni thërret: "I tillë është, pra, gëzimi im: arriti në kulm!" (Gjn 3,29). "Atëherë Jezusi, nën ndikimin e Shpirtit Shenjt, klithi plot hare" (Lk 10,21). Mesazhi i tij na gëzon: "Jua thashë këto, që gëzimi im të jetë në ju e gëzimi juaj të jetë i plotë" (Gjn 15,11). Gëzimi ynë i krishterë pi nga burimi i zemrës së tij të mbushur plot. Ai u premtonte dishepujve: "ju do të qani e do të vajtoni e bota do të gëzojë" (Gjn 16,20). Pastaj thotë: "por unë prapë do të vij t'ju shoh e zemra juaj do të galdojë" (Gjn 16,22). Dishepujt "u gëzuan" (Gjn 20,20) kur panë Krishtin e ringjallur. Te Veprat e Apostujve lexojmë se të krishterët e "ndanin bukën dhe me hare e me thjeshtësi" (2,46). Kudo që shkonin dishepujt "kishte gëzim të madh" (8,8); edhe në mes të përndjekjeve "ishin të mbushur me gëzim" (13,52). Eunuku i sapo pagëzuar "Ai e vazhdoi rrugën e vet me gëzim"

(8,39), ndërsa roja i burgut me “të gjithë anëtarët e familjes u gëzua që kishte besuar në Hyjin” (16,34). Përse të mos hyjmë edhe ne në këtë lumë gëzimi?

6. Ka disa të krishterë jeta e të cilëve duket si një stil Kreshme pa Pashkët. Unë e kuptoj sigurisht që gëzimi nuk shprehet njësoj në çdo kohë të jetës, sidomos në çastet shumë të vështira. Gëzimi përshtatet dhe ndryshon por reziston gjithnjë, ashtu si një rreze drite që buron nga siguria jonë personale e të qenit pa masë të dashur dhe pa asnjë kusht. Unë i kuptoj personat që prirën ndaj trishtimit për shkak të vështirësive serioze që duhet të durojnë, megjithatë pak nga pak ne duhet ta lëmë gëzimin e fesë që të gjallërohet, si një besim i fshehtë por i fortë, edhe në mes të shqetësimeve më të mëdha: “Shpirti im më s’di ç’është paqja, më nuk di ç’është lumturia...Ja, se çka përbluaj në zemër e prandaj më ngjallet shpresa: Çdo mëngjes Ai i përtërin! Besa jote s’ka kufi!... Është mirë të pritet në heshtje shëlbimi që vjen prej Zotit” (Vaj 3,17, 21-23, 26).

7. Shpesh ne tundohemi që të shfajësohemi dhe të ankohemi, duke vepruar sikurse të ishim të lum-

tur vetëm në disa kushte të caktuara. Kjo ndodh sepse “shoqëria jonë teknologjike vërtet që ia ka dalë mbanë të shtojë rastet e kënaqësisë, por nuk ka mundur dot që të gjejë gëzimin e vërtetë”². Unë mund të them se shprehjet më të bukura dhe të natyrshme që kam parë në jetën time kanë qenë ato të atyre njerëzve të varfër, të cilët kanë zotëruar shumë pak gjëra. Më vjen ndër mend gjithashtu edhe gëzimi i mirëfilltë që kam parë tek disa njerëz, të cilët edhe në mes të detyrimeve të mëdha profesionale, kanë qenë në gjendje të ruajnë me thjeshtësi një zemër plot besim. Në mënyra të ndryshme, të gjitha këto gëzime burojnë nga dashuria e pafund e Hyjit, i cili na është shfaqur në Jezu Krishtin. Unë nuk lodhem kurrë së përsërituri këto fjalë të Benediktit të XVI-të, të cilat na shpien te vetë thelbi i Ungjillit: “të jesh i Krishterë nuk është rezultat i një zgjedhjeje etike ose i një ideje të lartë, por të përballurit me një ngjarje, me një Person, që i jep jetës një horizont të ri dhe një drejtim vendimtar”³.

8. Vetëm falë këtij takimi, apo më mirë të themi ripërballje me dashurinë e Hyjit që shndërrohet

² *Ibid*, 8: AAS67 (1975), 292

³ *Leter enc. Deus caritas est* (25 dhjetor 2005) 1: AAS98 (2006), 217

në një miqësi të begatë, ne arrijmë të çlirohemi nga ndërgjegjja jonë e izoluar dhe nga vetë-fokusimi. Ne bëhemi krejt njerëzorë kur bëhemi më shumë se njerëzorë, kur e lëmë Hyjin që të na sjellë përtej vetes, me qëllim që të arrijmë të vërtetën e plotë të qenies sonë. Këtu ne gjejmë burimin dhe frymëzimin e të gjitha përpjekjeve në ungjillëzim. Sepse nëse e kemi marrë dashurinë që i kthen kuptimin jetëve tona, si atëherë nuk do ta ndajmë këtë dashuri me të tjerët?

II. GËZIMI I ËMBËL E LEHTËSUES I UNGJILLËZIMIT

9. Mirësia gjithnjë priret që të përhapet. Çdo përvojë autentike e së vërtetës dhe bukurisë kërkon në vetvete që të rritet brenda nesh dhe çdo person që ka përjetuar një çlirim të thellë bëhet më i ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve. Me këtë rritje apo shtrirje, kjo mirësi rrënjësohet më shumë dhe zhvillohet. Për këtë arsye, kush dëshiron që të jetojë me dinjitet e plotësi, nuk ka rrugë tjetër përveçse të pranojë tjetrin dhe të kërkojë të mirën e tij. Nuk duhet të na habisin disa thënie të Shën Palit: “Sepse dashuria e Krishtit na nxit kur mendojmë se: Njëri vdiq për të gjithë, prandaj, të

gjithë vdiqën” (2 Kor 5,14); “i mjeri unë nëse nuk e predikoj Ungjillin! (1 Kor 9,16).

10. Propozimi është që të jetojmë në një nivel më të lartë, por jo me më pak intensitet. “Jeta forcohet duke u dhënë por dobësohet kur jetohet në izolim dhe në rehati. Në fakt, ata që shfrytëzojnë më shumë mundësitë e jetës, janë ata që e lenë sigurinë vetjake dhe entuziazmohen pas misionit të përcjelljes së jetës tek të tjerët”⁴. Kur Kisha i thërret të Krishterët që të ndërmarrin zotimin e ungjillëzimit, ajo nuk bën gjë tjetër veçse u tregon atyre dinamizmin e përmbushjes personale: “Këtu ne zbulojmë një ligj tjetër të thellë të realitetit: jeta rritet dhe piqet në atë masë që e japim për jetën e të tjerëve. Por ky është në fund të fundit misioni”⁵. Si pasojë, një ungjillëzues nuk duhet të ketë kurrë fytyrën e dikujt që sapo është kthyer nga varrimi. Le ta restaurojmë dhe thellojmë entuziazmin tonë, atë “gëzim të ëmbël dhe ngushëllues të ungjillëzimit, edhe atëherë kur na duhet të mbjellim me lot... Le ta marrë bota e sotme që është në kërkim, herë me shqetësim e

⁴ Konferenca V e përgjithshme e Ipeshkvisë latinoamerikane dhe asaj të Karaibeve, *Dokumenti i Aparecidos* (31 maj 2007), 360

⁵ *Ibid.*

herë me shpresë lajmin e mirë jo nga ungjillëzues që janë të shkurajuar, të trishtuar, të padurueshëm apo të shqetësuar, por nga shërbyesit e Ungjillit, jeta e të cilëve rrëzëllen ngrohtësi, ata që janë të parët që kanë marrë gëzimin e Krishtit”⁶.

Një risi e përjetshme

11. Një shpallje e re u ofron besimtarëve, ashtu si dhe atyre që janë të vakët dhe që nuk e praktikojnë besimin, një gëzim të ri në fe dhe një frytshmëri në shërbesën ungjillëzuese. Thelbi i mesazhit do të jetë gjithnjë po ai: Hyji i cili e ka zbuluar dashurinë e tij të pakufishme në Krishtin e kryqëzuar dhe të ringjallur. Zoti i ripërtërin gjithnjë besnikët e tij, çfarëdo moshe që të kenë: “kurse ata që shpresojnë në Zotin, përtëriten në fuqi, marrin krahë porsi shqiponja, vrapojnë e nuk lodhen kurrë, ecin edhe kurrë nuk meken” (Is 40,31). Krishti është “Ungjilli i përjetshëm” (Zb 14,6), dhe është “i njëjtë dje e sot dhe do të jetë për amshim” (He 13,8), por pasuritë e bukuria e tij janë të pashtershme. Ai është përgjithnjë i ri dhe një burim i vazhdueshëm risie. Kisha nuk pushon

⁶ Pali VI, Esort.ap. *Evangeli nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 80: AAS 68 (1976), 75.

së mahnituri me “thellësinë e pasurisë, e urtisë dhe e dijes së Hyjit!” (Rom 11,33). Shën Gjoni i Kryqit thotë që “urtësia dhe dija e Hyjit është aq e thellë dhe aq e gjerë saqë një shpirt, sado që të ketë marrë prej saj, mund të depërtojë ende në thellësitë e saj”⁷. Ose siç shkruan Shën Ireneu: “Me ardhjen e tij, Krishti solli me vete tërë risinë”⁸. Me këtë risi Ai është në gjendje që të rinovojë pareshtur jetët e bashkësitë tona dhe nëse mesazhi i Krishterë do të kalojë përmes errësirës dhe dobësive brenda kishës, ai nuk do të vjetrohët kurrë. Jezusi mund t’i thyejë kategoritë monotone në të cilat duam ta burgosim dhe na mahnit me larminë tij krijuese hyjnore. Sa herë që përpiqemi të kthehemi te burimi dhe të rigjejmë freskinë e parë të Ungjillit, do të na dalin shtigje të reja, metoda të larmishme, me forma të ndryshme të shprehuri, shenja më shprehëse e fjalë që mbartin një domethënie të re për botën aktuale. Në realitet, çdo veprim i mirëfilltë ungjillëzues është gjithnjë “i ri”.

12. Megjithëse është e vërtetë që ky mision kërkon një impenjim bujar nga ana jonë, do të ishte e

⁷ *Kantiku shpirtëror*, 36,10

⁸ *Adversus haereses*, IV, c.34. n.1: PG 7 pars prior, 1083: “Om-nem novitatem attulit, semetipsum afferens”.

gabuar që ta shikonim si një ndërmarrje personale heroike, pasi është para së gjithash vepër e Zotit, që e tejkalon çdo gjë që mund të zbulojmë e perceptojmë. Jezusi është “ungjillëzuesi i parë dhe më i madhi”⁹. Në çdo veprimtari ungjillëzuese, përparësia i takon gjithnjë Hyjit, që na ka thirrur të bashkëpunojmë me të dhe na nxit me anë të fuqisë së Shpirtit. Risia e vërtetë është ajo që e sjell vetë Hyji në mënyrë të mistershme dhe të cilën e frymëzon, e provokon, e drejton dhe e shoqëron në njëmijë mënyra. Kisha duhet të shfaqë qartë në jetën e saj që është Hyji Ai që e merr iniciativën, që “Ai na deshi më parë” (1 Gjn 4,19) dhe që “vetëm Hyji e sjell rritjen” (1 Kor 3,7). Kjo bindje na aftëson që të ruajmë një shpirt ngazëllues edhe në mes të një detyre serioze dhe sfiduese që na e merr tërë jetën tonë. Hyji kërkon gjithçka prej nesh, por në të njëjtën kohë, ai na ofron gjithçka.

13. Por as nuk duhet ta shohim risinë e këtij misioni si një farë çrrënjosjeje, apo harrese të historisë së gjallë që na rrethon dhe na shpie përpara. Kujtesa është një përmasë e besimit tonë që mund ta quajmë “deuteronomike”, njësoj me

⁹ Pali VI, *Esort, ap. Evnagelii nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 7: AAS 68 (1976), 9.

kujtesën e vetë Izraelit. Jezusi na e lë Eukaristinë si përkujtimin e përditshëm të Kishës që të shpie gjithnjë e më shumë te Pashka (krh. Lk 22,19). Gëzimi i ungjillëzimit buron gjithnjë nga kujtesa mirënjohëse: ai është një hir që duhet ta kërkojmë vazhdimisht. Apostujt nuk e harronin kurrë çastin kur Jezusi u preku zemrën: “Ishte rreth orës dhjetë” [që është ora katër e pasdites] (Gjn 1,39). Së bashku me Jezusin kjo kujtesë na paraqet një “re kaq të madhe dëshmitarësh” (Heb 12,1), disa prej të cilëve ne i kujtojmë me gëzim të madh: “Mos i harroni eprorët tuaj, të cilët e shpallën Fjalën e Hyjit: vëreni mbarimin e jetës së tyre e ndiqni fenë e tyre!” (Heb 13,7).

Ngandonjëherë bëhet fjalë për persona të thjeshtë e të afërt që na kanë njohur me jetën e besimit: “Kujtoj fenë e çiltër që është në ty, që më parë ishte në gjyshen tënde Loidën dhe në nënën tënde Eunikën” (2 Tim 1,5). Besimtari është në thelb “një person që kujton”.

III. UNGJILLËZIMI I RI PËR PËRCJELLJEN E FESË

14. Në dëgjim të Shpirtit, që na ndihmon për të lexuar si bashkësi shenjat e kohës, nga 7 deri më

28 tetor 2012 u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Sinodit të Ipeshkvijve për të trajtuar temën: *Ungjillëzimi i Ri për përcjelljen e Fesë së Krishterë*. Sinodi e ripohoi faktin që ungjillëzimi i ri është një thirrje që u drejtohet të gjithëve dhe që realizohet në tre sfera kryesore¹⁰. Së pari po përmendim sferën e shërbesës së zakonshme baritore, e cila “merr jetë nga zjarri i Shpirtit, duke ndezur zemrat e besimtarëve që marrin pjesë rregullisht në adhurimin e bashkësisë duke u mbledhur ditën e Zotit për t’u ushqyer nga Fjala e tij dhe buka e jetës së amshuar”¹¹. Këtu mund të përfshihen edhe ata besimtarë që ruajnë një fe të thellë e të singertë, duke e shprehur atë në mënyra të ndryshme, ndonëse marrin pjesë rrallë në adhurim. Kjo shërbesë e zakonshme baritore përpiket që të ndihmojë besimtarët për t’u rritur shpirtërisht, me qëllim që t’i përgjigjen dashurisë së Hyjit me gjithë jetën e tyre.

Së dyti, kujtojmë sferën e “të pagëzuarve që nuk jetojnë ashtu siç e kërkon Ungjilli”¹², të cilëve u

¹⁰ Shih *Propositio* 7.

¹¹ Benedikti XVI, *Homelia në Meshën e Shenjtë në përfundim të Asamblesë së XIII të Përgjithshme të Sinodit të ipeshkvijve* (28 tetor 2012): AAS 104 (2012), 890

¹² *Ibid.*

mungon një marrëdhënie kuptimplote me Kishën dhe nuk e përjetojnë më ngushëllimin që lind nga feja. Kisha, si një nënë gjithnjë e dhembshur, i ndihmon që të përjetojnë një kthim i cili do t’u rikthejë gëzimin e besimit në zemrat e tyre dhe do t’i frymëzojë që t’i përkushtohen Ungjillit.

Së fundi, të mos harrojmë se ungjillëzimi është i lidhur më së shumti me predikimin e Ungjillit *ndaj atyre që nuk e njohin Jezu Krishtin ose që e kanë mohuar atë gjithnjë*. Shumë prej tyre e kërkojnë qetësisht Hyjin, të shtyrë nga një dëshirë e fortë për të parë fytyrën e tij, edhe në vendet me traditë të lashtë të krishterë. Të gjithë kanë të drejtë që ta marrin Ungjillin. Ndërsa të krishterët e kanë për detyrë që ta shpallin Ungjillin pa përjashtuar askënd, jo si ai që u imponon njerëzve një detyrim të ri, si ai që dëshiron të bashkëndajë një gëzim, duke tre-guar një horizont të mrekullueshëm, apo si ai që i fton të tjerët në një banket të këndshëm. Kisha nuk rritet me prozelitizëm por duke “tërhequr apo joshur njerëzit”¹³.

¹³ Benedikti XVI, *Homelia në Meshën e Shenjtë me rastin e përu-rimit të Konferencës së V të Përgjithshme të Ipeshkvisë latinoameri-kanë dhe të Karaibeve pranë Shenjtërores “La Aparecida”* (13 maj 2007), AAS 99 (2007), 437.

15. Gjon Pali II-të na ka ftuar që të pranojmë se “nuk duhet humbur shtysa për t’u shpallur Ungjillin” atyre që janë larg prej Krishtit “sepse kjo është detyra kryesore e Kishës”¹⁴. Vepërtaria misionare “paraqet edhe sot *sfidën më të madhe* për Kishën”¹⁵ dhe “detyra misionare duhet të jetë e para”¹⁶. Çfarë do të ndodhte nëse do t’i merrnim seriozisht këto fjalë? Ne do ta kuptonim se misioni ungjillëzues është *modeli i çdo veprë të Kishës*. Po në këtë linjë, ipeshkvijtë latinoamerikanë kanë pohuar se “ne nuk mund të rrimë më të qetë, duke ndenjur pasivë në ndërtesat tona të kishës”¹⁷; dhe se është e nevojshme që të kalojmë “nga një shërbesë baritore që kërkon thjesht të ruajë status kuon në një shërbesë baritore misionare”¹⁸. Kjo detyrë vazhdon të jetë burim gëzimesh të pakufishme për Kishën: “në qiell do të ketë po kështu më shumë gëzim për një mëkatar që pendohet e kthehet se për nëntëdhjetenëntë të drejtë, që s’kanë nevojë të kthehen” (Lk 15,7).

¹⁴ Let. enc. *Redemptoris mission* (7 dhjetor 1990), 34: AAS 83 (1991), 280.

¹⁵ *Ibid*, 40: AAS 83 (1991), 287.

¹⁶ *Ibid*, 86: AAS 83 (1991), 333.

¹⁷ Konferenca V e përgjithshme e Ipeshkvisë latinoamerikane dhe të Karaibeve, *Dokumenti i Aparecidës* (31 maj 2007), 548.

¹⁸ *Ibid*, 370

Pikësnyimi dhe kufizimet e kësaj nxitjeje

16. E kam pranuar me kënaqësi ftesën e etërve sinodalë për ta shkruar këtë Porosi¹⁹. Duke e bërë këtë, mbledh frytet e punimeve të Sinodit. Jam konsultuar edhe me persona të ndryshëm dhe synoj që të shpreh preokupimin tim mbi këtë kapitull të veçantë të shërbesës ungjillëzuese të Kishës. Çështje të panumërta që kanë të bëjnë me ungjillëzimin në ditët e sotme mund të trajtohen këtu, por kam vendosur që të mos i trajtoj me hollësi ato çështje që kërkojnë reflektim dhe studim të mëtejshëm. As nuk besoj se duhet pritur që magjisteri papnor të ofrojë një fjalë të plotë apo përfundimtare për çdo çështje që ka të bëjë me Kishën dhe botën. Nuk është e këshillueshme që Papa të zërë vendin e ipeshkvijve lokalë në dallimin e çdo çështjeje që dalin në territorin e tyre. Në këtë drejtim, jam i vetëdijshëm për nevojën për të promovuar një “decentralizim” të shëndoshë.

17. Këtu kam zgjedhur që të paraqes disa direktiva të cilat mund të nxisin e udhëheqin tërë Kishën në një fazë të re ungjillëzimi, plot entuziazëm

¹⁹ Shih *Propositio* 1.

dhe dinamizëm. Në këtë kontekst dhe në bazë të mësimit të Kushtetutës dogmatike *Lumen gentium*, kam vendosur që përveç temave të tjera, të trajtoj gjerësisht këto çështje të mëposhtme:

- a) reformën e Kishës në shërbesën e saj misionare;
- b) tundimet që ndeshin punëtorët baritorë;
- c) Kishën, e nënkuptuar si mbarë Populli i Hyjit që ungjillëzon;
- d) homelinë dhe përgatitjen e saj;
- e) përfshirjen e të varfërve në shoqëri;
- f) paqen dhe dialogun brenda shoqërisë;
- g) motivimet për misionin.

18. Unë i kam trajtuar me hollësi këto çështje, madje deri aty sa mund të duket edhe e tepruar. Por e kam bërë këtë jo me qëllimin për të shkruar një libër por thjesht për të treguar pasojat serioze që kanë për misionin e sotëm të Kishës. Të gjitha këto ndihmojnë në formimin e një stili të veçantë ungjillëzimi, të cilin ju ftoj ta përdorni në çdo veprimtari që do të ndërmerreni. Në këtë mënyrë ne mund ta zbatojmë në punët e përditshme porosinë e Fjalës së Hyjit: “Gëzohuni gjithnjë te Zoti, përsëri po ju them, gëzohuni!” (Fil 4,4).

KREU I

SHNDËRRIMI MISIONAR I KISHËS

19. Ungjillëzimi kryhet në bindje ndaj mandatit misionar të Jezusit: “Prandaj, shkoni e bëjini nxënës të mi të gjithë popujt! Pagëzoni në Emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt!²⁰ Mësojini të zbatojnë gjithçka ju kam urdhëruar! Dhe, ja, unë jam me ju gjithmonë - deri në të sosur të botës!” (Mt 28,19-20). Në këta vargje shohim sesi Krishti i ringjallur i ka dërguar pasuesit e Tij për të predikuar Ungjillin në çdo kohë dhe vend, në mënyrë që besimi në Të, të mund të përhapet në çdo skaj të tokës.

I. NJË KISHË QË DEL NËPËR BOTË

20. Fjala e Hyjit na tregon vazhdimisht sesi i nxit Hyji ata që besojnë në Të për “të dalë nëpër botë”. Abrahami e pranoi thirrjen që të nisej drejt një toke të re (krh. Zan 12,1-3). Moisiu e dëgjoi thirrjen e Hyjit: “eja se dua të të çoj” (Dal 3,10) dhe e nxori popullin drejt tokës së premtuar (krh. edhe Dal 3,17). Kurse Jeremisë i tha: “shko te të gjithë ata që do të të dërgoj” (Jer 1,7). Sot,

urdhërimi i Jezusit për të “shkuar e për të bërë nxënës” na thërret që të marrim pjesë të gjithë në këtë “shërbesë” të re misionare, që përfshin skenarët e përditshëm e sfidat e reja ndaj misionit të Kishës për të ungjillëzuar. Çdo i krishterë dhe çdo bashkësi duhet të dallojë rrugën që kërkon Zoti, por ne të gjithëve na kërkohet që ta pranojmë këtë thirrje, pra që të dalim nga rehatia jonë për të shkuar te të gjitha periferitë që kanë nevojë për dritën e Ungjillit.

21. Gëzimi i Ungjillit që e mbush jetën e bashkësisë së dishepujve është një gëzim misionar. Këtë e provuan shtatëdhjetë e dy dishepujt kur u kthyen nga misioni i tyre plot me gëzim (krh. Lk 10,17). Jezusi e ndjeu atë kur u gëzua në Shpirtin e Shenjtë dhe e lavdëroi Atin që iu zbulua të varfërve dhe të vegjëlve (krh. edhe Lk 10,21). U ndje nga të kthyerit e parë që mrekulloheshin duke dëgjuar apostujt të predikonin “në gjuhën e vet” (Vap 2,6) ditën e Rrëshajave. Ky gëzim është një shenjë që tregon se Ungjilli është shpallur dhe po jep fryte. Megjithatë shtytja për të dalë nga vetja e për të dhënë, për të ecur përpara duke mbjellë farën e mirë mbetet gjithnjë e pranishme. Zoti thotë: “Ejani të shkojmë gjetiu, në fshatrat e afërme që

të predikoj edhe atje. Prandaj edhe erdha” (Mk 1,38). Pasi fara të jetë mbjellë në një vend, Jezusi nuk qëndron më aty për të shpjeguar më shumë apo për të kryer më shumë shenja, por Shpirti e shtyn që të shkojë në fshatra të tjerë.

22. Fjala e Zotit është e paparashikueshme në fuqinë e vet. Ungjilli flet për një farë që pasi është mbjellë, rritet në vetvete edhe kur bujku fle (krh. Mk 4,26-29). Kisha duhet ta pranojë këtë liri të papërmbajtshme të Fjalës që përmbush atë çka do, në mënyra aq të larmishme, sa na befasojnë.

23. Intimiteti i Kishës me Jezusin është pjesë e një udhëtimi të përbashkët. “*Bashkësia dhe misioni janë të ndërlidhura ngushtë*”²⁰. Në besnikëri ndaj shembullit të Zotërisë, është mjaft e rëndësishme që Kisha sot të dalë dhe t’u predikojë Ungjillin të gjithëve, në çdo vend, në çdo rast, pa asnjë ngurrim e frikë. Gëzimi i Ungjillit është për të gjithë njerëzit, askush nuk përjashtohet. Këtë ua shpalli engjëlli barinjve në Betlehem: “Mos kini frikë! Ja, unë po ju sjell një lajm të mirë: gëzim të madh për mbarë popullin!” (Lk 2,10). Libri i Zbulesës flet për

²⁰ Gjon Pali II, Esort, ap. postsinodale Christifideles laici (30 dhjetor 1988), 32:AAS 81 (1989), 451.

“Ungjillin e amshuar që do t’u kumtohej banorëve të tokës: të çdo kombi, të çdo fisi, të çdo gjuhe dhe të çdo populli” (Zb 14,6).

*Të marrësh iniciativën, të përfshihesh,
të jesh përkrahës, të japësh fryte dhe të gëzohesh.*

24. Kisha “që del” është një bashkësi nxënësish misionarë që e marrin hapin e parë, përfshihen dhe janë përkrahës, japin fryte dhe gëzohen. “*Primerear* – të marrësh iniciativën”: do të më falni për këtë neologjizëm. Një bashkësi ungjillëzuese e di që Zoti e ka marrë iniciativën, duke na dashur i pari (krh. 1 Gjn 4,19) dhe prandaj ne mund të marrim iniciativën me kurajë, të shkojmë te të tjerët, të kërkojmë ata që janë rrëzuar, të qëndrojmë në udhëkryqe dhe të mirëpresim të përjashtuarit. Një bashkësi e tillë ka një dëshirë të pashtershme për të treguar mëshirë, çka është fryt i përvojës së mëshirës së pafund të Zotit. Le të përpiqemi edhe më shumë që ta ndërmarrim hapin e parë dhe të përfshihemi. Jezusi u lau këmbët dishepujve të tij. Zoti përfshihet vetë dhe i përfshin të vetët, duke ualuar këmbët. Ai iu thotë nxënësve të tij: “të lumët ju nëse edhe do t’i zbatoni!” (Gjn 13,17). Një bashkësi ungjillëzuese përfshihet me fjalë e vepër në jetën

e përditshme të njerëzve, ajo shkurton largësitë, është e gatshme që të poshtërohet nëse është e nevojshme dhe e përqafton jetën njerëzore, duke prekur trupin e përvuajtur të Krishtit tek të tjerët. Prandaj ungjillëzuesit mbajnë “aromën e deleve”, ndërsa delet janë të gatshme që të dëgjojnë zërin e tyre. Një bashkësi ungjillëzuese është gjithashtu përkrahëse, duke i qëndruar pranë Ajo i njeh mirë pritjet e gjata dhe durimin apostolik. Ungjillëzimi e praktikon shumë durimin dhe nuk e përfill kohën. Besnike ndaj dhuratave të Zotit, ajo jep shumë fryte. Bashkësia ungjillëzuese i jep rëndësi dhënies së fryteve sepse Zoti ia kërkon. Ajo kujdeset për grurin dhe nuk e humb qetësinë apo durimin me barërat e këqija. Farëdhësi, kur shikon egjërën në mes të grurit nuk ankohet e as nuk alarmohet, por e gjen mënyrën që Fjala të mishërohet në një situatë të veçantë dhe të japë frytet e jetës së re, sado që mund të duken gjysmake apo me të meta. Dishepulli di sesi ta ofrojë krejtësisht jetën e tij, deri dhe në martirizim, si dëshmi të Jezu Krishtit por megjithatë ai nuk synon që të bëjë armiq por ta shohë Fjalën e Zotit të pranuar dhe të zbulohet fuqia e saj çliruese dhe ripërtëritëse. Dhe së fundi bashkësia ungjillëzuese është e mbushur me gëzim dhe di sesi të gëzohet në çdo kohë. Ajo e feston

çdo fitore të vogël, çdo hap përpara në shërbesën e ungjillëzimit. Ungjillëzimi i gëzueshëm kthehet në një liturgji të bukur, si pjesë e preokupimit tonë për të përhapur mirësinë. Kisha ungjillëzon dhe ungjillëzohet përmes bukurisë së liturgjisë që është si një kremtim i detyrës së ungjillëzimit ashtu edhe burimi i shtytjes së vazhdueshme për të dhënë.

II. VEPRIMTARIA BARITORE DHE KTHIMI

25. Unë nuk e shpërfill faktin që sot dokumentet s'ngjallin të njëjtin interesim si në të kaluarën dhe ato harrohen shpejt. Megjithatë unë dua të theksoj se ajo çka dua të shpreh ka një domethënie programuese dhe pasoja të rëndësishme. Unë shpresoj se të gjitha bashkësitë do ta marrin mundimin që të bëjnë çmos me të gjitha mjetet e nevojshme për të përparuar në ecjen e një kthimi baritor dhe misionar që nuk mund t'i lërë gjërat ashtu siç janë. "Administrimi i thjeshtë"²¹ nuk mjafton. Le të jemi në mbarë botën "në një gjendje të vazhdueshme misioni"²².

²¹ Konferenca V e Përgjithshme e ipeshkvinjve amerikanolatine dhe të Karaibeve, *Dokumenti i Aparecidës* (31 maj 2007), 201.

²² *Ibid*, 551.

26. Pali i VI-të na ka ftuar që të zgjerojmë thirrjen ndaj ripërtëritjes, për ta shprehur me forcë se ripërtëritja nuk ka të bëjë vetëm me individë por me tërë Kishën. Le të kthehemi te ky tekst i paharrueshëm që vazhdon të na sfidojë. "Kisha duhet të shikojë me sy depërtues brenda vetes dhe të meditojë mbi misterin e qenies së saj [...] Kjo vetëdije e gjallë të çon patjetër në një krahasim midis imazhit ideal të Kishës ashtu siç e ka parë dhe e ka dashur Krishti, si nusen e tij të shenjtë e të panjollë (krh. Ef 5,27) dhe imazhin aktual që Kisha i paraqet sot botës [...] Nga kjo vetëdije buron një nevojë e madhe për ripërtëritje, për korrigjimin e të metave të cilat ia nxjerr në pah dhe i dënon vetë-shqyrtimi i saj, duke reflektuar modelin e tyre, Krishtin²³. Koncili i II-të i Vatikanit e ka paraqitur kthimin kishtar si një hapje ndaj një vetëripërtëritjeje të vazhdueshme që buron nga besnikëria ndaj Jezu Krishtit: "Çdo ripërtëritje e Kishës konsiston në thelb në një rritje të besnikërisë ndaj thirrjes së saj [...] Krishti e thërret Kishën shtegtare ndaj atij reformimi të vazhdueshëm, i cili i nevojitet asaj vazhdimisht, si një institucion

²³ Pali VI, Let. enc. *Ecclesiam suam* (6 gushtto 1964), 10: AAS 56 (1964), 611-612.

njerëzor që është ndërsa është këtu në tokë”²⁴. Ka struktura kishtare që mund t’i pengojnë përpjekjet ungjillëzuese, megjithatë edhe strukturat e vjetra janë të dobishme vetëm kur kanë një jetë që i ushqen, i mban dhe i vlerëson. Pa jetë të re dhe një shpirt të mirëfilltë ungjillor, pa “besnikërinë e Kishës ndaj thirrjes së saj”, çdo strukturë e re do të rezultojë jo efektive brenda një kohe të shkurtër.

Një ripërtëritje kishtare që nuk mund të shtyhet

27. Unë ëndërroj për një zgjedhje misionare që është në gjendje të shndërrojë gjithçka, në mënyrë që zakonet, stilet, oraret, gjuha dhe strukturat kishtare të kthehen në një mjet të përshtatshëm më shumë për ungjillëzimin e botës së sotme sesa për vetëruajtje. Ripërtëritja e strukturave që kërkon kthimi baritor mund të kuptohet vetëm në këtë dritë: si një pjesë e një përpjekjeje për t’i bërë më shumë misionare, në mënyrë që veprimtaria e zakonshme baritore të jetë më shumë përfshirëse dhe e hapur, për të frymëzuar tek punëtorët baritorë një dëshirë të vazhdueshme për të vazhduar përpara dhe për të nxjerrë kështu një

²⁴ CONC. ECUM. Vat. II, Dekreti mbi ekumenizmin Unitatis redintegratio, 6

përgjigje pozitive nga tërë ata të cilëve Jezusi u ofron miqësinë e tij. Siç iu tha Gjon Pali II-të një herë ipeshkvijve të Oqeanisë: “çdo ripërtëritje në Kishë duhet ta ketë misionin si pikësynim në mënyrë që të mos bjerë pre e ndonjë imponimi nga ana e kishës”²⁵.

28. Famullia nuk është një institucion i vjetruar; pikërisht sepse ka një elasticitet të madh, mund të marrë forma të ndryshme në vartësi të gatishmërisë dhe krijueshmërisë misionare të baritores e bashkësisë. Megjithëse sigurisht nuk është i vetmi institucion që ungjillëzon, nëse famullia rezulton e aftë për vetëripërtëritje dhe përshtatshmëri të vazhdueshme, ajo vazhdon të jetë “Kisha që jeton në mes të shtëpive të bijve e bijave të saj”²⁶. Kjo supozon që është në kontakt real me familjet dhe jetët e pjesëtarëve të saj dhe nuk kthehet në një strukturë të padobishme e të ndarë nga njerëzit ose një grup i mbyllur i disa të zgjedhurve. Famullia është prania e Kishës në një territor të caktuar, një mjedis që shërben për të dëgjuar Fjalën e Zotit, për rritje në jetën e krishterë, për dialog, shpallje,

²⁵ Gjon Pali II, Esort. ap. Postsinodale Ecclesia in Oceania (22 nëntor 2001), 19: AAS 94 (2002), 390.

²⁶ Gjon Pali II, Esort. ap. postsinodale Christifideles laici (30 dhjetor 1988), 26: AAS 81 (1989), 438.

shërbesa bamirëse, adhurim dhe kremtim²⁷. Në të gjitha veprimtaritë e veta, famullia i nxit dhe stërvit pjesëtarët e saj që të jenë ungjillëzues²⁸. Ajo është një bashkësi bashkësish, një shenjtërore ku të eturit vijnë për të pirë në mes të udhëtimit të tyre dhe një qendër shërbesash misionare të vazhdueshme. Megjithatë ne duhet ta pranojmë që thirrja për të rishikuar dhe ripërtërirë famullitë tona nuk ka qenë e mjaftueshme për t'i afruar më shumë me njerëzit, që të bëhen vende bashkësie të gjallë dhe pjesëmarrjeje dhe të priren ndaj misionit.

29. Institucione të tjera të Kishës, komunitete të mëdha e të vogla, lëvizje e forma të tjera shoqërimi janë një pasuri për Kishën, që Shpirti i përdor për të ungjillëzuar vende dhe rajone të ndryshme. Ato sjellin shpesh një zell të ri ungjillëzues dhe një aftësi të re për dialog me botën, me anë të të cilit Kisha ripërtërihet. Por do të rezultojë e dobishme për ta që të mos humbasin kontaktin me këtë realitet mjaft të pasur të famullisë lokale dhe të marrin pjesë me kënaqësi në veprimtarinë baritore të asaj Kise të veçantë²⁹. Ky lloj integrimi nuk

²⁷ Shih edhe *Propositio* 26.

²⁸ Shih edhe *Propositio* 44.

²⁹ Krh *Propositio* 26.

do t'i lërë të përqendrohen vetëm në një pjesë të Ungjillit ose Kishës, apo të kthehen në endacakë.

30. Çdo kishë e veçantë, si pjesë e Kishës Katolike nën udhëheqjen e ipeshkvit të saj, është e thirrur gjithashtu për kthimin misionar. Është subjekti kryesor i ungjillëzimit³⁰, duke qenë se është shfaqja konkrete e Kishës së vetme në një vend të caktuar dhe në të është e pranishme dhe vepruese "Kisha e vetme, e shenjtë, katolike dhe apostolike e Krishtit"³¹. Është Kisha e mishëruar në një hapësirë të përcaktuar, e pajisur me të gjitha mjetet e shpëtimit të dhëna nga Krishti, por vetëm se me veçori lokale. Gëzimi i saj për të ndarë Jezu Krishtin shprehet si nga një preokupim për ta predikuar atë aty ku ka më shumë nevojë dhe në një dalje të vazhdueshme drejt periferisë ose drejt vendeve të reja shoqërore-kulturore³². Ajo dëshiron të ndodhet aty ku nevoja për dritën dhe jetën e Krishtit të ringjallur është më e madhe³³.

³⁰ Krh *Propositio* 41.

³¹ Conc. Ecum. Vat.II Dekret mbi misionin pastoral të ipeshkvijve të Kishës *Christus Dominus*, 11

³² Shih Benedikti XVI, Fjalim ndaj pjesëmarrësve të Konferencës Ndërkombëtare me rastin e 40 vjetorit të dekretit konciljar *Ad gentes* (11 mars 2006); AAS 98 (2006), 337.

³³ Shih *Propositio* 42.

Që kjo shtytje misionare të jetë sa më intensive, e bollshme dhe e frytshme, unë nxis çdo Kishë të veçantë që të ndërmarrë një proces të patundur dallimi, pastrimi dhe reformimi.

31. Ipeshkvi duhet ta ushqejë këtë bashkësi misionare në Kishën e tij dioqezane, duke ndjekur idealin e bashkësive të para të krishtera, në të cilat besimtarët kanë qenë të një zemre dhe një shpirti të vetëm (krh. Vap 4,32). Për ta arritur këtë, ai do të dalë ndonjëherë para besimtarëve, për të treguar udhën dhe për ta mbajtur gjallë shpresën e tyre. Kurse në raste të tjera ai do të jetë në mesin e tyre me praninë e tij të dhembshur e të thjeshtë, apo dhe të qëndrojnë pranë tyre dhe të ndihmojnë ata që kanë mbetur prapa dhe mbi të gjitha të lejojë tufën që të gjejë shtigje të reja. Në misionin e tij të kultivimit të një bashkësie dinamike, të hapur dhe misionare, ai duhet të nxisë dhe zhvillojë mjetet e pjesëmarrjes të propozuara në Kodin e Ligjit Kanonik³⁴ dhe forma të tjera të dialogut baritor, nga dëshira për të dëgjuar çdo njeri dhe jo vetëm ata që i thonë atë çka ai dëshiron të dëgjojë. Por objektivi i këtyre proceseve pjesëmarrëse nuk do

³⁴ Shih në vijim 460-468; 492-502; 511-514; 536-537.

të jetë organizimi kishtar por aspirata misionare e të arriturit të çdo njeriu.

32. Meqë unë jam i thirrur që të zbatoj në praktikë atë që u kërkoj të tjerëve, më duhet të mendoj edhe për kthimin e papatit. Si ipeshkëv i Romës e kam për detyrë të jem i hapur ndaj sugjerimeve të cilat mund të më ndihmojnë që ushtrimi i shërbesës sime të jetë sa më besnike ndaj kuptimit që dëshiron të t'i jepte Jezu Krishti dhe nevojave të tashme të ungjillëzimit. Papa Gjon Pali II ka kërkuar ndihmë në gjetjen e një "mënyre për të ushtruar përparësinë që megjithëse është esenciale ndaj misionit të vet është prapëseprapë e hapur ndaj një situatë të re"³⁵. Ne kemi bërë pak përparim në këtë drejtim. Papati dhe strukturat qendrore të Kishës universale kanë nevojë gjithashtu që të dëgjojnë thirrjen ndaj kthimit baritor. Konkili i Vatikanit II ka pohuar se ashtu si kishat e lashta patriarkale, konferencat janë në një gjendje që "mund të kontribuojnë në mënyra të shumta dhe të frytshme për realizmin e shpirtit kolegjial"³⁶. Megjithatë kjo dëshirë nuk është

³⁵ Letra enciklike *Ut unum sint* (25 maj 1995), 95: AAS 87 (1995), 977-978.

³⁶ Conc. Ecum. Vat.II, Cost. Kushtetuta dogmatike e Kishës Lumen gentium, 23.

realizuar plotësisht, meqenëse statusi juridik i konferencave ipeshkvore që i sheh si subjekte atributesh konkrete, që përfshin edhe ndonjë autoritet autentik doktrinor nuk është shtjelluar ende mjaftueshëm³⁷. Centralizimi i tepruar në vend që të rezultojë i dobishëm, e ndërlikon jetën e Kishës dhe shërbesën e saj misionare.

33. Shërbesa baritore në një perspektivë misionare përpigjet të braktisë qëndrimin e vetë-kënaqur që thotë: “Ne e kemi bërë gjithnjë në këtë mënyrë”. I ftoj të gjithë që të jenë kurajozë dhe krijues në këtë detyrë të të rimenduarit të synimeve, strukturave, stilit dhe metodave të ungjillëzimit në bashkësitë e tyre përkatëse. Një propozim synimesh pa një kërkim të duhur komunitar të mjeteve për t’i arritur ato, do të rezultojë patjetër në një diçka iluzore. Unë e nxis secilin prej jush t’i zbatojë udhëzimet që gjenden në këtë dokument me zemërgjerësi dhe guxim, pa frenim apo frikë. E rëndësishme është të mos ecësh i vetëm, por të mbështetesh në njëri-tjetrin si vëllezër e motra, dhe sidomos nën drejtimin e ipeshkvijve, me një dallim baritor të mençur dhe realist.

³⁷ Shih Gjon Pali II, *Moptu proprio, Apostolos suos* (21 maj 1998): AAS 90 (1998), 641-658.

III. NGA ZEMRA E UNGJILLIT

34. Nëse përpigemi që t’i vendosim të gjitha gjërat në një perspektivë misionare, kjo do të ndikojë edhe në mënyrën sesi e përcjellim mesazhin. Në botën e sotme të komunikimit të shpejtë dhe të përzgjedhjes së informacionit nga ana e medieeve, mesazhi që predikojmë rrezikon shumë që të shtrembërohet apo të reduktohet në disa prej aspekteve të tij dytësore. Në këtë mënyrë disa çështje që janë pjesë e mësimit moral të Kishës janë marrë jashtë kontekstit që u jep kuptimin. Problemi më i madh është kur mesazhi që predikojmë duket se identifikohet me ato aspekte dytësore, të cilat sado të rëndësishme që të jenë, nuk e përcjellin në vetvete thelbin e mesazhit të Krishtit. Ne duhet të jemi realistë dhe të mos supozojmë që ata me të cilët komunikojmë e njohin mirë sfondin e fjalëve tona ose janë në gjendje që ta lidhin atë që u themi me vetë zemrën apo thelbin e Ungjillit i cili u jep kuptimin, bukurinë dhe joshjen.

35. Shërbesa baritore në një perspektivë misionare nuk është e fokusuar me përcjelljen e shkëputur të një sërë doktrinave të cilat duhet të imponohen me ngulm. Kur kemi një pikësynim baritor dhe një

metodë misionare që i arrin faktikisht të gjithë pa asnjë përjashtim, mesazhi duhet të përqendrohet mbi pikat esenciale, mbi atë që është më e bukur, më e madhërishme, më tërheqëse dhe në të njëjtën kohë edhe më e nevojshme. Mesazhi thjeshtohet por pa humbur ndërkohë asgjë nga thellësia dhe e vërteta e tij, duke u bërë kështu edhe më i fuqishëm dhe bindës.

36. Të gjitha të vërtetat e zbuluara rrjedhin nga i njëjti burim hyjnor dhe duhet të besohen me të njëjtën fe, megjithatë disa prej tyre janë më të rëndësishme për të shprehur në mënyrë më të drejtpërdrejtë thelbin e Ungjillit. Në këtë bërthamë ajo që shkëlqen është *bukuria e dashurisë shëlbuese të Hyjit që është shfaqur në Jezun Krishtin të vdekur e të ringjallur*. Në këtë kuptim, Koncili i II-të i Vatikanit shpjegon se “në doktrinën katolike ekziston një rend apo një ‘hierarki’ të vërtetash, meqenëse ato ndryshojnë në raport me lidhjen ndaj themelit të fesë së krishterë”³⁸. Kjo vlen si për dogmat e fesë ashtu edhe për të gjitha mësimet e Kishës, duke përfshirë edhe mësimet e saj morale.

³⁸ Conc. Ecum. Vat. II, Dekreti mbi ekumenizmin *Unitatis redintegratio*, 11

37. Shën Tomë Akuini ka mësuar që mësimi moral i Kishës ka “hierarkinë” e vet, në virtytet e aktet që rrjedhin prej tyre³⁹. Këtu, çfarë vlen mbi të gjitha është “besimi përmes dashurisë” (Gal 5,6). Veprat e dashurisë ndaj të afërmit janë të shfaqurit më të përkryer të jashtëm të hirit të brendshëm të Shpirtit: “Themeli i Ligjit të Ri është hiri i Shpirtit, i Cili shfaqet në besimin që vepron përmes dashurisë”⁴⁰. Toma shpjegon se për aq sa u përket veprave të jashtme, mëshira, është më e madhja e të gjitha virtyteve: “Mëshira në vetvete është më e madhja ndër virtytet, duke qenë se të gjitha të tjerat vërtiten rreth saj dhe ajo plotëson të metat e tyre. Kjo është një detyrë që i përket veçanërisht virtytit më të lartë, dhe si rrjedhim i takon Hyjit që të ketë mëshirën, me anë të së cilës shfaqet gjithëfuqishmëria e tij”⁴¹.

³⁹ Shih *Summa Theologiae*, I-II, q. 66, art. 4-6

⁴⁰ *Summa Theologiae*, I-II, q. 108, art. 1

⁴¹ *Summa Theologiae*, II-II, q. 30, art. 4. Shih po aty q. 30, art. 4, ad. 1: “Nuk e ushtrojmë adhurimin ndaj Hyjit me blatime të jashtme për të, por për ne dhe të afërmin tonë. Ai nuk ka nevojë për flijimet tona, por na kërkon që t’ia ofrojmë nga përsheptshmëria jonë dhe për të mirën e të afërmit tonë. Për të, mëshira që i mposht të metat e devocionit dhe flijimit tonë është flija më e kënaqshme, pasi është mëshira mbi të gjitha që kërkon të mirën e të afërmit tonë” (S. Th., II-II, q. 30, a. 4, ad 1).

38. Ka rëndësi që të nxjerrim pasojat baritore të mësimin të Konkilit, që reflekton një bindje të lashtë të Kishës. Së pari, duhet thënë se në predikimin e Ungjillit duhet ruajtur një masë e duhur, gjë që shihet në shpeshtësinë e referimit të disa temave të caktuara dhe theksimit që u jepet atyre në predikim. Për shembull, nëse gjatë një viti liturgjik, një famullitar flet dhjetë herë mbi vetëpërmbytjen por e përmend dashurinë apo drejtësinë vetëm dy a tri herë, do të rezultojë një çekuilibër dhe pikërisht ato virtyte që duhet të jenë më shumë të pranishme gjatë predikimit dhe katekizmit do të nënvleftësohen. E njëjta gjë ndodh kur flasim më shumë për ligjin sesa për hirin, më shumë për Kishën sesa për Krishtin, më shumë për Papën sesa për Fjalën e Hyjit.

39. Ashtu si uniteti organik ekzistues ndër virtytet do të thotë që asnjëra prej tyre nuk mund të përjashtohet nga ideali i krishterë, asnjë e vërtetë nuk mohohet. Integriteti i mesazhit të Ungjillit nuk duhet të deformohet. Po ashtu, çdo e vërtetë kuptohet më mirë kur lidhet me tërësinë e harmonishme të mesazhit të krishterë; në këtë kontekst të gjitha të vërtetat janë të rëndësishme dhe ndriçojnë njëra-tjetrën. Kur predikimi është

besnik ndaj Ungjillit, rëndësia e disa të vërtetave është e qartë dhe shihet se morali i krishterë nuk është një formë stoicizmi, apo vetëmohimi, apo thjesht një filozofi praktike ose një katalog mëkatesh dhe gabimesh. Para së gjithash, Ungjilli na fton që t'i përgjigjemi Hyjit të dashurisë i cili na shpëton, të shohim Zotin tek të tjerët dhe të dalim nga vetja për të kërkuar të mirën e të tjerëve. Në asnjë mënyrë nuk duhet të cënohet kjo ftesë! Të gjitha virtytet janë në shërbim të kësaj përgjigjeje të dashurisë. Nëse kjo ftesë nuk rrezaton me forcë dhe në mënyrë tërheqëse, ndërtesa e mësimin moral të Kishës rrezikon të bëhet një shtëpi prej kartoni, që na rrezikon shumë. Por atëherë nuk do të ishte Ungjilli që do të predikohej, por vetëm disa pika doktrinale ose morale të bazuara në disa opsione specifike ideologjike. Mesazhi do të rrezikojë humbjen e freskisë dhe nuk do ta ketë më "aromën e Ungjillit".

IV. NJË MISION I MISHËRUAR

BRENDA KUFIJVE NJERËZORË

40. Kisha është vetë një nxënëse misioni dhe si e tillë ajo ka nevojë të rritet në interpretimin e fjalës

së zbuluar dhe në kuptimin e saj të së vërtetës. Ekzegjetët dhe teologët e kanë për detyrë që të ndihmojnë për “maturimin e gjykimit të Kishës”⁴². Edhe shkencat e tjera gjithashtu ndihmojnë në realizimin e kësaj, secila në mënyrën e vet unike. Duke iu referuar shkencave shoqërore, Gjon Pali II për shembull, ka thënë se Kisha u kushton kujdes kontributeve të saj “për të nxjerrë tregues konkretë që ta ndihmojnë në shpalosjen e misionit të vet të Magjisterit”.⁴³ Brenda Kishës po studiohen çështje të panumërta dhe po reflektohen me liri të madhe. Rryma të ndryshme mendimi filozofik, teologjik dhe në baritoren, nëse janë të hapura ndaj harmonizimit prej Shpirtit në lidhje me respektin dhe dashurinë, mund ta aftësojnë Kishën që të rritet, meqenëse ato ndihmojnë në të shprehurit më të qartë të pasurive të pakufishme të Fjalës së Zotit. Për ata që ëndërrojnë një doktrinë monolite që ruhet nga të gjithë pa lënë asnjë vend për nuanca të ndryshme, kjo mund të duket e padëshirueshme dhe konfuze. Por në fakt një larmi e tillë shërben për të nxjerrë në pah

⁴² Konkili II Ekumenik i Vatikanit, Kusht. Dogm. mbi Zbulesën Hyjnore *Dei Verbum*, 12.

⁴³ *Motu Proprio Socialium Scientiarum* (1 Janar 1994): AAS 86 (1994), 209.

dhe zhvilluar tipare të ndryshme mbi pasuritë e pashtershme të Ungjillit⁴⁴.

41. Në të njëjtën kohë, ndryshimet e mëdha dhe të shpejta kulturore të kohës së sotme kërkojnë që ne të përpiqemi pa reshtur për të shprehur të vërtetat e pandryshueshme në një gjuhë që sjell risinë e përhershme. Sepse, në fushën e fesë së krishterë “lënda e saj është një gjë [...] ndërsa mënyra e të shprehurit është diçka tjetër”⁴⁵. Ka raste kur besimtarët duke dëgjuar një gjuhë krejt të shëndoshë, marrin diçka që nuk përputhet me Ungjillin e mirëfilltë të Jezu Krishtit, për shkak të gjuhës që përdorin vetë e cila ndryshon me atë që

⁴⁴ Shën Tomë Akuini ka vënë re se shumëllojshmëria dhe variacioni “kanë qenë qëllimi i agentit të parë”, i cili dëshiron që “ajo çfarë i mungonte çdo individ me qëllim që të reflektonte mirësinë hyjnore të mund të konpensohej nga gjëra të tjera”, duke qenë se mirësia e Krijuesit “nuk mund të reflektohej si duhej nga një krijesë e vetme” (S. Th., I, q. 47, a. 1). Si rrjedhim, ne duhet të kapim varietetin e gjërave në marrëdhëniet e tyre të shumëllojshme (shih S. Th., I, q. 47, a. 2, ad 1; q. 47, a. 3). Për arsye të ngjashme, ne duhet të dëgjojmë dhe të plotësojmë njëri-tjetrin në perceptimin tonë të realitetit dhe të Ungjillit.

⁴⁵ Gjoni XXIII, fjalim me rastin e hapjes së Konkilit të Dytë të Vatikanit (11 tetor 1962): AAS 54 (1962), 792: “Est enim aliud ipsum depositum fidei, seu veritates, quae veneranda doctrina nostra continentur, aliud modus, quo eadem enuntiantur”.

dëgjojnë. Me qëllimin e shenjtë të komunikimit të së vërtetës mbi Hyjin dhe njerëzimin, ne ndonjëherë u japim një hyj të rremë apo një ideal njerëzor që nuk është me të vërtetë i krishterë. Në këtë mënyrë, ne i qëndrojmë besnik një formulimi ndërkohë që nuk e përcjellim substancën e tij. Ky është rreziku më i madh. Le të mos harrojmë kurrë që “shprehja e së vërtetës mund të marrë forma të ndryshme. Ripërtëritja e këtyre formave të shprehjes bëhet e nevojshme për hir të transmetimit ndaj njeriut të sotëm mesazhin e Ungjillit në kuptimin e tij të pandryshueshëm”⁴⁶.

42. Kjo ka një aktualitet të madh për predikimin e Ungjillit, nëse jemi vërtet të preokupuar për ta bërë bukurinë e vet që të njihet e të pranohet nga të gjithë. Megjithatë nuk mund t’i bëjmë mësimet e Kishës që të kuptohen lehtësisht ose të vlerësohen mirë nga të gjithë. Besimi gjithnjë mbart në vetvete një aspekt të kryqit, një farë paqartësie që nuk e pakëson vendosmërinë e miratimit. Disa gjëra kuptohen dhe vlerësohen vetëm nga këndvështrimi i këtij miratimi apo pohimi, që është i lidhur ngushtë me dashurinë,

⁴⁶ Gjon Pali II, letër enciklike *Ut Unum Sint* (25 Maj 1995), 19: AAS 87 (1995), 933.

përtej shtrirjes së arsyeve e argumenteve të qarta. Ne duhet të kujtojmë që çdo mësim i doktrinës duhet të përditësohet në qëndrimin ungjillëzues që zgjon përputhjen e zemrës me afërsinë, dashurisë dhe dëshmisë⁴⁷.

43. Në shoshitjen e vazhdueshme, Duke cituar Shën Agustinin, ai vëren që rregullat e urdhëruara nga Kisha duhet të kërkojnë me kujdes “që të mos rëndojnë jetën e besimtarëve” dhe ta bëjnë fenë tonë një farë skllavërie, kur në fakt “mëshira e Hyjit ka dashur që të jemi të lirë”⁴⁸. Ky paralajmërim që është bërë shumë shekuj më parë është mjaft aktual sot. Duhet të jetë një nga kriteret që duhet të merret parasysh kur mendohet për një reformë të Kishës dhe të predikimeve të saj, duke e aftësuar që të arrijë tek të gjithë.

44. Po ashtu, barinjtë dhe besimtarët që shoqërojnë vëllezërit e motrat e tyre në fe ose në një rrugëtim në kërkim të Hyjit duhet të kujtojnë gjithnjë atë që Katekizma e Kishës Katolike mëson qartë: “Fajshmëria dhe përgjegjshmëria për një veprim mund të pakësohet ose madje edhe të shfuqizohet

⁴⁷ *Summa Theologiae*, I-II, q. 107, art. 4.

⁴⁸ *Ibid*

nga padituria, shkujdesi, detyrimi, frika, zakoni, dashuritë apo lidhjet e çrregullta dhe faktorë të tjerë psikologjikë apo shoqërorë⁴⁹. Si rrjedhim, pa hequr asgjë nga ideali i ungjillit, ata duhet të shoqërojnë me mëshirë dhe durim fazat e mundshme të rritjes personale ashtu siç zhvillohen ditë pas dite⁵⁰. Kurse meshtarëve iu kujtoj se rrefyestorja nuk është një dhomë torturash por një përballje me mëshirën e Zotit që na nxit të bëjmë më të mirën tonë. Një hap i vogël në mes të kufizimeve të mëdha njerëzore mund të jetë më e pëlqyeshme për Hyjin sesa një jetë që duket nga jashtë në rregull por i kalon ditët pa u ndeshur me vështirësi të mëdha. Çdo njeri duhet të preket nga ngushëllimi dhe nxitja e dashurisë shpëtuese të Hyjit, që vepron në mënyrë të mistershme në çdo person, përtej të metave dhe dështimeve të tyre.

45. Ne shohim pra që detyra e ungjillëzimit vepron brenda kufijve të gjuhës dhe rrethanave. Ajo përpaket vazhdimisht të komunikojë më mirë të vërtetën e Ungjillit në një kontekst specifik, pa hequr dorë nga e vërteta, mirësia dhe drita që mund të sjellë sa herë që përsosmëria nuk

⁴⁹ No. 1735

⁵⁰ Shih Gjon Pali II, Porosi post-sinodale *Familiaris Consortio* (22 nëntor 1981), 34: AAS 74 (1982), 123.

është e mundshme. Një zemër misionare është e vetëdijshme për këta kufizime dhe e bën veten “të dobët me të dobët... për të gjithë u bëra gjithçka” (1 Kor. 9,22). Nuk mbyllet asnjëherë në vetvete, nuk tërhiqet në sigurinë e vet e nuk zgjedh kurrë ngurtësinë dhe vetëmbrojtjen. Ajo e kupton se duhet të rritet në kuptimin e Ungjillit dhe në dallimin e shtigjeve të Shpirtit dhe kështu e bën gjithnjë atë të mirë që mundet, edhe kur duke e bërë këtë, i ndoten këpucët me baltën e rrugës.

V. NJË NËNË ME NJË ZEMËR TË HAPUR

46. Një Kishë e cila “del jashtë” është një Kishë që i ka dyert e hapura. Të dalësh për të arritur ata që janë braktisur nga të gjithë nuk do të thotë që të ecësh nëpër botë pa një drejtim të caktuar. Shpesh është më mirë të ngadalësosh hapin, duke e lënë mënjane ankthin tonë dhe t’i dëgjojmë njerëzit duke i parë në sy, e të mos ngutemi nga një gjë në tjetrën dhe të qëndrojmë me dikë që është rrëzuar. Disa herë duhet të jemi si babai i djalit plangprishës, i cili e mbante gjithnjë derën e hapur, në mënyrë që kur të kthehej i biri ai të mund të futej lehtësisht brenda.

47. Kisha është thirrur që të jetë shtëpia e Atit, me dyert e hapura në çdo kohë. Një shenjë konkrete e një gatishmërie të tillë është që dyert e kishave tona duhet të jenë gjithnjë të hapura, në mënyrë që nëse dikush shkon e kërkon Zotin, i shtyrë nga Shpirti, ai ose ajo nuk e gjen derën e mbyllur. Ka dhe dyer të tjera që nuk duhet të mbyllen. Çdo njeri mund të marrë pjesë në një farë mënyre në jetën e Kishës; çdo njeri mund të jetë pjesë e bashkësisë e as nuk duhet t'u mbyllen dyert e sakramenteve për çfarëdo arsye. Kjo vlen sidomos për sakramentin që është vetë "dera": pagëzimin. Eukaristia, ndonëse është plotësia e jetës sakramentale nuk është një çmim për të përkryerit por një ilaç i fuqishëm dhe ushqim për të dobtit⁵¹. Këto bindje kanë pasoja baritore të cilat jemi thirrur për t'i marrë në konsideratë

⁵¹ Shën Ambrozi, *De Sacramentis*, IV, 6, 28: PL 16, 464: "Unë duhet ta marr gjithnjë, që të më falen mëkatet. Nëse mëkatet vazhdimisht, duhet të kem një zgjidhje apo ilaç"; ID., op. cit., IV, 5, 24: PL 16, 63: "Ata që e hëngrën manën vdiqën, ndërsa ata që e hanë këtë trup do të marrin faljen e mëkatëve të tyre"; Shën Cirili i Aleksandrisë, In Joh. Evang., IV, 2: PG 73, 584-585: "Unë e shqyrtova veten dhe e shoh veten të padenjë. Atyre që flasin kështu unë iu them: kur do të jeni të denjë? Kur jeni paraqitur për herë të fundit para Krishtit? Dhe nëse mëkatet ju pengojnë nga të afruarit te Ai, dhe ju gjithnjë rrëzoheni, sepse siç thotë Psalmi: 'cili është ai njeri që i njej fajet e tij?' – a do të rrini pa marrë nga shenjtërimi që jep jetën e përjetshme?"

me maturi dhe guxim. Shpesh, ne veprojmë më shumë si arbitra hiri sesa lehtësues. E pra Kisha nuk është një doganë, por është shtëpia atërore ku ka vend për secilin me të gjitha problemet e tij.

48. Nëse e tërë Kisha e merr këtë dinamizëm misionar, ajo do të arrijë çdo njeri pa asnjë përjashtim. Por te ku duhet të shkojë ajo në fillim? Kur lexojmë Ungjillin, ne shohim një orientim të qartë: jo aq shumë te miqtë tanë dhe të afërmit e pasur, por mbi të gjitha tek të varfrit e të sëmurët, ata që zakonisht përbuzen dhe shpërfillen, "ata që nuk mund t'jua shpërblejnë" (Luka 14,14). Nuk ka vend për dyshim ose për shpjegime që e dobësojnë një mesazh kaq të qartë. Sot dhe gjithnjë: "të varfrit janë marrësit e privilegjuar të Ungjillit"⁵² dhe fakti që u predikohet lirisht atyre është një shenjë e mbretërisë që Jezusi erdhi të vendosë. Ne duhet të deklarojmë, pa fjalë të bukura se ekziston një lidhje e pandashme midis besimit tonë dhe të varfërve. Le të mos i braktisim kurrë ata.

49. Le të dalim pra që t'i ofrojmë çdo njeriu jetën e Jezu Krishtit. Po e përsëris për mbarë Kishën atë që u kam thënë shpesh meshtarëve dhe

⁵² Benedikti XVI, Fjalim para ipeshkvijve brazilianë në katedralen e Shën Palit, Brazil (11 maj 2007), 3: AAS 99 (2007), 428.

besimtarëve të Buenos Airesit: unë preferoj më mirë një Kishë që është e plagosur, e lënduar dhe e pistë sepse ka dalë nëpër rrugë, sesa një Kishë që është e sëmurë nga të qenit e mbyllur në kafaz. Nuk dua një Kishë që e ka mendjen që të jetë në qendër dhe në fund zihet në rrjetën e manive dhe procedurave. Nëse ka diçka që duhet me të drejtë të na trazojë ndërgjegjen është fakti që shumë prej vëllezërve e motrave tona jetojnë pa fuqinë, dritën dhe ngushëllimin që buron nga miqësia me Jezun Krishtin, pa përkrahjen e një bashkësie të fesë, pa një qëllim në jetë. Më shumë se frika se mos gaboj, shpresoj që do të prekemi nga frika e të mbyllurit brenda strukturave që na japin një ndjenjë të rreme sigurie, brenda rregullave që na bëjnë gjyqtarë të ashpër, brenda zakoneve që na bëjnë të ndjehemi të sigurt, ndërsa njerëzit na trokasën te dera të uritur dhe Jezusi nuk lodhet së thëni: “jepuni diçka për të ngrënë” (Mk 6,37).

KREU II

NË MES TË KRIZËS SË PËRKUSHTIMIT KOMUNITAR

50. Para se të flasim për disa çështje bazë të lidhura me shërbesën e ungjillëzimit, mund të jetë e dobishme që të përmendim shkurtimisht kontekstin në të cilin na duhet të jetojmë dhe të punojmë. Sot ne dëgjojmë shpesh për një “ngarkesë diagnostike” që nuk është e shoqëruar gjithnjë me metoda efektive dhe të zbatueshme trajtimi. As nuk do të na ndihmonte një analizë krejt sociologjike që do të synonte pranimin e realitetit duke përdorur një metodë gjoja neutrale dhe klinike. Ajo që dua të propozoj është diçka pak a shumë në linjën e një dallimi ungjillor. Është qëndrimi i një dishepulli misionar, një qëndrim që “ushqehet nga drita dhe forca e Shpirtit të Shenjtë”⁵³.

51. Nuk është detyra e Papës që të ofrojë një analizë të detajuar dhe të plotë të realitetit

⁵³ Gjon Pali II, Porosi Apostolike post-sinodale *Pastores Dabo Vobis* (25 mars 1992), 10: AAS 84 (1992), 673.

bashkëkohor, por unë i nxis të gjitha bashkësitë për një “shqyrtim vigjilent për të parë shenjat e kohës”⁵⁴. Bëhet fjalë për një përgjegjësi serioze, duke qenë se disa realitete të caktuara të tanishme nëse nuk gjejnë zgjidhje të mira, mund të krijojnë procese çnjerëzore që do të ishte e vështirë të ktheheshin mbrapsht. Ne duhet të dallojmë qartë atë që mund të jetë një fryt i mbretërisë nga ajo që bie ndesh me planin e Hyjit. Kjo ka të bëjë jo vetëm me njohjen e dallimin e shpirtave por edhe të zgjedhësh lëvizjet e shpirtit të mirë, duke mohuar ndërkohë ato të shpirtit të keq, që është diçka shumë e rëndësishme. Unë i marr si faktike analizat e ndryshme që kanë ofruar dokumentet e tjera të magjisterit universal, si dhe ato të propozuara nga konferencat rajonale dhe kombëtare të ipeshkvijve. Në këtë Porosi unë pretendoj vetëm që të konsideroj shkurtimisht dhe nga një perspektivë baritore disa faktorë të ndryshëm që mund të frenojnë ose dobësojnë shtytjen e ripërtëritjes misionare në Kishë, ose sepse e kërcënojnë jetën dhe dinjitetin e popullit të Hyjit ose sepse i prekin ata që janë të përfshirë

⁵⁴ Pali VI, Letër Enciklike *Ecclesiam Suam* (6 gusht 1964), 19: AAS 56 (1964), 609.

drejtpërdrejt në institucionet e Kishës dhe në shërbesën e saj të ungjillëzimit.

I. DISA SFIDA TË BOTËS SË SOTME

52. Në kohën tonë njerëzimi po provon një kthesë në historinë e tij, siç mund ta shohim nga përparimet e bëra në shumë fusha. Ne duhet të lavdërojmë hapat e marrë për të përmirësuar mirëqenien e njerëzve në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe mjetet e komunikimit. Në të njëjtën kohë ne duhet të kujtojmë se shumica e bashkëkohësve tanë jetojnë në një pasiguri të madhe të përditshme, me pasoja serioze. Një sërë sëmundjesh po përhapen. Zemrat e shumë njerëzve i ka pushtuar frika e dëshpërimi, edhe në të ashtuquajturat vende të pasura. Gëzimi i të jetuarit po shuhet gjithnjë e më shumë, mungesa e respektit për të tjerët e dhuna janë në rritje, ndërsa pabarazia është bërë gjithnjë e më e dukshme. Jeta është bërë luftë dhe i ka humbur dinjitetin. Ky ndryshim epokal është shkaktuar nga përparimet sasiore, cilësore, të shpejta e të akumuluar që shihen në shkenca dhe teknologji si dhe në

zbatimet e shpejta në sfera të ndryshme të natyrës e jetës. Ne jetojmë në një kohë të njohjes dhe informacionit, që ka shërbyer si burim formash të reja të një pushteti më shumë anonim.

Jo një ekonomi përjashtimi

53. Ashtu si urdhërimi “mos vrit” vë një limit të qartë për të ruajtur vlerën e jetës njerëzore, sot ne duhet t’i themi gjithashtu “mos” një ekonomi përjashtimi dhe pabarazie. Një ekonomi e tillë vret. Si ka mundësi që nuk del në lajme kur një i pastrehë vdes nga të jetuarit në rrugë, ndërkohë që kur bursa humbet dy pikë del lajm i parë. Ky është një rast përjashtimi. A mund të vazhdojmë të qëndrojmë kur ndërkohë që ushqimi hidhet përtokë, njerëzit vdesin nga uria? Kjo është pabarazi. Sot gjithçka i nënshtrohet ligjeve të konkurrencës dhe mbijetesës së më të fortëve, ku më të fuqishmit jetojnë në kurriz të të dobëtëve. Si pasojë, një masë e madhe njerëzish e shohin veten të përjashtuar dhe të harruar: pa punë, pa mundësi, e pa asnjë rrugëdalje. Vetë qeniet njerëzore konsiderohen si mallra konsumi për t’u përdorur dhe pastaj flaken si mbeturina. Ne

kemi krijuar një kulturë “flakjeje” që po përhapet gjithnjë e më shumë. Nuk bëhet më fjalë për shtypje dhe shfrytëzim, por diçka e re. Përjashtimi në fund të fundit ka të bëjë me atë që do të thotë të jesh pjesë e shoqërisë në të cilën jetojmë. Të përjashtuarit nuk janë më të anashkaluarit, sepse nuk janë as pjesë e saj. Të përjashtuarit nuk janë të “shfrytëzuarit” por të dëbuarit.

54. Në këtë kontekst, disa njerëz vazhdojnë të mbrojnë teori të dështuara sipas të cilave rritja ekonomike, e nxitur nga tregu i lirë do t’ia dalë që të sjellë drejtësi e barazi më të madhe në botë. Ky mendim, që nuk është provuar asnjëherë me fakte, shpreh një besim trashanik dhe naiv në mirësinë e atyre që kanë në dorë pushtetin ekonomik dhe në mekanizmat e shenjtëruara të sistemit aktual ekonomik. Ndërkohë, të përjashtuarit janë ende duke pritur. Për të ruajtur një mënyrë të jetuari apo për të ruajtur entuziazmin për këtë ideal egoist, është zhvilluar një globalizim indiference. Pothuajse pa qenë të vetëdijshëm, ne bëhemi të paaftë që të ndjejmë dhembshuri ndaj thirrjeve të të varfërve, të qajmë për dhimbjet e të tjerëve dhe të ndjejmë nevojën për t’i ndihmuar ata, sikur të

ishte përgjegjësia e të tjerëve e jo e jona. Kultura e begatisë na bën të pandjeshëm dhe të humbim qetësinë. Sa herë që tregu na ofron diçka të re për të blerë ne ngazëllohemi. Ndërkohë që jetët e atyre që kanë mbetur të mbërthyer nga mungesa mundësish na duken si një spektakël, pa na prekur fare.

Jo ndaj kësaj idhujtarie të re të parasë

55. Njëra nga shkaqet e kësaj situatë gjendet në marrëdhënien tonë me paranë, meqenëse ne e pranojmë qetësisht sundimin e saj mbi veten dhe shoqërinë. Kriza e tanishme financiare mund të na bëjë të nënvleftësojmë faktin që e ka zanafillën në një krizë të thellë njerëzore, që është mohimi i përparësisë së qenies njerëzore! Ne kemi krijuar idhuj të rinj. Adhurimi i viçit të lashtë të artë (krh. Eksodi 32,1-35) është kthyer me një maskë të re dhe të pamëshirshme në idhujtarinë e parasë dhe diktaturës së një ekonomie të papërcaktuar dhe pa një qëllim të mirëfilltë njerëzor. Kriza mbarëbotërore që ka prekur financat dhe ekonominë zbulon çekuilibrin dhe mbi të gjitha

mungesën e një preokupimi të vërtetë për qeniet njerëzore që i kthen ato në mallra konsumi.

56. Ndërsa fitimet e një pakice po rriten në mënyrë të dukshme, po ashtu po rritet edhe hendeku midis shumicës nga mirëqenia e vetëm pak fatlumëve. Ky çekuilibër është pasojë e ideologjive që mbrojnë autonominë absolute të tregut dhe spekulimeve financiare. Si pasojë, ata mohojnë të drejtën e shteteve, të ngarkuar me detyrën e vigjilencës për të mirën e përbashkët. E kështu krijohet një tirani e re, e padukshme dhe shpesh virtuale, që në mënyrë të paanshme dhe të pamëshirshme imponon ligjet dhe rregullat e veta. Borxhi dhe akumulimi i interesave e bëjnë po ashtu të vështirë që vendet të kuptojnë potencialin e ekonomive të tyre dhe të mos i lënë qytetarët të gëzojnë pushtetin e tyre të mirëfilltë blerës. Këtyre mund t'u shtojmë edhe korrupsionin mjaft të përhapur dhe evazionin fiskal vetëshërbyes, që ka marrë përmasa botërore. Etja për pushtet dhe zotërime materiale nuk njeh kufi. Në këtë sistem që priret të gllabërojë çdo gjë që i bëhet pengesë për rritjen e të ardhurave, çfarëdo lloji gjëje që është e brishtë, si mjedisi, është e pambrojtur para

interesave të një tregu të hyjnizuar, që bëhet në rregullën e vetme absolute.

Jo, ndaj një sistemi financiar që më shumë sundon sesa shërben

57. Prapa këtij qëndrimi fshihet një refuzim i etikës dhe i Hyjit. Etika shihet tani me një farë tallje apo sarkazmi. Ajo shihet si kundër-produktive, shumë njerëzore, sepse e bën paranë dhe pushtetin relativ. Shihet si një kërcënim, meqë dënon manipulimin dhe poshtërimin e personit. Në fakt etika të çon në një Hyj që kërkon një përgjigje të dedikuar e cila gjendet jashtë kategorisë së tregut. Kur këto të fundit absolutizohen, Hyji nuk mund të mos shihet veçse si i pakontrollueshëm, i pamanipulueshëm, madje edhe i rrezikshëm, meqë ai i thërret qeniet njerëzore drejt përmbushjes së tyre të plotë dhe drejt lirisë nga çdo formë skllavërimi. Etika, një etikë jo ideologjike e bën të mundur arritjen e ekuilibrit dhe të një rendi njerëzor shoqëror. Me këtë në mendje, unë i nxis ekspertët financiarë dhe udhëheqësit politikë që të reflektojnë mbi fjalët e njërit prej dijetarëve të lashtë: “Të mos ndash

pasurinë me të varfrit do të thotë t’u vjedhësh atyre dhe t’u heqësh bukën e gojës. Të mirat materiale që zotërojmë nuk janë tonat por të tyre⁵⁵.

58. Një reformë financiare e hapur ndaj konsiderimeve etike të tilla do të kërkojë një ndryshim të fuqishëm të qëndrimit nga ana e udhëheqësve politikë. Unë i nxis ata që ta përballin këtë sfidë me vendosmëri dhe me shikimin nga e ardhmja, duke mos shpërfillur sigurisht aspektet specifike të çdo rasti. Paraja duhet të shërbejë e jo të sundojë! Papa i do njësoj të gjithë, të pasur apo të varfër, por ai është i detyruar në emrin e Krishtit për t’u kujtuar të gjithëve se të pasurit duhet të ndihmojnë e të respektojnë të varfrin. Unë ju nxis për një solidaritet bujar dhe për kthimin e një etike të ekonomisë e financave që i favorizon me të vërtetë qeniet njerëzore.

Jo pabarazisë që pjell dhunë

59. Sot në shumë vende dëgjojmë një thirrje për një siguri më të madhe. Por nëse nuk ndryshojnë

⁵⁵ Shën Gjon Gojarti, De Lazaro Concio, II, 6: PG 48, 992D.

përrjashtimi dhe pabarazia në shoqëri dhe midis njerëzve, do të jetë e pamundur që të eliminohet dhuna. Të varfrit dhe popullsitë më të varfra akuzohen për dhunë, megjithatë pa mundësi të barabarta format e ndryshme të agresionit dhe konfliktit do të gjejnë një terren pjellor për rritje dhe do të shpërthejnë patjetër. Kur një shoqëri, qoftë ajo lokale, kombëtare apo globale është e gatshme që të lërë një pjesë të vetes në periferi, asnjë program politik ose përpjekje e forcave të rendit apo të sigurimit të shtetit nuk mund të garantojë qetësinë në mënyrë të pakufizuar. Kjo nuk ndodh sepse pabarazia nxit një reagim të dhunshëm nga të përjashtuarit prej sistemit, por sepse sistemi socio-ekonomik është i padrejtë në rrënjë. Ashtu si mirësia priret të përhapet, toleranca e të keqes që është padrejtësi priret ta shtrijë ndikimin e vet të dëmshëm dhe që të minojë qetësisht çdo sistem politik dhe shoqëror, pavarësisht sesa solide mund të duket. Nëse çdo veprim ka pasojat e veta, një e keqe e futur në strukturat e një shoqërie ka një potencial të vazhdueshëm për shpërbërje dhe vdekje. Është e keqja e kristalizuar në strukturat e padrejta shoqërore të cilat nuk mund të jenë baza e shpresës për një të ardhme më të mirë. Ne

jemi larg prej së ashtuquajturit “fund të historisë”, meqenëse kushtet për një zhvillim të pranueshëm dhe paqësor nuk janë artikuluar dhe kuptuar si duhet.

60. Mekanizmat e ekonomisë aktuale nxisin konsumin e tepruar, ndërkohë që është e qartë se konsumizmi i papërmbajtur i kombinuar me pabarazinë rezulton dy herë i dëmshëm ndaj strukturës shoqërore. Pabarazia shkakton një dhunë të tillë që fuqia e armëve nuk mund ta zgjidhë dot kurrë. Por vetëm sa shërben që t’u ofrojë shpresa të rreme atyre që bërtasin për siguri më të madhe, kur ne e dimë se armët dhe dhuna, në vend që të sigurojnë zgjidhje krijojnë konflikte të reja edhe më serioze. Disa kënaqen duke fajësuar të varfrit dhe vendet e varfra për problemet e tyre, me përgjithësime të papërligjura, duke pretenduar se zgjidhja është një “edukim” që do t’i qetësojë ata, duke i shndërruar në qenie të zbutura dhe të padëmshme. Kjo bëhet më irrituese për të përjashtuarit në dritën e korrupsionit të ngulitur thellë që shohim në shumë vende, në qeveritë, bizneset e institucionet, pavarësisht nga ideologjia politike e udhëheqësve të tyre.

61. Ne ungjillëzojmë edhe kur përpiqemi të konfrontojmë sfidat kryesore që mund të dalin⁵⁶. Ka raste kur ato marrin formën e sulmeve të vërteta ndaj lirisë fetare ose përndjekjeve të reja ndaj të krishterëve, të cilat në disa vende kanë arritur nivele alarmuese të urrejtjes dhe dhunës. Në shumë vende, problemi është më shumë ai i indiferencës dhe relativizmit, i lidhur me zhgënjimin dhe krizën e ideologjive që ka ndodhur si një reagim ndaj çdo gjëje që mund të duket si totalitare. Kjo nuk dëmton vetëm Kishën por edhe jetën shoqërore. Ne e shohim sesi në një kulturë ku çdo person dëshiron të mbartë të vërtetën e tij subjektive, qytetarët do ta kenë të vështirë për të hartuar një plan të përbashkët që i tejkalon interesat e dëshirat personale.

62. Në kulturën ekzistuese, i jepet përparësia të jashtmes, të menjëhershmes, të dukshmes, sipërfaqësore dhe të përkohshmes. Ajo që është reale i lë vendin dukjeve të jashtme. Në shumë vende globalizimi ka nënkuptuar një përkeqësim

⁵⁶ Shih *Propositio* 13.

të përshpejtuar të rrënjëve të tyre kulturore dhe një invadim të mënyrave të të menduarit dhe të tendencave që u përkasin kulturave të tjera të cilat janë të përparuara ekonomisht por të dobësuar etnikisht. Këtë fakt e kanë përmendur ipeshkvij të disa kontinenteve në sinode të ndryshme. Ipeshkvijtë afrikanë për shembull duke marrë Enciklikën *Sollicitudo Rei Socialis*, kanë sinjalizuar para disa vitesh se ka pasur sulme të shpeshta për t'i shndërruar vendet afrikane “pjesë të një mekanizmi, pjesë të një ingranazhi gjigant. Kjo është shpesh e vërtetë edhe në fushën e mjeteve të komunikimit shoqëror, të cilat duke u administruar më së shumti nga qendra në hemisferën veriore, nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur përparësive dhe problemeve të vendeve të tilla ose nuk e respektojnë fizionominë e tyre kulturore”⁵⁷. Në të njëjtën mënyrë, ipeshkvijtë e Azisë nënvizuan “ndikimet e jashtme mbi kulturat aziatike. Forma të reja të sjelljes po rezultojnë si pasojë e një mbiekspozimi ndaj mjeteve të komunikimit (...) Si pasojë, aspektet negative të industrisë

⁵⁷ Gjon Pali II, Porosi Apostolike *Ecclesia në Afrikë* (14 September 1995), 52: AAS 88 (1996), 32-33; ID., Letër enciklike *Sollicitudo Rei Socialis* (30 dhjetor 1987), 22: AAS 80 (1988), 539.

mediatike dhe të zbavitjes po kërcënojnë vlerat tradicionale dhe në veçanti shenjtërinë e martesës dhe stabilitetin e familjes”⁵⁸.

63. Feja Katolike e shumë popujve po përballet me sfidën e përhapjes së shpejtë të lëvizjeve të reja fetare, disa prej të cilave priren drejt fundamentalizmit, ndërsa të tjerat duket se propozojnë një përshtetësi pa Hyjin. Kjo është nga njëra anë një reagim njerëzor ndaj një shoqërie materialiste, konsumiste dhe individualiste, por është nga ana tjetër edhe një mjet shfrytëzimi i dobësisë së njerëzve që jetojnë në varfëri dhe në periferi të shoqërisë, apo në zona shumë të varfra, njerëzve që mbijetojnë në mes të vuajtjeve njerëzore dhe kërkojnë zgjidhje të menjëhershme të nevojave të tyre. Këto lëvizje fetare, jo pa një farë dinakërie, plotësojnë brenda një kulture më së shumti individualiste vakumin e lënë nga racionalizmi shekullar. Ne duhet ta pranojmë që nëse një pjesë e të pagëzuarve tanë u mungon ndjenja e përkatësisë në Kishë, kjo ndodh edhe për shkak të disa strukturave të caktuara dhe

⁵⁸ Gjon Pali II, Porosi Apostolike *Ecclesia në Azi* (6 nëntor 1999), 7: AAS 92 (2000), 458.

atmosferës mos mikpritëse në disa prej famullive dhe komuniteteve tona, ose mënyrës burokratike të të vepruarit ndaj problemeve, qofshin të thjeshta ose të koklavitura në jetën e besimtarëve. Në shumë vende mbizotëron një qëndrim administrativ mbi atë baritor, si një sakramentalizim pa formë të tjera të ungjillëzimit.

64. Procesi i shekullarizimit priret që ta reduktojë fenë dhe Kishën në një sferë personale apo private. Po ashtu, duke mohuar plotësisht të jashtëzakonshmen, ka prodhuar një degjenerim të etikës, një dobësim të ndjenjës së mëkatit personal dhe kolektiv dhe një rritje të ndjeshme të relativizmit. Këto kanë çuar në një ndjenjë të përgjithshme çorientimi, sidomos në periudhën e adoleshencës dhe rinisë që është mjaft e ndjeshme ndaj ndryshimeve. Ashtu siç kanë theksuar me të drejtë ipeshkvijtë amerikanë, ndërsa Kisha insiston mbi ekzistencën e normave morale të cilat janë të vlefshme për çdo njeri “janë ata në kulturën tonë të cilët e portretizojnë këtë mësim si të padrejtë, pra në kundërshtim me të drejtat njerëzore bazë. eklarime të tilla zakonisht pasojnë një formë relativizmi moral që i bashkohet në mënyrë jo

konsekuente një besimi në të drejtat absolute të individëve. Në këtë drejtim, Kisha shihet sikur promovon një paragjykim të veçantë dhe bën ndesh me lirinë individuale”⁵⁹. Ne jetojmë në një shoqëri informacioni që na bombardon gjithë kohën me të dhëna, të cilat trajtohen sikur kanë të njëjtën rëndësi dhe që çojnë në një sipërfaqësi të madhe për sa i përket dallimit moral. Si pasojë, ne duhet të sigurojmë një edukim që mëson të menduarit kritik dhe nxit zhvillimin e vlerave të pjekura morale.

65. Pavarësisht nga vala e shekullarizimit që ka pushtuar shoqëritë tona në shumë vende, madje edhe ato ku të krishterët janë pakicë, Kisha Katolike konsiderohet një institucion i besueshëm nga opinioni publik, e besueshme për solidaritetin e saj dhe preokupimin për ata që kanë nevojë më të madhe. Kisha ka vepruar në shumë raste si një ndërmjetëse për gjetjen e zgjidhjeve të problemeve që kanë të bëjnë me pagën, harmoninë shoqërore, atdheun, mbrojtjen e jetës, të drejtat njerëzore

⁵⁹ Konferenca amerikane e ipeshkvijve katolikë, shërbesa ndaj personave me pritje homoseksuale: udhëzime për kujdes pastoral (2006), 17.

dhe civile dhe kështu me radhë. Dhe sa i madh është kontributi nëpër shkolla dhe universitete katolike në mbarë botën! Kjo është diçka e mirë. E megjithatë ne e kemi të vështirë që njerëzit të shohin se kur ne ngremë çështje të tjera më pak të pëlqyeshme ndaj opinionit publik, ne e bëjmë këtë nga besnikëria ndaj po atyre bindjeve mbi dinjitetin njerëzor dhe të mirën e përbashkët.

66. Familja po përjeton një krizë të thellë kulturore, ashtu si të gjitha komunitetet dhe lidhjet shoqërore. Në rastin e familjes, dobësimi i këtyre lidhjeve bëhet shumë serioz sepse familja është qeliza themelore e shoqërisë, ku ne mësojmë të jetojmë me të tjerët, pavarësisht nga ndryshimet tona dhe gjithashtu t’i përkasim njëri-tjetrit. Ajo është gjithashtu vendi ku prindërit u përcjellin fenë fëmijëve të tyre. Martesa tani priret që të shihet si një formë e një kënaqjeje emocionale që mund të ndërtohet apo modifikohet si të duash. Por kontributi i domosdoshëm i martesës ndaj shoqërisë i tejkalon ndjenjat dhe nevojat momentale të çiftit. Siç kanë mësuar ipeshkvijtë francezë, ai nuk lind nga “ndjenja e dashurisë, kalimtare nga përkufizimi, por nga thellësia e

detyrimeve që kanë marrë bashkëshortët duke pranuar një bashkim të plotë jete”⁶⁰.

67. Individualizmi i epokës sonë postmoderne dhe të globalizuar favorizon një mënyrë të jetuari që e dobëson zhvillimin dhe stabilitetin e marrëdhënieve personale dhe i deformon lidhjet familjare. Veprimtaria baritore duhet ta nxjerrë në pah më qartë faktin që marrëdhënia jonë me Atin kërkon dhe inkurajon një bashkësi që shëron, promovon dhe përforcon lidhjet ndërpersonale. Në botën tonë, sidomos në disa vende, forma të ndryshme lufte dhe konfliktesh po shfaqen e megjithatë ne të krishterët qëndrojmë të patundur në synimin tonë për të respektuar të tjerët, për të shëruar plagët, për të lidhur ura, për të forcuar marrëdhënie dhe për të “mbajtur barrën e njëritjetrit” (Gal. 6,2). Edhe sot, po themelohen shoqata për mbrojtjen e të drejtave dhe ndjekjen e synimeve fisnike, çfarë është një shenjë që tregon etjen e shumë qytetarëve që duan të kontribuojnë ndaj progresit shoqëror dhe kulturor.

⁶⁰ Conférence Des Évêques De France, Conseil Famille et Société, Élargir le mariage aux personnes de même sexe? Ouvrons le débat! (28 shtator 2012).

Sfida ndaj kulturimit të besimit

68. Baza e krishterë e disa popujve, më së shumti në perëndim, është një realitet i gjallë. Këtu ne gjejmë, sidomos në mes të nevojtarëve, një burim moral që i ruan vlerat e një humanizmi autentik të krishterë. Duke e parë realitetin me sytë e besimit, ne nuk mund të mos dallojmë atë që po mbjell Shpirti i Shenjtë. Do të ishte mungesë besimi në veprimtarinë e tij të lirë dhe të pashqetësuar që të mendosh se vlerat autentike të krishtera mungojnë aty ku një numër i madh njerëzish kanë marrë pagëzimin dhe e shprehin besimin e solidaritetin e tyre në një sërë mënyrash. Kjo nënkupton më shumë se të pranosh “farëra të Fjalës” të rastësishme, duke qenë se ka të bëjë me një besim autentik të krishterë që ka shprehjet dhe mjetet e veta të të shfaqurit të marrëdhënies që ka me Kishën. Nuk është mirë të nënvleftësohet rëndësia e madhe që ka një kulturë e karakterizuar nga besimi, sepse kjo kulturë e ungjillëzuar, përtej çdo limiti, ka më shumë burime sesa shuma e besimtarëve përpara sulmeve të shekullarizimit aktual. Një kulturë popullore e ungjillëzuar përmban vlera besimi dhe solidariteti, që mund

të nxisin zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe besimtare dhe zotëron një urtësi të veçantë që duhet pranuar me mirënjohje.

69. Është e domosdoshme të ungjillëzosh kulturat me qëllim kulturimin e Ungjillit. Në vende me traditë Katolike, kjo do të thotë inkurajim, përkujdes dhe përforsim i një pasurie tashmë ekzistuese. Në vende me tradita të tjera fetare, ose vende thellësisht të shekullarizuara, nënkupton favorizimin e proceseve të reja për ungjillëzimin e kulturës, ndonëse këto do të kërkojnë një planifikim afat-gjatë. Por ne duhet të kemi parasysh se jemi nën një thirrje të vazhdueshme për t'u rritur. Çdo kulturë dhe grup shoqëror ka nevojë për pastrim dhe rritje. Në rastin e kulturave popullore të vendeve me popullsi Katolike, ne mund të shohim të metat që duhet të shërohen nga Ungjilli, si: shovinizmi, alkoolizmi, dhuna në familje, pjesëmarrje e ulët në Meshë, nocione fataliste ose supersticioze që të çojnë në magji e gjëra të ngjashme. Vetë besimi popullor mund të jetë pikënisja për shërimin e çlirimin nga këto të meta.

70. Është e vërtetë gjithashtu që në disa raste një theksim më i madh u vihet shprehjeve të jashtme dhe traditave të disa grupeve, ose ndonjë zbuluese të supozuar private që absolutizohen. Ky është një lloj krishtërimi që përbëhet nga përshtypshmëri që reflektojnë një jetë të besimit individual dhe sentimental i cila nuk përputhet me "besimin popullor" autentik. Disa njerëz i promovojnë këto shprehje pa u shqetësuar aspak për përparimin e shoqërisë ose formimin e laikëve dhe në disa raste e bëjnë këtë për përfitime ekonomike ose ndonjë farë pushteti mbi të tjerët. As nuk mund të nënvleftësojmë faktin që në dekadat e fundit ka pasur një rënie për sa i përket mënyrës sesi të krishterët ua përcjellin besimin të rinjve. Është e pamohueshme që shumë njerëz ndjehen të zhgënjyer dhe nuk identifikohen më me traditën katolike. Një numër gjithnjë e më i madh i prindërve nuk i sjell fëmijët për pagëzim apo për t'i mësuar sesi të luten. Ka dhe një farë eksodi në drejtim të bashkësive të tjera fetare. Ndër shkaqet e kësaj shpërndarjeje kemi: mungesën e mundësisë për dialog në familje, ndikimin e mjeteve të komunikimit, subjektivizmin relativist, konsumizmin e papërmbytur që ushqen tregun,

mungesën e përkujdesit baritor ndër të varfrit, dështimin e institucioneve tona për të qenë mikpritëse dhe vështirësinë tonë për të restauruar lidhjen mistike të fesë në një mjedis fetar pluralist.

Sfida nga kultura urbane

71. Jeruzalemi i ri, qyteti i shenjtë (krh. Zb 21,2-4) është synimi drejt të cilit po ecën i tërë njerëzimi. Është interesante që zbulesa e Zotit na tregon që plotësia e njerëzimit dhe e historisë po përmbushet në një qytet. Ne duhet t'i shohim qytetet tona me një vështrim soditës, një vështrim besimi që e shikon Hyjin të banojë në shtëpitë e tyre, në rrugët dhe sheshet e tyre. Prania e Hyjit i shoqëron përpjekjet e singerta të individëve dhe grupeve për të gjetur inkurajim dhe kuptim në jetët e tyre. Ai banon në mesin e tyre duke ushqyer solidaritet, vëllazërim dhe dëshirën për mirësi, të vërtetën dhe drejtësinë. Kjo prani nuk duhet të shpiket por të zbulohet. Hyji nuk e fsheh veten nga ata që e kërkojnë me një zemër të sinqertë, ndonëse ata e bëjnë këtë si rastësisht, me ngurrim dhe në mënyrë të mjegullt.

72. Në qytete, ndryshe nga fshati, përmasa fetare e jetës shprehet nga mënyra të ndryshme të jetuari, dhe ritmet e përditshme të lidhura me vende dhe njerëz. Në jetët e tyre të përditshme njerëzit duhet të luftojnë për mbijetesë dhe kjo luftë përmban nga përbrenda një njohje të thellë të jetës që shpesh përfshin një ndjenjë të thellë fetare. Ne duhet ta analizojmë këtë më nga afër që të hyjmë në dialog siç hyri Zoti me gruan samaritane te pusi ku ajo donte të shuante etjen e tij (krh. Gjn 4,1-15).

73. Kultura të reja vazhdojnë të lindin në këto hapësira të reja të gjera ku të krishterët jo vetëm që mund të jenë promovues ose gjeneratorë të kuptimit, por që edhe të marrin nga këto kultura gjuhë të tjera, simbole, mesazhe dhe paradigma që propozojnë qëndrime të reja ndaj jetës, të cilat shpesh bien në kundërshtim me Ungjillin e Jezusit. Një kulturë krejt e re ka lindur dhe vazhdon të rritet në qytete. Sinodi ka konstatuar se ndryshimet e ndodhura sot në hapësira të mëdha dhe kultura që krijojnë janë një vend i privilegjuar i ungjillëzimit të ri⁶¹. Kjo na nxit që të imagjinojmë hapësira lutjeje dhe bashkësie që janë më tërheqëse dhe domethënëse për

⁶¹ *Propositio* 25.

popullsitë urbane. Nëpërmjet ndikimit të medias, zonat rurale po preken nga të njëjtat ndryshime kulturore, të cilat po ndryshojnë gjithashtu edhe mënyrën e tyre të jetuarit.

74. Bëhet i nevojshëm një ungjillëzim që të mund të hedhë dritë mbi këto mënyra të reja të të lidhurit me Hyjin, me të tjerët dhe me botën që na rrethon dhe që na frymëzon me vlera themelore. Ai duhet të arrijë te vendet ku formohen tregime e paradigma të reja, duke e sjellë fjalën e Jezusit në vendet më të thella të shpirtit të qytetit. Nuk duhet harruar që qytetet janë multikulturore. Në qytetet e mëdha gjendet një rrjet lidhjeje, në të cilin grupe njerëzish ndajnë një imagjinatë dhe ëndrra të përbashkëta mbi jetën dhe formohen në sektorë të rinj njerëzorë, në territore kulturore dhe në qytete të padukshme. Forma të ndryshme kulturore ekzistojnë në fakt, por ushtrojnë në shumë raste izolim dhe dhunë. Kisha është thirrur që të vihet në shërbim të një dialogu të vështirë. Nga ana tjetër, ka qytetarë që i zotërojnë mjetet e nevojshme për zhvillimin e jetës personale dhe familjare, por ka dhe shumë nga ata që “nuk janë qytetarë”, janë “gjysmë qytetarë” ose “qytetës të

mbetur”. Qyteti prodhon një farë ambivalencë të përhershme sepse, megjithëse ata u ofrojnë qytetarëve të vet mundësi të pafund, ai paraqet edhe pengesa të shumta për zhvillimin e plotë të jetës së tyre. Kjo kontradiktë shkakton vuajtje të mëdha. Në shumë anë të botës qytetet janë skena të protestave masive ku me mijëra veta dalin në kërkim të lirisë, për të drejtën që të kenë një zë në jetën publike, për drejtësi dhe një sërë kërkesash të tjera, të cilat nëse nuk kuptohen si duhet, nuk mund të detyrohen me forcë që të mbyllin gojën.

75. Ne nuk mund ta injorojmë faktin që në qytete ndodhin trafikimi i qenieve njerëzore, tregtia e lëndëve narkotike, abuzimi dhe shfrytëzimi i minoreneve, braktisja e të moshuarve dhe të sëmurëve dhe forma të ndryshme të korrupsionit e veprimtarive kriminale. Në të njëjtën kohë, ato vende që mund të ishin vende të rëndësishme takimi dhe solidariteti shndërrohen shpesh në vende izolimi dhe mosbesimi të dyanshëm. Shtëpitë dhe lagjet ndërtohen më shumë për izolim dhe mbrojtje sesa për lidhje dhe integritet. Shpallja e Ungjillit do të jetë një bazë për restaurimin e dinjitetit të jetës njerëzore në këta kontekste sepse

Jezusi dëshiron të derdhë jetën me bollëk në qytetet tona (krh. Gjn 10,10). Ndjenja e plotë dhe uniformuar e jetës njerëzore që propozon Ungjilli është ilaçi më i mirë për sëmundjet e qyteteve tona, ndonëse ne duhet të kuptojmë që një program uniform dhe i përpiktë ungjillëzimi nuk i përgjigjet këtij realiteti kompleks. Por të jetuarit e jetës sonë plotësisht dhe të përballurit me çdo sfidë si një tharm i dëshmisë së Ungjillit në çdo kulturë dhe në çdo qytet do të na bëjë të krishterë të mirë dhe të japim frytë në qytetet tona.

II. TUNDIME TË VEPRIMTARËVE BARITORË

76. Ndjej një mirënjohje të madhe për tërë ata që janë të përkushtuar për të punuar për Kishën. Por nuk dua tani që të flas me hollësi për veprimtaritë e shërbyesve të ndryshëm baritorë, nga ipeshkvijtë deri te ata që kryejnë shërbesat nga më të përlulurat e të fshehura. Por do doja që të reflektoj mbi sfidat që ata duhet të ndeshin në kontekstin e kulturës sonë të globalizuar. Por për të qenë i drejtë, duhet të them së pari se kontributi i Kishës në botën e sotme është mjaft i madh.

Dhimbja dhe turpi që ndjejmë nga mëkatet e disa pjesëtarëve të Kishës dhe tonat, nuk duhet të na bëjë kurrë që të harrojmë sesa shumë të krishterë po japin jetën nga dashuria. Ata ndihmojnë aq shumë njerëz që të shërohen ose të vdesin në page në spitale të improvizuara. Ata janë pranë atyre që janë të skllavëruar nga vartësi të ndryshme në vendet më të varfra të botës. Ata u përkushtohen edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Kujdesen për pleqtë e braktisur dhe kërkojnë të gjejnë mënyra komunikimi të vlerave në mjedise jo miqësore. Ata janë të përkushtuar në shumë mënyra të tjera për të treguar një dashuri të pakufishme, të frymëzuar nga Hyji që u bë njeri. Unë jam mirënjohës për shembullin e mrekullueshëm që më japin shumë të krishterë të cilët i fllojnë me gëzim jetët dhe kohën e tyre. Kjo dëshmi më ngushëllon dhe më jep forcë në përpjekjet e mia për të mposhtur egoizmin dhe për ta dhënë krejtësisht veten.

77. Megjithatë si bij të kësaj epoke ne të gjithë jemi në një farë mënyre të prekur nga kultura ekzistuese e globalizuar që ndonëse na ofron vlera dhe mundësi të reja edhe mund të kufizojë, kushtëzojë dhe të na dëmtojë. Unë jam i vetëdijshëm që ne

duhet të krijojmë hapësira ku shërbyesit baritorë mund të ndihmohen dhe shërohen, “vende ku vetë feja në Krishtin e kryqëzuar dhe të ringjallur ripërtërihet, ku pyetjet më të thella dhe shqetësimet e përditshme ndahen, ku dallimi më i thellë mbi përvojat tona dhe vetë jetën, ndërmerret në dritën e Ungjillit, me qëllimin për të drejtuar vendimet individuale dhe shoqërore drejt së mirës dhe së bukurës”⁶². Në të njëjtën kohë dua të tërheq vëmendjen ndaj disa tundimeve të veçanta që kanë të bëjnë me shërbyesit baritorë.

Po ndaj sfidës së një spiritualiteti misionar

78. Sot ne po shohim te shumë veprimtarë baritorë, duke përfshirë burra e gra të përkushtuar, një shqetësim të çrregullt për lirinë dhe qetësinë e tyre personale, që i bën ta shohin punën e tyre thjesht si një shtojcë të jetës së tyre, sikur të mos ishte pjesë e identitetit të tyre. Në të njëjtën kohë, jeta shpirtërore identifikohet vetëm me disa ushtrime fetare që mund të ofrojnë vërtet një farë lehtësimi,

⁶² Azione Cattolica Italiana, Messaggio della XIV Assemblea Nazionale alla Chiesa ed al Paese (8 maj 2011).

por që nuk nxisin takimin me të tjerët, impenjimin në botë apo pasionin për ungjillëzimin. Si pasojë, te shumë veprimtarë ungjillëzimi, megjithëse luten, mund të shihet një individualizëm i theksuar, një krizë identiteti dhe një ftohje zelli. Këto janë të tre të këqijat që ushqejnë njëra-tjetrën.

79. Ka raste kur kultura e medias sonë dhe disa qarqe intelektuale përcjellin një skepticizëm të theksuar në lidhje me mesazhin e Krishtit, bashkë me një farë cinizmi. Si pasojë, shumë veprimtarë baritorë, megjithëse luten, zhvillojnë një farë kompleksi inferioriteti që i bën ata të relativizojnë ose fshehin identitetin e krishterë dhe bindjet e tyre. Kjo prodhon një rreth vicioz. Ata përfundojnë duke qenë të pakënaqur me atë që janë dhe atë që bëjnë e nuk ndjehen të identifikuar me misionin e tyre të ungjillëzimit, gjë që ua dobëson përkushtimin. Përfundojnë duke e mbytur gëzimin e misionit të tyre me një farë manie për të qenë dikush tjetër dhe për të zotëruar atë që ai zotëron. Shërbesa e tyre e ungjillëzimit bëhet kështu si diçka e detyrueshme dhe ata i kushtojnë pak energji dhe një kohë mjaft të kufizuar.

80. Shërbyesit baritorë mund të bien kështu pre

e relativizmit që pavarësisht nga mënyra e tyre e veçantë e përshpirtërisë ose mënyra e të menduarit, rezulton edhe më e rrezikshme sesa relativizmi doktrinor. Kjo ka të bëjë me vendimet më të thella që përcaktojnë formën e jetës. Ky relativizëm praktik konsiston në të vepruarit sikur Hyji të mos ekzistonte, duke marrë vendime të tilla sikur të varfrit nuk ekzistojnë, duke vendosur pikësynime sikur të tjerët nuk ekzistojnë, duke punuar sikur njerëzit që kanë marrë Ungjillin të mos ekzistojnë. Është për t'u vënë re që edhe ata që kanë bindje solide doktrimore dhe shpirtërore bien shpesh në një mënyrë të jetuari që të shpie në një lidhje ndaj sigurisë financiare ose një dëshire për pushtet apo lavdi njerëzore me çdo kusht, sesa duke ua dhënë të tjerëve në mision. Të mos ta lëmë veten që të na privojnë nga entuziazmi misionar!

Jo ndaj egoizmit dhe dembelizmit shpirtëror

Pikërisht në një kohë kur na duhet më shumë dinamizmi misionar që i sjell kripë e dritë botës, shumë laikë druhen se mund t'u kërkojnë të ndërmarrin ndonjë shërbesë apostolike dhe

kështu përpiqen të shmangin çdo përgjegjësi që mund t'u marrë kohën e lirë. Për shembull, është bërë shumë e vështirë sot të gjesh katekistë të përgatitur që janë të gatshëm për të ngulmuar në këtë shërbesë për disa vite. Diçka e ngjashme po ndodh edhe me meshtarët që janë të preokupuar me mbrojtjen e kohës së tyre të lirë. Kjo ndodh për shkak të faktit që njerëzit ndjejnë një nevojë imponuese për të ruajtur lirinë e tyre personale, sikur detyra e ungjillëzimit të ishte një helm i rrezikshëm dhe jo një përgjigje e gëzueshme ndaj dashurisë së Hyjit, që na thërret në mision dhe na bën të përmbushur dhe produktivë. Disa rezistojnë që t'i jepen krejtësisht misionit dhe përfundojnë në një gjendje dembelizmi paralizues.

82. Problemi nuk është gjithnjë një teprim veprimtarie, por më shumë një veprimtari që është ndërmarrë keq, pa motivim të përshtatshëm, pa një përshpirtmëri që do ta përshkonte atë dhe ta bënte të pëlqyeshme. Si rezultat, puna bëhet më e lodhshme sesa duhet dhe madje edhe sëmuren. Por kjo nuk është një lodhje e kënaqshme, por një lodhje tendosëse, e rëndë, e pakënaqshme që në fund sjell një lodhje të padurueshme. Ky

dembelizëm baritor mund të shkaktohet nga një sërë arsyes. Disa bien pre e tij sepse ndërmarrin projekte të parealizueshme dhe nuk janë të kënaqur që thjesht të bëjnë atë çfarë mund të bëjnë normalisht. Ndërsa disa të tjerë, meqë nuk e kanë durimin për të pritur evolucionin e vështirë të proceseve dhe presin që t'u bjerë çdo gjë nga qielli. Por ka edhe të tjerë që bien se janë të lidhur nga disa projekte ose ëndrra të kota suksesi, apo e kanë humbur kontaktin e mirëfilltë me njerëzit dhe e kanë depersonalizuar aq shumë punën e tyre saqë preokupohen më shumë me organizimin e projektit sesa me njerëzit. Ka dhe nga ata që bien në dembelizëm sepse nuk janë në gjendje të presin, por duan të dominojnë ritmin e jetës. Mania e sotme me rezultatet e menjëhershme e bën që punëtorët baritorë të durojnë me zor ndonjë kundërshtim, dështim të mundshëm, ndonjë kritikë apo kryq.

83. E kështu merr formë kërcënimi më i madh, që është: “pragmatizmi i hirtë i jetës së përditshme të Kishës, në të cilin gjithçka duket sikur shkon normalisht, ndërsa në realitet besimi po degeneron në një mendjengushtësi

apo meskitet⁶³. Zhvillohet kështu psikologjia e varrit që i shndërron me ngadalë të krishterët në mumie muzeu. Zhgënjyer me realitetin, me Kishën dhe me veten, ata provojnë një tundim të vazhdueshëm ndaj një trishtimi të ëmbël e pa shpresë që e pushton zemrën si “bari çudibërës më i çmuar i djallit”⁶⁴. Të thirrur për të rrezatuar dritë dhe për të përcjellë jetë, në fund ata e lënë veten që të joshen nga gjërat që prodhojnë vetëm errësirë dhe rraskapitje të brendshme e dalëngadalë e dobësojnë zellin apostolik. Ndaj gjithë kësaj po e them përsëri: të mos lejojmë që të na privojnë nga gëzimi i ungjillëzimit!

Jo ndaj një pesimizmi steril

84. Gëzimi i Ungjillit është i tillë që nuk mund të na hiqet nga askush e nga asgjë (krh. Gjn 16,22). Të

⁶³ J. Ratzinger, *Gjendja aktuale e besimit dhe teologjisë*. Konferencë e dhënë gjatë takimit të presidentëve të komisioneve ipeshkvore amerikano-latine për Doktrinën e Fesë, mbajtur në Guadalajara, Meksikë, 1996. Publikuar në L'Osservatore Romano, 1 Nëntor 1996; cituar në: Konferencën e Përgjithshme të ipeshkvijve amerikano-latinë dhe të karaibeve, *dokumenti Aparecida*, 29 qershor 2007.

⁶⁴ G. Bernanos, *Journal d'un curé de campagne*, Paris, 1974, 135.

këqijat e botës sonë dhe ato të Kishës, nuk duhet të shërbejnë si pretekst për të pakësuar përkushtimin dhe zellin. Le t'i shohim ato si sfida që mund të na ndihmojnë të rritemi. Ne mund të shohim me sytë e besimit dritën që e rrezaton gjithnjë Shpirti i Shenjtë në mes të errësirës, pa harruar asnjëherë se “kur u shumëzua mëkati, shumë më i begatshëm u bë hiri” (Rom 5,20). Besimi ynë sfidohet për të dalluar sesi mund të shndërrohet vera në ujë dhe gruri të rritet në mes të egjërës. Pesëdhjetë vite pas Koncilit II të Vatikanit, ndonëse jemi të shqetësuar nga mjerimet e kësaj epoke dhe jemi shumë larg optimizmit naiv, megjithatë fakti që jemi më realistë nuk duhet të nënkuptojë se besojmë më pak te Shpirti apo se jemi më pak bujarë. Në këtë kuptim, ne mund të dëgjojmë përsëri fjalët e të lumit Gjoni XXIII-të ditën e paharrueshme të 11 tetorit 1962: “Ka raste kur na duhet të dëgjojmë me keqardhje zërat e atyre të cilët, ndonëse digjen nga zelli, u mungon një ndjenjë objektiviteti dhe maturie. Në këtë epokë moderne ata nuk shohin gjë tjetër përveç mjerimit dhe rrënimit... Ne mendojmë se duhet të mos pajtohemi me profetët e vdekjes që gjithnjë parashikojnë fatkeqësi, a thua se fundi i botës të ishte afër. Në kohën tonë,

providenca hyjnore po na shpie në një rend të ri të marrëdhënive njerëzore, të cilat me anë të përpjekjeve njerëzore dhe përtej çdo pritjeje, janë drejt përmbushjes së planeve të pahulumtueshme të Zotit, në të cilat gjithçka, madje edhe ngjarjet e pakëndshme, të çojnë në të mirën e madhe të Kishës”⁶⁵

85. Një nga tundimet më serioze që e ndrydh guximin dhe zellin është një disfatizëm që na shndërron në pesimistë të pakënaqur dhe të zhgënjyer me “fytyrë të ngrysët”. Askush nuk mund të shkojë në luftë pa qenë i bindur plotësisht më parë për fitore. Nëse fillojmë pa besim, atëherë pothuajse e kemi humbur betejën dhe i kemi groposur në dhe talentet tona. Megjithëse jemi mjaft të vetëdijshëm për dobësitë tona, ne duhet të vazhdojmë përpara pa u dorëzuar, duke pasur parasysh atë që Zoti i tha Shën Palit: “Të mjafton hiri im, sepse fuqia përsoset në ligështi” (2 Kor 12,9). Triumfi i krishterë është gjithnjë një kryq, e megjithatë një kryq që është në të njëjtën kohë edhe një flamur fitimtar i cili ngrihet me një butësi

⁶⁵ Fjalimi i hapjes së Vatikanit II (11 tetor 1962): 4, 2-4: AAS 54 (1962), 789.

luftarake kundër sulmeve të të ligut. Shpirti i keq i disfatzimit është vëlla me tundimin e ndarjes para kohës së grurit nga egjra e është produkt i një mungese shqetësuese dhe egoiste të mosbesimit.

86. Në disa vende ka ndodhur një farë “shkretimi” si pasojë e përpjekjeve të disa shoqërive për të ndërtuar pa Zotin, ose për të eliminuar rrënjët e tyre të krishtera. Në këta vende “bota e krishterë po bëhet sterile, dhe po konsumohet si një tokë e mbishfrytëzuar që po shndërrohet në shkretëtirë”⁶⁶. Në vende të tjera, kundërshtimi i dhunshëm ndaj Krishtërit i detyron të krishterët që ta mbajnë të fshehur besimin e tyre në atdheun e tyre të dashur. Kjo është një tjetër lloj shkretëtire e dhimbshme. Por familja dhe vendi i punës mund të jenë gjithashtu një vend i thatë ku besimi duhet të ruhet dhe përcillet. Megjithatë “pikërisht nga përvoja e kësaj shkretëtire, nga kjo zbrazëtitë mund të rizbulojmë gëzimin e të besuarit dhe rëndësinë jetike që ka për ne, burra e gra. Në shkretëtirë ne rizbulojmë vlerën e asaj që është esenciale për të jetuar. Në botën e sotme kemi pra

⁶⁶ J.H. Newman, Letër e 26 janarit 1833, në Letrat e Ditarët e Xhon Henri Njuman-it, vol. III, Oxford, 1979, 204.

shenja të panumërta, të cilat shprehin shpesh në formë të nënkuptuar ose negative etjen për Hyjin ose qëllimin kryesor të jetës. Dhe në shkretëtirë nevojiten njerëz të besimit, të cilët me shembullin e jetës së tyre na drejtojnë te Toka e premtuar dhe e mbajnë të gjallë shpresën”⁶⁷. Në këto situata ne jemi të thirrur për të qenë burime të gjalla uji prej nga mund të pinë njerëzit. Disa herë kjo përbën edhe një kryq të rëndë, por pikërisht në kryq, ku Zoti i ynë u shpua duke na e dhënë veten si burim uji të gjallë. Mos lejojmë që të na e marrin shpresën!

Po ndaj marrëdhëniet e reja që sjell Krishti

87. Sot kur rrjetet dhe mjetet e komunikimit njerëzor kanë bërë përparime të jashtëzakonshme, ne e ndjejmë sfidën e të gjeturit dhe përcjelljen e një “mistike” të të jetuarit së bashku, duke u shkrirë dhe duke takuar, duke përqafuar dhe duke mbështetur njëri-tjetrin, duke u përballur me baticën që duke qenë kaotike mund të kthehet

⁶⁷ Benedikti XVI, Homeli e mbajtur në Meshën me rastin e nisjes së Vitit të Fesë (11 tetor 2012): AAS 104 (2012), 881.

në një përvojë të mirëfilltë vëllazërie, një karvan solidariteti, një pelegrinazh i shenjtë. Kështu mundësitë më të mëdha për komunikim kthehen në mundësi më të mëdha takimi dhe solidariteti për të gjithë. Nëse do të ishim në gjendje që ta merrnim këtë rrugë, do të ishte diçka e mirë, qetësuese, çliruese dhe shpresëdhënëse! Të dalim nga vetja dhe të bashkohemi me të tjerët është diçka e shëndetshme për ne. Të mbyllesh në vetvete do të thotë të shijosh helmin e hidhur të imanencës, pra të të mbeturit në vend, dhe njerëzimi do të jetë më keq për çdo zgjedhje egoiste që bëjmë.

88. Ideali i krishterë do të jetë gjithnjë një ftesë për të mposhtur dyshimin, mosbesimin e vazhdueshëm, frikën e humbjes së intimitetit tonë dhe të gjitha qëndrimet vetëmbrojtëse që na imponon bota e sotme. Shumë njerëz përpiqen të largohen nga të tjerët dhe gjejnë strehë në ngushëllimin e privatësisë ose në një rreth të ngushtë miqsh, duke hequr dorë nga realizmi i aspektit shoqëror të Ungjillit. Sepse ashtu si disa njerëz duan një Krisht krejt shpirtëror, pa mish e pa kryq, ata duan po ashtu edhe marrëdhëniet e tyre ndërpersonale të siguruar nga pajisje të sofistikuara, si monitorë

dhe sisteme që mund të ndizen e të shuhen me komandim. Ndërkohë, Ungjilli na tregon vazhdimisht që të ndërmarrim riskun e përballjes fizike me të afërmin që na sfidon, me dhimbjet dhe lutjet e tyre, me gëzimin e tyre që na infekton në ndërveprimin tonë të afërt dhe të vazhdueshëm. Besimi i vërtetë në Birin e mishëruar të Hyjit është i pandashëm nga vetë-dhënia, nga përkatësia në komunitet, nga shërbimi e pajtimi me të tjerët. Biri i Hyjit, duke u bërë njeri, na thirri te revolucioni i butësisë.

89. Izolimi, që është një version i të qenit imanent mund të gjejë shprehje në një autonomi të rreme që e përjashton Hyjin. Por në sferën e besimit mund të marrë edhe formën e një konsumizmi shpirtëror, produkt i individualizmit të sëmurë. Kthimi te e shenjta dhe kërkimi për spiritualitetin që karakterizon kohën tonë janë fenomene të megjullta. Sot sfida jonë nuk është aq shumë ateizmi sesa nevoja për t'iu përgjigjur si duhet etjes së njerëzve për Hyjin, e jo të përpiqen ta shuajnë atë me zgjidhje të tjetërsuara ose me një Jezus pa mish, që nuk na kërkon asgjë në lidhje me të afërmin tonë. Nëse këta njerëz nuk gjejnë

në Kishë një dimension shpirtëror që mund të ofrojë shërim dhe çlirim dhe mund t'i mbushë me jetë e paqe, ndërkohë që i thërret ndaj bashkësisë vëllazërore dhe frytshmërinë misionare, ata do të mashtrohen në fund nga zgjidhje që as nuk e trajtojnë jetën njerëzore me dinjitet e as nuk i japin lavdi Hyjit.

90. Format e duhura të religjiozitetit popullor janë të mishëruara, duke qenë se kanë lindur nga mishërimi i besimit të krishterë në kulturën popullore. Për këtë arsye ato përfshijnë një marrëdhënie personale, jo me energji apo fuqi të turbullta shpirtërore por me vetë Hyjin, me Krishtin, me Marinë, e me shenjtërit. Këto përshpirtmëri kanë mish dhe fytyrë dhe janë në gjendje të ushqejnë marrëdhënie dhe jo thjesht të mundësojnë arratisje individualiste. Në pjesë të tjera të shoqërisë ne shohim tërheqjen në rritje ndaj formave të ndryshme të një "spiritualiteti mirëqenieje" që është i ndarë nga jeta e bashkësisë, ose ndaj një "teologjie begatie", e shkëputur nga përgjegjësia ndaj vëllezërve e motrave tona, ose ndaj përvojave subjektive pa fytyrë njeriu, të cilat

nuk janë asgjë më shumë sesa një formë egoizmi.

91. Një sfidë e rëndësishme është të tregosh se zgjidhja nuk do të gjendet kurrë në largimin nga një marrëdhënie e përkushtuar dhe personale me Hyjin, që në të njëjtën kohë na dedikon t'u shërbejmë të tjerëve. Kjo ndodh shpesh në ditët e sotme, meqenëse besimtarët përpiqen të fshihen ose të veçohen nga të tjerët, apo të kalojnë në heshtje nga një vend në tjetrin, ose nga një detyrë në tjetrën, pa krijuar lidhje të thella e të qëndrueshme: "Imaginatio locorum et mutatio multos fefellit"⁶⁸. Ky është një shërim i rremë që e gjymtojnë zemrën dhe disa herë edhe trupin. Ne duhet të ndihmojmë të tjerët që të kuptojnë se e vetmja mënyrë është të mësojnë sesi të përballen me të tjerët në mënyrën e duhur, që do të thotë t'i pranosh dhe çmosh ata si shokë të udhës, pa asnjë kundërshtim të brendshëm. Do të thotë të mësosh të gjesh Jezusin në fytyrat e të tjerëve, në zërat dhe lutjet e tyre. Dhe të mësosh të vuash në përqafimin e Jezusit të kryqëzuar sa herë që sulmohemi padrejtësisht ose ndeshim mosmirënjohje, pa u

⁶⁸ Thomas À Kempis, *De Imitatione Christi*, Lib. I, IX, 5: "Të ënderruarit e vendeve të ndryshme dhe duke u endur nga një vend në tjetrin, ka mashtruar shumë veta".

lodhur kurrë nga vendimi ynë për të jetuar në vëllazëri⁶⁹.

92. Atje e gjejmë shërimin e vërtetë, meqenëse mënyra për t'u lidhur me të tjerët që shëron me të vërtetë është një vëllazëri mistike dhe soditëse. Një dashuri vëllazërore që është në gjendje të shohë madhështinë e shenjtë të të afërmit tonë, të gjejë Hyjin në çdo qenie njerëzore, të durojë ngacmimet e jetës, duke u kapur fort pas dashurisë së Zotit dhe di sesi t'ia hapë zemrën dashurisë hyjnore dhe kërkon lumturinë e të tjerëve siç bën Ati i tyre qiellor. Pikërisht në këtë epokë, dhe sidomos aty

⁶⁹ Ne mund të përfitojmë nga dëshmia e Shën Terezës së Lis-jësë, që flet për një përvojë të brendshme që pati një ndikim vendimtar në marrëdhënien që kishte me një farë motre me të cilën nuk shkonte mirë: "Pasditen e një dimri po merresha si zakonisht me detyrën time modeste për motrën Saint Pierre. Bënte ftohtë dhe po errej...Papritmas dëgjova në largësi tingujt e harmonishëm të një vegle muzikore. Fillova të përftyroj një dhomë të ndriçuar mirë, veshur me ar dhe në të disa zonjusha të veshura me elegancë po shkëmbenin komplimente dhe kortezi mondane. Pastaj pashë gruan e ngratë të sëmurë për të cilën kujdesesha. Në vend të melodisë, unë dëgjova rënkimet e saj të trishtueshme...Nuk mund ta përshkruaj dot se çfarë ndodhi në shpirtin tim. Por di vetëm që Zoti e ndiçoi atë me rrezet e të vërtetës që e tejkalonin vezullimin regëtues të kënaqësive tokësore, saqë nuk e besoja dot sa e lumtur ndjehesha" (Ms. C, 29v-30r, in Oeuvres Complètes, Paris, 1992, 274-275).

ku ka një "tufë të vogël" (Lk 12,32), dishepujt e Zotit janë të thirrur për të jetuar si një bashkësi që është kripa e tokës dhe drita e botës (krh. Mt 5,13-16). Ne jemi të thirrur për të dëshmuar ndaj një udhe vazhdimisht të re të të jetuarit së bashku në besnikëri ndaj Ungjillit⁷⁰. Të mos lejojmë që të na e marrin bashkësinë!

Jo ndaj mondanitetit shpirtëror

93. Mondaniteti shpirtëror që fshihet pas dukjes së besimit dhe madje edhe dashurisë për Kishën konsiston në të mos kërkuarit të lavdisë së Zotit por lavdinë njerëzore dhe mirëqenien personale. Pikërisht për këtë shpirt i qortonte Zoti farisenjtë: "Po si mund të besoni ju, ju që kërkonit lavdi prej njëri-tjetrit, e nuk e kërkonit lavdinë që vjen prej Një Hyji të vetëm?" (Gjn 5,44). Është fjala për një mënyrë të stërholluar për të kërkuar "interesat vetjake dhe jo ato të Jezu Krishtit" (Fil 2,21), që merr shumë forma, në vartësi të llojeve të personave dhe grupeve në të cilët depërton. Meqenëse bazohet mbi dukjet e kultivuara me

⁷⁰ Shih *Propositio* 8.

kujdes, nuk është gjithnjë e lidhur me mëkatin e jashtëm dhe nga jashtë çdo gjë duket në rregull. Por nëse arrin të futet në Kishë “do të ishte shumë më katastrofike sesa çdo lloj tjetër mondaniteti që është thjesht moral”⁷¹.

94. Ky mondanitet mund të ushqehet në dy mënyra të lidhura ngushtë. Njëra është tërheqja e agnosticizmit, një besim krejt subjektiv, interesi i vetëm i të cilit është një farë përvoje ose një seri idesh dhe arsyetimesh që duhet të ngushëllojnë dhe ndriçojnë, por që në fakt e mbajnë dikë të izoluar në mendimet e ndjenjat e veta. Ndërsa tjetra është neopelagjianizmi prometeian vetëreferencial i atyre që besojnë në aftësitë e tyre dhe ndjehen superiorë ndaj të tjerëve sepse ndjekin disa rregulla të caktuara ose u qëndrojnë jashtëzakonisht besnikë një stili të veçantë katolik të së kaluarës. Ajo që shihet si një siguri doktrinale ose disiplinore të çon në një elitizëm narcizist dhe autoritar, në të cilin në vend të ungjillëzimit, bëhet thjesht një analizë dhe kategorizim i të tjerëve dhe në vend që t’i hapet dera hirit, konsumohen

energjitë në inspektim dhe verifikim, pa u interesuar fare as për Krishtin e as për të tjerët. Këto janë shfaqje të një imanentizmi antropocentrik. Është e pamundur që të mendohet se një shtytje e vërtete ungjillëzuese mund të rezultojë nga këto forma të falsifikuara të Krishtërit.

95. Ky mondanitet i errët shfaqet në një mori qëndrimesh që duken si kundërshtuese e megjithatë të gjitha pretendojnë se “zotërojnë hapësirën e Kishës”. Në disa njerëz ne shohim një preokupim sa për t’u dukur ndaj liturgjisë, doktrinës dhe prestigjit të Kishës, por pa u shqetësuar që të merren me nevojat konkrete të kohës dhe që Ungjilli të ketë një ndikim të vërtetë mbi popullin e Hyjit. Në këtë mënyrë, jeta e Kishës kthehet në një artikull muzeu apo diçka që është pronë vetëm e pak vetave. Kurse në të tjerë, ky mondanitet shpirtëror fshihet pas një joshjeje pas fitimeve shoqërore dhe politike ose pas krenarisë së lidhur me administrimin e gjërave praktike ose pas një manie ndaj programeve vetëvlerësuese dhe vetëpërmbushjeje. Kjo mund të shpjegohet në një preokupim që të duken se përfshihen në jetën shoqërore plot me takime, udhëtime, darka

⁷¹ H. De Lubac, *Méditation sur l'Église*, Paris, 1968, 321.

dhe bankete. Shpjegohet edhe në një mendësi administruese, plot me statistika, plane dhe vlerësime, përfituesi më i madh i të cilave nuk është populli i Hyjit por Kisha si një institucion. Shenja e Krishtit të mishëruar, kryqëzuar dhe të ringjallur nuk është e pranishme. Formohen grupe të mbyllura përbërë prej elitës dhe asnjë përpjekje nuk bëhet për të dalë e kërkuar ata që janë larg ose turmat e panumërta që kanë etje për Krishtin. Vetëkënaqësia e zbrazët i zë vendin zellit të Ungjillit.

96. Kjo mënyrë të menduari e ushqen kotësinë e atyre që janë të kënaqur për të pasur një farë pushteti dhe preferojnë që të jenë gjeneralë në një ushtri të mundur sesa ushtarë të thjeshtë në një skuadër që po lufton. Sa shpesh ëndërrojmë projekte të mëdha apostolike, të përpikta, si ato të gjeneralëve që kanë pësuar disfatë! Por kjo do të thotë të mohosh historinë tonë si një Kishë, që është e lavdishme pikërisht si një histori sakrificash, shpresash dhe konfliktesh të përditshme, të jetëve të shpenzuara në shërbim dhe ngulmimi në punë të mundimshme, sepse çdo punë është fryt i “djersës së ballit”. Përkundrazi, ne e humbasim

kot kohën duke folur “për atë që duhet bërë”, ose siç e quajmë ndryshe, mëkati i “asaj që duhet bërë” si mjeshtra shpirtërorë dhe ekspertë baritorë që japin udhëzime nga larg. Ne e kultivojmë imagjinatën tonë pa kufi dhe humbim çdo kontakt me jetën reale dhe vështirësitë e besimtarëve.

97. Ata që kanë rënë në këtë mondanitet shikojnë nga lart e nga larg, duke mohuar profecinë e vëllezërve e motrave të tyre, duke diskredituar ata që ngrenë pyetje, duke treguar me gisht gjithë kohën gabimet e të tjerëve dhe janë të mbërthyer nga dukja e jashtme. Zemrat e tyre janë të hapura vetëm ndaj horizontit të kufizuar të imancencës dhe interesave të tyre dhe si pasojë ata as nuk mësojnë nga mëkatet e tyre e as nuk janë të hapur me të vërtetë nga falja. Ky është një korrupsion i tmerrshëm që maskohet si diçka e mirë. Ne duhet ta shmangim atë duke bërë që Kisha të dalë vazhdimisht nga vetja, duke pasur si fokus të misionit Jezui Krishtin dhe përkushtimin ndaj të varfërve. Zoti na shpëtoftë nga një Kishë mondane me mbulesa të një përshtypshmërie apo të një shërbese baritore! Ky mondanitet mbytet mund të shërohet duke thithur ajrin e pastër të

Shpirtit të Shenjtë që na çliron nga vetëfokusimi që mbulohet nën petkun e një shpirti fetar që nuk e përmban Zotin. Të mos lejojmë që të na marrin Ungjillin!

Jo ndaj luftës në mes nesh

98. Sa shumë luftëra ndodhin brenda popullit të Hyjit dhe në bashkësitë tona të ndryshme! Sa shumë luftëra në lagjet ku banojmë dhe në vendet e punës, të shkaktuara nga smira dhe xhelozia, madje edhe në mes të krishterëve! Mondaniteti shpirtëror i shtyn disa të krishterë që të luftojnë me të krishterë të tjerë të cilët i pengojnë në kërkimin tyre për pushtet, prestigj, kënaqësi dhe siguri ekonomike. Disa nuk janë më të kënaqur që të jetojnë si pjesë e bashkësisë më të madhe të Kishës duke krijuar një shpirt përjashtues. Në vend që t'i përkasim tërë Kishës me larminë e saj të pasur, ata i përkasin njërit apo tjetrit grup që ndjehet ndryshe apo i veçantë.

99. Bota jonë po masakrohet nga luftëra e dhunë dhe është plagosur nga një individualizëm i

përhapur gjerësisht që i përçan qeniet njerëzore, duke i vënë kundër njëri-tjetrit ndërsa ndjekin mirëqenien e tyre. Në vende të ndryshme, konfliktet dhe përçarjet e vjetra të së kaluarës janë duke u rishfaqur. U kërkoj veçanërisht të krishterëve të komuniteteve në mbarë botën që të japin një dëshmi tërheqëse dhe rrezatuese të bashkësisë vëllazërore . Të gjithë le ta admirojnë sesi kujdeseni për njëri-tjetrin dhe si i inkurajoni dhe shoqëroni njëri-tjetrin: “Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do t’ju njohin se jeni nxënësit e mi” (Gjn 13,35). Kjo ishte lutja e zjarhtë që Jezusi i bëri Atit: “që të gjithë të jenë një... në ne...që ta kuptojë bota se ti më dërgove” (Gjn 17,21). Ruhuni nga tundimet e xhelozisë! Ne jemi të gjithë në të njëjtën barkë dhe po shkojmë drejt të njëjtit port! Le të kërkojmë hirin që të gëzohemi në dhuratat e secilit që u përkasin në fakt të gjithëve.

100. Ata që janë të plagosur nga ndarjet historike dhe e kanë të vështirë që të pranojnë ftesën tonë për falje dhe pajtim, meqenëse mendojnë se po e shpërfillim dhimbjen e tyre ose po iu kërkojmë që të heqin dorë nga kujtesa dhe idealet e tyre. Por nëse ata shohin dëshminë e bashkësive që janë vërtet

vëllazërore dhe të pajtuara, atëherë kjo dëshmi do të jetë ndriçuese dhe tërheqëse për ta. Gjithnjë shqetësohem kur shoh sesi disa komunitete të krishtera dhe madje edhe persona të kushtuar tolerojnë forma të ndryshme armiqësie, përçarjeje, shpifjesh, përflasjeje, hakmarrjeje, xhelozie dhe dëshire për të imponuar me çdo kusht disa ide, madje duke arritur në përndjekje të tilla që duken si një gjueti e pamëshirshme shtrigash. Kë do të ungjillëzojmë nëse veprojmë në këtë mënyrë?

101. Le t'i kërkojmë Zotit që të na ndihmojë të kuptojmë ligjin e dashurisë. Sa mirë është ta kesh këtë ligj! Sa mirë na bën ta duam njëri-tjetrin, pavarësisht se çfarë ndodh. Po, pavarësisht se çfarë ndodh! Fjala nxitëse e Shën Palit i drejtohet secilit prej nesh: “Mos lejo të të mundë e keqja, por ngadhënje mbi të keqen me vepra të mira!” (Rom 12,21). Dhe përsëri: “Mos të lodhemi kurrë duke bërë mirë” (Gal 6,9). Ne të gjithë kemi pëlqimet dhe mospëlqimet tona dhe ndoshta jemi të zemëruar tani që po flasim me dikë. Së paku le t'i themi Zotit: “Unë jam i zemëruar me këtë person apo me atë person. Unë po të lutem për këtë person”. Të lutesh për një person që na irriton është një hap

i mrekullueshëm përpara në dashuri dhe një akt ungjillëzues. Le ta bëjmë këtë sot! Të mos lejojmë që të marrin idealin e dashurisë vëllazërore!

Sfida të tjera kishtare

102. Laikët përbëjnë shumicën dërrmuese të popullit të Hyjit. Pakica që përbëhet nga ministrat e shuguruar janë në shërbim të tyre. Është rritur gjithnjë e më shumë vetëdija për identitetin dhe misionin e laikëve në Kishë. Ne mund të përfshijmë një numër të madh laikësh që kanë një ndjenjë të fortë komuniteti dhe besnikëri të madhe ndaj detyrës së dashurisë, katekizmit dhe kremtimit të fesë. Në të njëjtën kohë, vetëdija e qartë ndaj kësaj përgjegjësie të laikëve, e themeluar në pagëzimin dhe krezmimin e tyre nuk shfaqet në të njëjtën mënyrë në çdo vend. Në disa raste kjo ndodh sepse laikët nuk e kanë marrë formimin e nevojshëm për të ndërmarrë përgjegjësi të ndryshme, kurse në raste të tjera ndodh sepse në kishat e tyre nuk është krijuar hapësirë që ata të flasin e të veprojnë, për shkak të një klerikalizmi të tepruar që i pengon të marrin vendime. Megjithatë shumë veta janë

të përfshirë në shërbesat e laikëve, kjo përfshirje nuk pasqyrohet në një penetrim më të madh të vlerave të krishtera në sektorët shoqërorë, politikë dhe ekonomikë. Shërbesa e laikëve shpesh lidhet pas detyrave brenda kishës, pa një përkushtim të vërtetë ndaj zbatimit të Ungjillit për transformimin e shoqërisë. Formimi i laikëve dhe ungjillëzimi i jetës profesionale dhe intelektuale paraqesin një sfidë domethënëse baritore.

103. Kisha e pranon kontributin e domosdoshëm të gruas në shoqëri për shkak të ndjeshmërisë, intuitës dhe aftësive të tjera të veçanta të cilat i karakterizojnë më shumë. Mendoj për shembull për vëmendjen e veçantë që gratë u kushtojnë të tjerëve, që gjen një shprehje të veçantë, për të mos thënë ekskluzive të të qenit nënë. Shoh me kënaqësi sesi shumë gra i ndajnë përgjegjësitë baritore e me meshtarët, duke i ndihmuar që të udhëheqin besimtarët, familjet dhe grupet e ndryshme dhe duke ofruar kontribut të vazhdueshëm ndaj reflektimeve teologjike. Por ne duhet të krijojmë mundësi edhe më të mëdha për një përfshirje edhe më të gjerë të femrës në Kishë. Duke qenë se “gjenia femërore nevojitet në të gjitha aspektet

e jetës shoqërore; për këtë arsye prania e grave duhet të garantohet edhe në vendin e punës”⁷² dhe në ambiente të tjera ku merren vendime të rëndësishme, si në Kishë ashtu edhe në strukturat shoqërore.

104. Kërkesat për respektimin e të drejtave legjitime të grave, të bazuara në bindjen e patundur mbi dinjitetin e barabartë të burrave e grave i paraqesin Kishës çështje të thella dhe sfidauese të cilat nuk mund të anashkalohen lehtë. Rezervimi i priftërisë ndaj meshkujve, si një shenjë e Krishtit Dhëndër që e jep veten në Eukaristi, nuk është e hapur për diskutim, por mund të rezultojë përçarëse nëse pushteti sakramental identifikohet me pushtetin në përgjithësi. Duhet të kemi parasysh se kur flasim për pushtet sakramental “ne ndodhemi brenda sferës së funksionit dhe jo asaj të dinjitetit të shenjtërisë”⁷³. Megjithëse priftëria ministeriale është një mjet i përdorur nga Jezusi për shërbimin e popullit të tij, dinjiteti ynë më i madh rrjedh nga pagëzimi që është i

⁷² Konkili pontifikal për drejtësi dhe paqe, *Përmbledhje e doktrinës shoqërore të Kishës*, 295.

⁷³ Gjon Pali II, Porosia post-sinodale apostolike *Christifideles Laici* (30 dhjetor 1988), 51: AAS 81 (1989), 413.

mundshëm për të gjithë. Konfigurimi i meshtarit ndaj Krishtit si Kreu, si burimi kryesor i hirit, nuk aludon për një lartësim që e ngre atë mbi të tjerët. Në Kishë, funksionet “nuk e favorizojnë epërsinë e disave mbi të tjerët”⁷⁴. Në fakt, një grua, Maria, është më e rëndësishme sesa ipeshkvijtë. Edhe kur funksioni i priftërisë ministeriale konsiderohet “hierarkik”, duhet të kujtojmë që “është caktuar krejtësisht për shenjtërinë e pjesëtarëve të Krishtit”⁷⁵. Çelësi dhe boshti i tij nuk është pushteti i kuptuar si dominim, por pushteti për të administruar sakramentet e eukaristisë që është dhe zanafilla e autoritetit të tij i cili është gjithnjë një shërbim ndaj popullit të Zotit. Kjo paraqet një sfidë të madhe për barinjtë dhe teologët që janë në gjendje për të dalluar më mirë se çfarë përfshin kjo në lidhje me rolin e mundshëm të gruas për sa i përket vendimmarrjes në sfera të ndryshme të Kishës.

⁷⁴ Kongregacioni për doktrinën e fesë, deklarata *Inter Insigniores* mbi çështjen e pranimi të grave në shërbesën meshtarake (15 October 1976): AAS 68 (1977) 115, cituar te : Gjon Pali II, Porosia postsinodale apostolike *Christifideles Laici* (30 dhjetor 1988), 51 (shënimi 190); AAS 81 (1989), 493.

⁷⁵ Gjon Pali II, Letra Apostolike *Mulieris Dignitatem* (15 gusht 1988), 27: AAS 80 (1988), 1718.

105. Shërbesa baritore me të rinjtë siç jemi mësuar ta zhvillojmë, ka qenë nën ndikimin e ndryshimeve shoqërore. Të rinjtë shpesh nuk arrijnë të gjejnë përgjigje ndaj shqetësimeve, nevojave, problemeve dhe lëndimeve të tyre në strukturat e zakonshme. Si të rritur, ne e kemi të vështirë që t'i dëgjojmë ata me durim e t'i vlerësojmë shqetësimet e kërkesat e tyre dhe t'u flasim me një gjuhë që mund ta kuptojnë. Për këtë arsye, përpjekjet tona në fushën e edukimit nuk prodhojnë rezultatet e dëshiruara. Të shfaqurit e rritja e shoqërive dhe lëvizjeve që përbëhet më së shumti nga të rinjtë mund të shihet si vepër e Shpirtit të Shenjtë që hap shtigje të reja në përputhje me pritjet e tyre dhe kërkimin për një përshtypshmëri të thellë dhe një ndjenjë më të madhe reale të përkatësisë. Por megjithatë është e nevojshme një pjesëmarrje më e qëndrueshme e këtyre shoqërive brenda përpjekjeve të përgjithshme baritore të Kishës⁷⁶.

106. Ndonëse nuk është gjithnjë e lehtë t'u afrohesh të rinjve, është bërë përparim në dy aspekte: në vetëdijen sipas së cilës i tërë komuniteti thirret të ungjillëzojë dhe të edukojë të rinjtë

⁷⁶ Shih *Propositio* 51.

dhe nevojën urgjente që të rinjtë të ushtrojnë një protagonizëm më të madh. Ne duhet ta pranojmë se pavarësisht nga kriza aktuale e përkushtimit dhe marrëdhënieve komunitare shumë të rinj po ofrojnë ndihmën e tyre solidare përkundrejt problemeve të botës sonë dhe po ndërmarrin forma të ndryshme aktivizmi dhe shërbese vullnetare. Disa marrin pjesë në jetën e Kishës si pjesëtarë të grupeve të shërbimit dhe të nismave të ndryshme në dioqezat e tyre dhe në vende të tjera. Sa bukur është të shohësh të rinj “duke predikuar në rrugë”, të kënaqur për të sjellë Krishtin në çdo rrugë, në çdo shesh dhe në çdo qoshe të botës!

107. Shumë vende po përjetojnë mungesën e thirrjeve ndaj meshtarisë dhe jetës së kushtuar, gjë që ndodh shumë herë për shkak të mungesës së zjarrit ngjithës apostolik në komunitete, e cila shkakton në ftohjen e entuziazmit dhe të qenit tërheqës. Aty ku ka jetë, zell dhe dëshirë për të sjellë Krishtin te të tjerët, do të rezultojnë thirrje të vërteta. Edhe në ato famulli në të cilat meshtarët nuk janë të përkushtuar apo të gëzueshëm, jeta vëllazërore dhe zjarri i komunitetit mund të zgjojë tek të rinjtë një dëshirë për t’ia kushtuar krejtësisht

jetën Hyjit dhe predikimit të Ungjillit. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse një bashkësi e gjallë lutet me ngulmim për thirrje dhe u propozon me guxim të rinjve rrugën e kushtimit të veçantë. Nga ana tjetër, pavarësisht nga rrallimi i thirrjeve, sot ne po bëhemi më të vetëdijshëm për një proces më të mirë të përzgjedhjes së kandidatëve për meshtari. Seminarët nuk mund të pranojnë kandidatë në bazë të çfarëdo motivi, sidomos nëse këta motivime kanë të bëjnë me pasigurinë emocionale ose ndjekjen e karrierës, të lavdisë njerëzore ose mirëqenien ekonomike.

108. Siç kam thënë më lart, nuk kam dashur që të ofroj një diagnozë të plotë por i ftoj komunitetet që t’i plotësojnë dhe pasurojnë këto perspektiva në bazë të vetëdijes së tyre për sfidat me të cilat përballen ata dhe të afërmit e tyre. Unë shpresoj që duke e bërë këtë, ata do të kuptojnë sesa herë që përpiqemi t’i lexojmë shenjat e kohës është e dobishme që të dëgjojmë të rinjtë dhe të moshuarit. Të dy brezat paraqesin një burim shprese për çdo njeri. Ndërsa të moshuarit sjellin kujtesën dhe urtësinë e përvojën, që na paralajmëron për të mos i përsëritur marrëzisht gabimet e kaluara, të

rinjtë na thërrasin drejt një shprese të ripërtërirë dhe të gjerë, sepse na paraqesin një drejtim të ri për njerëzimin dhe na hap drejt së ardhmes, në mënyrë që të mos t'i ngjitemi nostalgjisë për struktura dhe tradita që nuk janë më jetëdhënëse në botën e sotme.

109. Sfidat ekzistojnë për t'u mposhtur! Le të jemi realistë por pa e humbur gëzimin, guximin dhe përkushtimin tonë të mbushur me shpresë. Të mos lejojmë që të na marrin vrullin apo zellin misionar!

KREU III

SHPALLJA E UNGJILLIT

110. Pasi kam marrë në konsideratë disa nga sfidat e sotme, do të doja që të flisja për detyrën që vlen për çdo epokë dhe vend, sepse “nuk mund të ketë ungjillëzim të vërtetë pa shpalljen e qartë të Jezusit si Zot” dhe pa përparësinë e shpalljes së Jezu Krishtit në çdo shërbesë ungjillëzuese”⁷⁷. Duke i pranuar shqetësimet e ipeshkvijve aziatikë, Gjon Pali II iu tha: “që Kisha të përmbushë fatin e vet providencial, ungjillëzimi si predikimi i gëzueshëm, i durueshëm dhe progresiv i vdekjes shpëtuese dhe ngjalljes së Jezu Krishtit duhet të jetë përparësia juaj absolute”⁷⁸. Këto fjalë vlejnë për të gjithë ne.

I. E TËRË BASHKËSIA E HYJIT SHPALL UNGJILLIN

111. Ungjillëzimi është detyrë e Kishës. Por ky subjekt i ungjillëzimit është më shumë se një

⁷⁷ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Azi* (6 nëntor 1999), 19: AAS 92 (2000), 478.

⁷⁸ *ibid* 2: AAS 92 (2000), 451.

institucional organik dhe hierarkik. Ajo është para së gjithash një popull që ecën përpara në rrugën e vet të shtegtimin drejt Hyjit. Ajo është me siguri një mister që i ka rrënjët në Trininë, e megjithatë ajo ekziston konkretisht në histori si një popull shtegtarësh dhe ungjillëzuesish, që e tejkalojnë çdo shprehje institucionale, sado të nevojshme. Do të doja që të ndalem shkurtimisht te kjo mënyrë e të kuptuarit të Kishës, që e ka themelin te iniciativa e lirë dhe e hirshme e Hyjit.

Një bashkësi për secilin

112. Shpëtimi që na ofron Hyji është vepër e mëshirës së tij. Por asnjë përpjekje njerëzore, sado e mirë të jetë nuk mund të na aftësojë që të meritojmë një dhuratë kaq të madhe. Hyji, vetëm nga hiri i tij i pastër na tërheq pas vetes dhe na bën një me të⁷⁹. Ai e dërgon Shpirtin e tij në zemrat tona për të na bërë fëmijë të tij, duke na shndërruar dhe duke na aftësuar që t'i përgjigjemi dashurisë së tij përmes jetëve tona. Kisha është dërguar nga Jezu Krishti si sakramenti i shpëtimit i ofruar nga

⁷⁹ Shih *Propositio* 4.

Hyji⁸⁰. Përmes veprimtarisë së saj ungjillëzuese, ajo bashkëpunon si një vegël e këtij hiri hyjnor që vepron pa pushim dhe përtej çdo mbikëqyrje të mundshme. Benedikti i XVI-të e shprehte më së miri në fillim të reflektimeve të Sinodit: “Ka gjithnjë rëndësi që ta dimë se fjala e parë, iniciativa e vërtetë, veprimi i vërtetë vjen nga Hyji dhe vetëm duke e përfshirë veten në iniciativën hyjnore, vetëm duke e kërkuar këtë iniciativë hyjnore, do të jemi në gjendje që të bëhemi me të dhe në të, ungjillëzues”⁸¹. Ky parim i *përparësisë së hirit* duhet të jetë një far që i ndriçon vazhdimisht reflektimet tona mbi ungjillëzimin.

113. Shpëtimi që Hyji ka kryer dhe Kisha shpall me gëzim është për çdo njeri⁸² dhe Hyji ka gjetur një mënyrë për të bashkuar me veten çdo qenie njerëzore në çdo kohë. Ai ka zgjedhur që t'i thërrasë ata së bashku si një popull dhe jo si

⁸⁰ Shih Konkili i II ekumenik i Vatikanit, Kushtetuta dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 1.

⁸¹ Meditim gjatë Kongregacionit të Parë të Përgjithshëm të Asamblesë së Përgjithshme të Sinodit të Ipeshkvijve (8 tetor 2012): AAS 104 (2012), 897.

⁸² Shih *Propositio* 6; Konk. Ekum. Vatikanit II, Kushtetuta Pastorale mbi Kishën në botën moderne *Gaudium et Spes*, 22.

individë të izoluar⁸³. Asnjë nuk shpëtohet vetë, individualisht apo me forcat e veta. Hyji na tërheq duke marrë në konsideratë ndërthurjen e stërholluar të marrëdhënieve personale që përfshijnë jetën e një komuniteti njerëzor. Ky popull që Hyji ka zgjedhur dhe ka thirrur është Kisha. Jezusi nuk u tha apostujve që të formonin një grup ekskluziv *elitar*. Ai tha: “shkoni e bëjini nxënës të mi të gjithë popujt!” (Mt 28,19). Shën Pali na thotë që në popullin e Hyjit, Kishën, “Nuk ka më: hebre - grek!... Të gjithë ju jeni një në Krishtin Jezus!” (Gal 3,28). Atyre që e ndjejnë veten larg Zotit dhe Kishës, të gjithë atyre që janë të frikësuar apo indiferentë, do të doja t’ju thosha këtë: Zoti me një respekt e dashuri të madhe po ju thërret edhe ju për të qenë pjesë e popullit të tij!

114. Të jesh Kishë do të thotë të jesh popull i Hyjit, sipas planit të mrekullueshëm të dashurisë së Atit. Kjo do të thotë që ne duhet të jemi tharmi i Hyjit në mes të njerëzimit. Do të thotë të shpallësh dhe të sjellësh shpëtimin e Hyjit në këtë botë, që shpesh devijon dhe duhet të inkurajohet, t’i jepet

⁸³ Shih Konk. Ekum. Vatikanit II, Kushtetuta Dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 9.

shpresë dhe të marrë forcë për të ecur. Kisha duhet të jetë një vend ku mëshira jepet falas e ku çdo njeri mund të ndjehet i mirëpritur, i dashur, i falur dhe i nxitur që të jetojë jetën e Ungjillit.

Një bashkësi me persona nga më të ndryshëm

115. Ky popull i Hyjit është i mishëruar në popujt e botës, ku secili ka kulturën e vet. Koncepti i kulturës është i vlefshëm për të kapur shprehjet e ndryshme të jetës së krishterë që janë të pranishme në popullin e Hyjit. Ka të bëjë me mënyrën e të jetuarit të një shoqërie të caktuar, mënyra specifike në të cilën pjesëtarët e saj lidhen me njëra-tjetrën, me krijesa të tjera dhe me Hyjin. E kuptuar në këtë mënyrë, kultura përqafon tërësinë e jetës së një populli⁸⁴. Çdo popull gjatë kursit të historisë e zhvillon kulturën e vet me autonominë legjitime⁸⁵. Kjo ndodh për shkak të faktit që personi njerëzor, “nga natyra ka një nevojë absolute për jetën shoqërore”⁸⁶ dhe është referuar gjithnjë ndaj

⁸⁴ Shih Konferenca e tretë e ipeshkvijve amerikano-latinë dhe të Karaibeve, dokumenti *Puebla*, 23 mars 1979, Nos. 386-387.

⁸⁵ Shih Konkili Vat.II, Kushtetuta Pastorale mbi Kishën në botën moderne *Gaudium et Spes*, 36.

⁸⁶ *Ibid*, 25.

shoqërisë, ku jeton në mënyrë konkrete të lidhjes ndaj realitetit. Qeniet njerëzore janë të vendosura gjithnjë në një farë kulture: “natyra dhe kultura janë të lidhura ngushtë”⁸⁷. Hiri supozon kulturën dhe dhurata e Hyjit bëhet mish në kulturën e atyre që e marrin atë.

116. Në këto dy mijë vjet të krishterimit, një numër i madh popujsh kanë marrë hirin e besimit, e kanë bërë të lulëzojë në jetët e tyre të përditshme dhe e kanë përcjellë në gjuhën e kulturës së tyre. Kur një bashkësi e merr mesazhin e shpëtimit, Shpirti i Shenjtë e pasuron kulturën e tij me fuqinë shndërruese të Ungjillit. Historia e Kishës tregon se krishtërimi nuk ka vetëm një shprehje kulturore, por duke “qëndruar plotësisht ndaj vetes, me një besnikëri të patundur ndaj shpalljes së Ungjillit dhe traditës së Kishës, do të pasqyrojë gjithashtu tiparet e ndryshme të kulturave dhe popujve në të cilat pranohet dhe zë rrënjë”⁸⁸. Në shumëllojshmërinë e popujve që përjetojnë dhuratën e Hyjit, secili në përputhje me kulturën e vet, Kisha e shpreh autenticitetin e saj katolik

⁸⁷ *Ibid*, 53.

⁸⁸ Gjon Pali II, Letra Apostolike Novo Millennio Ineunte (6 janar 2001), 40: AAS 93 (2001), 295.

të mirëfilltë dhe tregon “bukurinë e fytyrës së saj të larmishme”⁸⁹. Në shprehjet e krishtera të një populli të ungjillëzuar, Shpirti i Shenjtë zbukuron Kishën, duke i treguar aspekte të reja të Zbulesës dhe duke i dhënë një fytyrë të re. Përmes kulturimit, Kisha “i prezanton popujt, së bashku me kulturat e tyre në bashkësinë e vet”⁹⁰, sepse çdo kulturë ofron vlera dhe forma pozitive që mund të pasurojnë mënyrën sesi Ungjilli predikohet, kuptohet dhe jetohet”⁹¹. Në këtë mënyrë, Kisha i merr vlerat e kulturave të ndryshme dhe bëhet, porsi “sponsa ornata monilibus suis” (nusja me bizhuteri e stolitur” (krh. Is 61,10)”⁹².

117. Kur kuptohet si duhet, shumëllojshmëria kulturore nuk përbën kërcënim ndaj unitetit të Kishës. Shpirti i Shenjtë, i dërguar nga Ati dhe Biri i shndërron zemrat tona dhe na aftëson që të hyjmë në bashkësinë e përkryer të Trinisë së Shenjtë, ku

⁸⁹ *Ibid*

⁹⁰ Gjon Pali II, Letra Enciklike *Redemptoris Missio* (7 dhjetor 1990), 52: AAS 83 (1991), 300; shih edhe Porosinë Apostolike *Catechesi Tradendae* (16 tetor 1979) 53: AAS 71 (1979), 1321.

⁹¹ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Oqeani* (22 nëntor 2001), 16: AAS 94 (2002), 384.

⁹² Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Afrikë*, (14 shtator 1995), 61: AAS 88 (1996), 39.

të gjitha gjërat e gjejnë unitetin e tyre. Ai ndërton bashkësinë dhe harmoninë e popullit të Hyjit. Po i njëjti Shpirti Shenjtë është kjo harmoni, ashtu siç është edhe lidhja e dashurisë midis Atit dhe Birit⁹³. Ai shkakton një larmi të madhe dhuratash, ndërkohë që krijon një unitet që nuk është kurrë uniformizëm por harmoni që tërheq. Ungjillëzimi i pranon me gëzim këta thesare të ndryshme që Shpirti i Shenjtë derdh mbi Kishën. Nuk do të bëhej drejtësi ndaj logjikës së mishërimit nëse do ta shihnim krishtërimin si monokulturore dhe uniform. Megjithatë është e vërtetë se disa kultura kanë qenë të lidhura ngushtë me predikimin e Ungjillit dhe zhvillimin e ideve të krishtera, mesazhi i zbuluar nuk identifikohet me ndonjërin prej tyre; përmbajtja e tij është transkulturore. Prandaj në ungjillëzimin e kulturave të reja, ose atyre që nuk e kanë mirëpritur predikimin e krishterë, nuk është esenciale që të imponohet një formë specifike kulturore, pavarësisht sesa e bukur dhe e lashtë mund të jetë, së bashku me propozimin Ungjillor. Mesazhi që shpallim ka gjithnjë një veshje kulturore, megjithatë në Kishë

⁹³ Shën Tomë Akuinati, S. Th. I, q. 39, a. 8 cons. 2: “Pa Shpirtin e Shenjtë që është lidhja e të dyjave, nuk mund të kuptohet uniteti lidhës midis Atit dhe Birit”; shih I, q. 37, a. 1, ad 3.

mund të biem në sakralizimin e kotë të kulturës sonë, duke treguar kështu më shumë fanatizëm sesa zell të vërtetë në ungjillëzim.

118. Ipeshkvijtë e Oqeanisë kërkuar që Kisha “të zhvillojë një kuptim e paraqitje të së vërtetës së Krishtit duke u nisur nga traditat dhe kulturat e rajonit” dhe i ftuan “të gjithë misionarët për të punuar në harmoni me të krishterët vendas për të siguruar që feja dhe jeta e Kishës të shprehet në forma legjitime të përshtatshme për çdo kulturë”⁹⁴. Nuk mund të pretendojmë që popujt nga çdo kontinent, duke shprehur besimin e tyre të krishterë të imitojnë mënyra të shprehuri që kanë zhvilluar kombet evropiane në një çast të caktuar të historisë, sepse besimi nuk mund të lidhet me kufizimet e kuptimit dhe shprehjes së çdo kulture⁹⁵. Është një fakt i padiskutueshëm që asnjë kulturë e vetme nuk mund ta konsumojë misterin e shëlbimit tonë në Krishtin.

⁹⁴ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Oqeani* (22 nëntor 2001), 17: AAS 94 (2002), 385.

⁹⁵ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Azi* (6 nëntor 1999), 20: AAS 92 (2000), 478-482.

Ne jemi të gjithë dishepuj misionarë

119. Në të gjithë të pagëzuarit, nga i pari te i fundit, fuqia shenjtëruese e Shpirtit është në veprim, duke na shtyrë që të ungjillëzojmë. Populli i Hyjit është i shenjtë falë kësaj vajosjeje, që e bën të pagabueshëm *“in credendo”* (në të besuarit). Kjo do të thotë se kur beson nuk gabohet, ndonëse mund të mos gjesh fjalë për ta shpjeguar besimin tënd. Shpirti e udhëheq atë në të vërtetën dhe e shpie drejt shëlbimit⁹⁶. Si pjesë e dashurisë së tij misterioze për njerëzimin, Hyji e pajis tërësinë e besimtarëve me një *instinkt besimi – il sensus fidei* – që i ndihmon të shohisin atë që vjen vërtet nga Hyji. Prania e Shpirtit u jep të krishterëve një farë natyre të dytë ndaj realiteteve hyjnore dhe një urtësi që i aftëson për t'i kuptuar këta realitete me intuitë, edhe kur u mungojnë mjetet e duhura për t'i shprehur saktë.

120. Për shkak të meritave të Pagëzimit të marrë, të gjithë pjesëtarët e popullit të Hyjit janë bërë dishepuj misionarë (krh. Mt 28,19). Të gjithë të pagëzuarit, cilado qoftë pozita që kanë në Kishë ose

⁹⁶ Shih Konc. Ekum. Vatikanit II, Kushtetuta Dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 12.

niveli i të udhëzuarit në fe, janë subjekte vepruese të ungjillëzimit dhe do të ishte e papërshtatshme të hartosh një skemë ungjillëzimi për t'u zbatuar nga profesionistë ndërsa besimtarët e tjerë do të qëndrojnë si marrës të thjeshtë pasivë. Ungjillëzimi i ri duhet të përfshirë një protagonizëm të ri nga çdo i pagëzuar. Kjo bindje transformohet në një thirrje të drejtpërdrejtë për çdo të krishterë, në mënyrë që askush të mos heqë dorë nga zotimi i vet për të ungjillëzuar; nga çasti kur, nëse dikush e ka provuar me të vërtetë dashurinë shpëtuese të Hyjit, nuk ka nevojë për shumë kohë apo për shumë përgatitje që të shkojë e ta shpallë atë, e kështu nuk mund të pritet që t'i jepen shumë mësim apo instruksione të gjata. Çdo i krishterë është një misionar në atë masë që ai ose ajo është ndeshur me dashurinë e Hyjit në Krishtin Jezus. Ne nuk themi më se jemi “dishepuj” dhe “misionarë” por që jemi gjithnjë “dishepuj-misionarë”. Nëse nuk jemi të bindur, le të shohim dishepujt e parë, të cilët sapo u përballën me vështirimin e Jezusit, shkuan dhe e shpallën atë plot gëzim: “E gjetëm Mesinë” (Gjn 1,41). Gruaja samaritane u bë misionare pasi foli me Jezusin dhe shumë samaritanë besuan në të “për shkak të dëshmisë së gruas” (Gjn 4,39). Edhe Shën Pali,

pasi u takua me Jezu Krishtin “menjëherë filloi të njoftojë se Jezusi është Biri i Hyjit” (Vap 9,20; krh. edhe 22,6-21). Për çfarë po presim atëherë?

121. Sigurisht që ne të gjithë jemi thirrur për t’u rritur në shërbesën tonë si ungjilltarë. Ne duam të kemi një formim sa më të mirë, një dashuri më të madhe dhe një dëshmi më të qartë ndaj Ungjillit. Në këtë drejtim, ne duhet t’i lëmë të tjerët që të na ungjillëzojnë vazhdimisht. Por kjo s’do të thotë që duhet të heqim dorë nga misioni ungjillëzues, përkundrazi ne duhet të gjejmë mënyra sesi mund ta përcjellim Jezusin kudo që jemi. Gjithësesi, të gjithë jemi thirrur që t’u ofrojmë të tjerëve një dëshmi të qartë ndaj dashurisë shpëtuese të Hyjit, i cili pavarësisht nga të metat tona na ofron afërsinë e tij, fjalën dhe fuqinë e tij dhe i jep qëllim jetës sonë. Në zemrën tënde ti e di mirë sesa ndryshe është të jetosh pa të, ajo që keni arritur të kuptoni, çfarë ju ka ndihmuar që të jetoni dhe të keni shpresë, duhet gjithashtu ta ndani me të tjerët. Papërsosmëria jonë nuk duhet të jetë kurrë pretekst, por përkundrazi, misioni është një nxitje e vazhdueshme për të mos qëndruar i zhytur në mediokritet dhe për të ngulmuar që të rritemi.

Dëshmia e fesë që çdo i krishterë duhet të japë, na nxit të themi bashkë me Shën Palin: “Jo, si t’ia kisha arritur, as, si të isha bërë i përsosur, por - vrapoj që, në ndonjë mënyrë, të mund ta zë, sepse edhe vetë kam qenë zënë prej Krishtit [Jezus]” (Fil 3,12-13).

Fuqia ungjillëzuese e besimit popullor

122. Në të njëjtën mënyrë, ne mund të shohim që popujt e ndryshëm ndër të cilët është kulturuar Ungjilli janë subjekte kolektive vepruese apo veprimtarë të ungjillëzimit. Kjo ndodh sepse çdo popull është krijues i kulturës dhe protagonist i historisë së vet. Kultura është një realitet dinamik që një popull e rikrijon vazhdimisht. Çdo brez i përcjell një mori mënyrash trajtimi të situatave të ndryshme ekzistuese brezit tjetër, i cili duhet ta përpunojë sërish nga ana e vet ndërsa përballet me sfidat e tij. Të jesh njerëzor do të thotë “të jesh në të njëjtën kohë edhe baba dhe bir i një kulture të cilës i përket”⁹⁷. Kur në një popull, Ungjilli të jetë bërë pjesë e kulturës, në procesin

⁹⁷ Letra Enciklike e Gjon Palit II, *Fides et Ratio* (14 shtator 1998), 71: AAS 91 (1999), 60.

e transmetimit të kulturës transmeton gjithashtu edhe fenë në forma gjithnjë të reja. Prej kësaj duhet ta shohim rëndësinë e të kuptuarit të ungjillëzimit si kulturim. Çdo pjesë e popullit të Hyjit, duke e transmetuar dhuratën e Hyjit në jetën e vet, në përputhje me aftësitë e veta, dëshmon ndaj fesë që ka marrë dhe e pasuron me shprehje të reja dhe elokuate. Mund të themi madje që “një popull ungjillëzon vazhdimisht vetveten”.⁹⁸ Këtu shihet rëndësia e mëshirës së popullit, një shprehje autentike e veprimtarisë misionare spontane të Popullit të Hyjit. Bëhet fjalë për një realitet në zhvillim të përhershëm, ku Shpirti i Shenjtë është protagonist.⁹⁹

123. Mëshira e popullit mund të arrijë mënyrën në të cilën besimi i marrë të mishërohet në një kulturë dhe të vazhdojë të përcillet. Ndërsa më parë shihej me përcmim, mëshira e popullit filloi të çmohej përsëri në dekadat që pasuan Koncilin. Në Porosinë *Evangelii Nuntiandi*, Pali VI

⁹⁸ Konferenca e tretë e përgjithshme e ipeshkvijve latino-amerikanë dhe ipeshkvijve karibeanë, *dokumenti Puebla*, 23 mars 1979, 450; shih edhe Konf. e pestë e përgjo. E ipeshkv, latinoamerikanë dhe ipeshkvijve karibeanë, *dokumenti Aparecida* (29 qershor 2007, 264.

⁹⁹ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Ecclesia në Azi* (6 nëntor 1999), 21: AAS 92 (2000), 482-484.

dha një shtytje vendimtare në këtë drejtim, duke deklaruar se mëshira e popullit “shfaq një etje për Hyjin që vetëm të varfrit dhe të thjeshtët mund ta njohin”¹⁰⁰ dhe se “të bën të aftë për bujari dhe sakrificë deri në heroizëm, kur është çështja për të dëshmuar fenë”¹⁰¹. Më afër kohës sonë, Benedikti i XVI-të, duke folur për Amerikën Latine, theksoi se mëshira e popullit është “një thesar i çmuar i Kishës Katolike”, në të cilin “ne shohim shpirtin e popujve latinoamerikanë”¹⁰².

124. Në dokumentin *Aparecida* përshkruhen pasuritë që Shpirti i Shenjtë derdh në mëshirën e popullit me anë të iniciativës së tij të hirshme. Në atë kontinent të dashur, ku shumë të krishterë e shprehin besimin e tyre përmes mëshirës së popullit, ipeshkvijtë i referohen si “përsheptmëri popullorë” ose “misticizmi i popullit”¹⁰³. Bëhet fjalë me të vërtetë për një “përsheptmëri të mishëruar në kulturën e të thjeshtëve”¹⁰⁴. Ai nuk

¹⁰⁰ *ibid*

¹⁰¹ *Ibid*

¹⁰² Fjalimi në hapjen e Konf. së pestë të përgjo. të ipeshkv. latinoamerikanë dhe karibeanë (13 maj 2007), 1: AAS 90 (2007), 446.

¹⁰³ Konf. e pestë e përgj. e ipeshkv. latinoamerikanë dhe atyre karibeanë, *dok. Aparecida*, 29 qershor 2007, 262.

¹⁰⁴ *Ibid* 263.

është pa përmbajtje por e zbulon dhe e shpreh atë përmbajtje më shumë me anë të simboleve sesa me anë të arsyetimit të dobishëm dhe në aktin e besimit vihet më shumë theks në *credere in Deum* sesa në *credere Deum*¹⁰⁵. Është një “mënyrë legjitime e të jetuarit të besimit, një mënyrë e të ndjerit pjesë e Kishës dhe një mënyrë e të qenit misionarë”¹⁰⁶; ai sjell në vetvete hirin e të qenit misionar dhe të dalurit nga vetja dhe të qenit shtegtarë: “Duke ecur së bashku drejt shenjtëroreve dhe duke marrë pjesë në manifestime të tjera të besimit popullor, duke marrë me vete fëmijët ose duke ftuar të tjerët, është në vetvete një veprim ungjillëzues”¹⁰⁷. Le të mos ta ndrydhim apo të pretendojmë se e kemi në kontroll këtë fuqi të misionit!

125. Për ta kuptuar këtë realitet, ne duhet t'i afrohem me vështrimin e Bariut të Mirë, që nuk kërkon të gjykojë por të dojë. Vetëm nga ajo natyra e dytë e lindur nga dashuria mund ta çmojmë jetën teologjike që është e pranishme në besimin e popujve të krishterë, sidomos në mes

¹⁰⁵ Shih Shën Tomë Akuinati, S. Th., II-II, q. 2, a. 2.

¹⁰⁶ Konf. e pestë e përgj. e ipeshkv. latinoamerikanë dhe atyre karibeane, dok. *Aparecida*, 29 qershor 2007, 264.

¹⁰⁷ *Ibid*

të varfërve. Mendoj për besimin e patundur të nënave në këmbët e krevatit të fëmijëve të sëmurë, të cilat ndonëse nuk i dinë mirë fjalët e Besojmës, marrin rruzaren. Dhe për shpresën e varur në një qiri të ndezur në një shtëpi të thjeshtë ku i kërkohet ndihmë me lutje Marisë, ose vështrimin plot dashuri të Krishtit të kryqëzuar. Ai që e do popullin e shenjtë të Hyjit nuk ka për t'i parë këta veprime si shprehje të një kërkimi thjesht të natyrashëm për hyjnoren. Ato janë të shfaqurit e një jete teologjike të ushqyer nga veprimet e Shpirtit të Shenjtë që është derdhur në zemrat tona (krh. Rom 5,5).

126. Në mëshirën e popullit, si fryt i Ungjillit të kulturuar, gjendet një fuqi aktive ungjillëzuese që nuk mund ta nënvleftësojmë, pasi ndryshe nuk do prananim veprën e Shpirtit të Shenjtë. Madje, ne jemi të thirrur që ta nxisim dhe përforcojmë atë, me qëllim që të thellojmë procesin e pareshtur të kulturimit, i cili është një realitet që s'përfundon kurrë. Shprehjet e mëshirës së popullit kanë shumë gjëra për të na mësuar dhe për kë është i aftë t'i lexojë janë një *vend teologjik* që kërkon vëmendjen tonë, sidomos tani që po mendojmë për ungjillëzimin e ri.

Dialog personal

127. Sot, ndërsa Kisha përpiket të përjetojë një ripërtëritje të thellë misionare, kemi një lloj predikimi që na përket të gjithëve në detyrat e përditshme. Ajo ka të bëjë me përcjelljen e Ungjillit te njerëzit që takojmë, qofshin ata të afërmit tanë apo njerëz të panjohur. Ky është predikimi formal që ndodh në mes të një bisede, apo në diçka që një misionar bën gjatë një vizite në shtëpi. Të jesh dishepull do të thotë të jesh gjithnjë gati për të sjellë dashurinë e Jezusit te i afërmi dhe kjo mund të ndodhë papritur dhe në çdo vend: në rrugë, në një shesh, në vendin e punës apo në një udhëtim.

128. Në këtë predikim, që është gjithnjë respektues dhe i butë, hapi i parë është dialogu personal, kur tjetri ndan gëzimet e veta, shpresat e shqetësimet që ka për të dashurit, apo për shumë gjëra që mbushin zemrën e tij. Vetëm pas këtyre bisedave mund ta sjellim fjalën e Hyjit, ndoshta duke lexuar ndonjë varg nga Bibla apo duke treguar ndonjë histori, por gjithnjë duke pasur parasysh mesazhin themelor: dashurinë personale të Hyjit që u bë njeri, që e dha veten për ne, që jeton dhe që na ofron

shpëtimin e miqësinë e tij. Ky mesazh duhet ndarë përlësisht si një dëshmi nga ana e dikujt që është gati të mësojë, duke qenë i vetëdijshëm se mesazhi është aq i pasur dhe i thellë saqë e tejkalon gjithnjë kufirin e njohjes sonë. Ka raste kur mesazhi mund të paraqitet drejtpërdrejt, e ka raste kur me anë të një dëshmie apo gjesti personal, ose në një mënyrë që Shpirti Shenjtë mund ta sugjerojë në një situatë të caktuar. Nëse duket e urtë dhe nëse janë rrethanat e përshtatshme, kjo përballje vëllazërore dhe misionare mund të përfundojë me një lutje të shkurtër që ka të bëjë me shqetësimet që personi mund të ketë shprehur. Në këtë mënyrë ata do ta ndjejnë qartë se janë dëgjuar dhe kuptuar dhe do ta dinë se situata e tyre e veçantë i është parashtruar Hyjit dhe se fjala e Hyjit i flet realisht zemrës së tyre.

129. Por ne nuk duhet të mendojmë se mesazhi i Ungjillit duhet të përcillet gjithnjë me formulime të fiksuara, të mësuara përmendësh apo me anë të fjalëve të veçanta që shprehin një përmbajtje të pandryshueshme. Ky komunikim ndodh në shumë mënyra aq të larmishme saqë do të ishte e pamundur për t'i përshkruar apo rreshtuar të

gjitha dhe populli i Hyjit, me të gjitha shenjat e veprimet janë subjekti kolektiv. Si pasojë, kur Ungjilli mishërohet në një kulturë, mesazhi nuk përcillet më thjesht nga një person në tjetrin. Në vendet ku krishterimi është pakicë, bashkë me nxitjen që çdo i pagëzuar të shpallë Ungjillin, disa kisha të veçanta duhet të jenë vepruese në promovimin e formave paraprake të kulturimit, gjithnjë me synimin përfundimtar që Ungjilli, duke u predikuar në kategori të përshtatshme me çdo kulturë, do të krijojë një sintezë të re me atë kulturë të veçantë. Por meqë ky është gjithnjë një proces i ngadaltë, mund të paralizohemi nga frika. Nëse e lëmë frikën e dyshimet të na e mbysin guximin, në vend që të jemi krijues, do të rehatohemi, duke mos bërë asnjë lloj përparimi. Në këtë rast ne nuk do të luajmë asnjë rol aktiv në proceset historike, por do të bëhemi spektatorë të thjeshtë të një Kise që po qëndron në vend.

Karizma në shërbim të një bashkësie që ungjillëzon

130. Shpirti Shenjtë e pasuron tërë Kishën që ungjillëzon me karizma të ndryshme. Këto dhurata

synojnë të ripërtërijnë dhe ndërtojnë Kishën¹⁰⁸. Ato nuk janë thjesht një trashëgimi, që janë ruajtur dhe u janë besuar një grupi të vogël për t'i ruajtur, por janë dhurata të Shpirtit që janë të integruara në trupin e Kishës, të tërhequra drejt qendrës që është Krishti, prej nga kanalizohen në një shtytje ungjillëzuese. Një shenjë e sigurt e autenticitetit të një karizme është natyra e saj kishtarë, aftësia për t'u integruar harmonishëm në jetën e besimtarëve të shenjtë e besnikë, për të mirën e të gjithëve. Diçka vërtet e re e shkaktuar nga Shpirti nuk ka pse t'i mbulojë dhuratat e tjera dhe aspektet e tjera shpirtërore, për t'u dukur vetë. Në masën që një karizëm drejtohet më mirë ndaj zemrës së Ungjillit, ushtrimi i saj do të jetë më e lidhur me kishën. Edhe kur rezulton e mundimshme, një karizëm vërtetohet si e mirëfilltë dhe misteriozisht e frytshme pikërisht në një bashkësi. Në bazë të përgjigjes së saj ndaj kësaj sfide, Kisha mund të jetë një model paqeje në botën tonë.

131. Ndryshimet midis personave dhe komuniteteve mund të rezultojnë disa herë të papëlqyeshme, por Shpirti Shenjtë që është

¹⁰⁸ Shih Konc. II Ekum. Vat., Kushtet. Dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 12.

burimi i kësaj shumëllojshmërie mund të nxjerrë diçka të mirë nga çdo gjë dhe ta kthejë në një mjet tërheqës ungjillëzimi. Shumëllojshmëria duhet të pajtohet gjithnjë me ndihmën e Shpirtit Shenjtë, sepse vetëm ai mund të shkaktojë larmi, shumësi, ndërkohë që sjell unitet. Kur ne nga ana jonë, aspirojmë pas larmisë, ne bëhemi të vetëmbyllur, përjashtues dhe përçarës, dhe po ashtu sa herë që përpigemi të krijojmë unitet mbi bazën e përlllogaritjeve tona njerëzore, ne imponojmë njëtrajtshmëri monolitike, gjë që nuk e ndihmon aspak misionin e Kishës.

Kultura, idetë dhe formimi

132. Të shpallurit e mesazhit të Ungjillit ndaj kulturave të ndryshme nënkupton të shpallurit ndaj qarqeve profesionale, shkencore dhe akademike. Kjo do të thotë një përballje midis fesë, arsyes dhe shkencës me synimin e zhvillimit të metodave të reja dhe argumenteve mbi çështjen e besueshmërisë, një apologjetikë krijuese¹⁰⁹, që do të nxiste një hapje më të madhe ndaj Ungjillit.

¹⁰⁹ Shih *Propositio* 17.

Kur disa kategori të caktuara të arsyes dhe shkencës përdoren në shpalljen e mesazhit, këto kategori bëhen vegla të ungjillëzimit e uji kthehet në verë. Çfarëdo që merret e përdoret, jo thjesht shpengohet, por bëhet një instrument i Shpirtit për ndriçimin e ripërtëritjes së botës.

133. Nuk mjafton që ungjillëzuesit të preokupohen që ta arrijnë çdo person, apo që Ungjilli t'u shpallet kulturave në tërësi, por një teologji e jo thjesht një teologji baritore, që është në dialog me shkencat e tjera dhe përvojat njerëzore është mjaft e rëndësishme për dallimin tonë sesi ta sjellim më së miri mesazhin e Ungjillit te kontekste e grupe të ndryshme kulturore¹¹⁰. Kisha, në përkushtimin e saj ndaj ungjillëzimit, e çmon dhe e nxit karizmën e teologëve dhe përpjekjet e tyre për të nxitur dialogun me botën e kulturës dhe të shkencës. Unë u bëj thirrje teologëve që ta zbatojnë këtë shërbesë si pjesë të misionit shpëtues të Kishës. Por duke e bërë këtë, ata s'duhet të harrojnë se Kisha dhe teologjia ekzistojnë për të ungjillëzuar dhe jo të kënaqen me një teologji të lidhur pas tryezës së punës.

¹¹⁰ Shih *Propositio* 30.

134. Universitetet janë mjedise të njohura për artikulin dhe kultivimin e këtij përkushtimi ungjillëzues në një mënyrë ndërdisiplinore dhe të integruar. Shkollat katolike të cilat përpiqen vazhdimisht që t'u bashkohen punës së tyre edukuese me shpalljen e qartë të Ungjillit janë një burim tejet i çmuar për ungjillëzimin e kulturës, edhe në ato vende e qytete ku situata të pafavorshme na nxisin për një krijueshmëri më të madhe në kërkimin tonë të metodave të përshtatshme¹¹¹.

II. HOMELIA

135. Të shikojmë tani predikimin brenda liturgjisë, që kërkon një konsideratë serioze nga ana e barinjve. Unë do të flas me shumë hollësi mbi homelinë dhe përgatitjen e saj meqë janë shprehur shumë shqetësime mbi këtë shërbesë të rëndësishme, të cilat nuk mund t'i shpërfillim. Homelia është themeli i gjykimit të afërsisë dhe aftësisë së bariut për të komunikuar me bashkësinë

¹¹¹ Shih Propositio 27.

e tij. Ne e dimë se besimtarët i japin një rëndësi të madhe asaj dhe si ata ashtu edhe ministrat e tyre të shuguruar vuajnë për shkak të homelive: laikët nga nevoja për t'i dëgjuar ato vazhdimisht ndërsa klerikët nga nevoja për t'i predikuar! Fatkeqësisht kjo është e vërtetë. Homelia mund të jetë një përvojë intensive dhe e bekuar e Shpirtit, një takim ngushëllues me fjalën e Hyjit, një burim i vazhdueshëm ripërtëritjeje dhe rritjeje.

136. Le ta rinovojmë besimin te predikimi, bazuar në bindjen se është Hyji që përpiket të arrijë të tjerët përmes predikuesit dhe se ai e shfaq pushtetin e vet me anë të fjalëve njerëzore. Shën Pali e thekson me forcë nevojën për të predikuar, meqenëse Zoti dëshiron që të arrijë njerëzit me anë të fjalës sonë (krh. Rom 10,14-17). Me anë të fjalëve të tij Zoti i fitoi zemrat e njerëzve që vinin për ta dëgjuar nga çdo anë (krh. Mk 1,45) dhe mahniteshin nga mësimet e tij (krh. Mk 6,2). Me anë të fjalëve të tyre, apostujt, që Krishti i kishte vendosur "për të qenë me të dhe për t'u dërguar që të predikojnë" (Mk 3,14), i sollën të gjitha kombet në gjirin e Kishës (krh. Mt.16,15-20).

137. Duhet të kujtohem që “shpallja liturgjike e fjalës së Hyjit, sidomos në mbledhjen eukaristike, nuk është aq shumë një kohë meditimi dhe katekizmi sesa *dialogu midis Hyjit dhe popullit të tij*, një dialog në të cilin veprat e mëdha të shpëtimit shpallen dhe ri-deklarohen vazhdimisht kërkesat e besëlidhjes”¹¹². Homelia ka rëndësi të veçantë për shkak të kontekstit të saj eukaristik dhe i tejkalon të gjitha format e katekizmës si çasti suprem në dialogun midis Hyjit dhe popullit të tij që të çon në kungimin sakramental. Homelia e merr sërish dialogun që Hyji e ka vendosur tashmë me popullin e tij. Predikuesi duhet ta njohë zemrën e bashkësisë së tij, me qëllim që të kuptojë se ku është e gjallë dhe e zjarrtë dëshira e saj për Hyjin, dhe se ku ky dialog që më parë ka qenë i mbështjellë me dashuri, është deformuar dhe është bërë shterpë.

138. Homelia nuk mund të jetë një formë dëfrimi si ato që na paraqet media, e megjithatë duhet t’i japë kremtimit jetë dhe kuptim. Ajo i përket një

¹¹² Gjon Pali II, Letra apostolike *Dies Domini* (31 maj 1998), 41: AAS 90 (1998), 738-739.

zhanri të veçantë, meqenëse predikimi i saj ndodh brenda formës së një kremtimi liturgjik, prandaj dhe duhet të jetë i shkurtër, pa marrë trajtën e një fjalimi apo lekturë. Një predikues mund të jetë i aftë ta mbajë të gjallë vëmendjen e dëgjuesve për një orë të tërë, por në këtë rast fjalët e tij bëhen më të rëndësishme sesa kremtimi i fesë. Nëse homelia do të zgjasë shumë, do të prekë dy tipare karakteristike të kremtimit liturgjik: balancën dhe ritmin e tij. Kur predikimi ndodh brenda kontekstit të liturgjisë, është pjesë e ofrimit që i bëhet Atit dhe një ndërmjetësim i hirit që Krishti e derdh gjatë kremtimit. Ky kontekst kërkon që predikimi të udhëheqë asamblenë dhe predikuesin në një bashkësi jetëshndërruese me Krishtin në eukaristi. Kjo do të thotë që fjalët e predikuesit duhet të maten, në mënyrë që Zoti, më shumë se ministri i tij, do të jetë qendra e vëmendjes.

Biseda e një nëne

139. Ne thamë që populli i Hyjit, me anë të veprimit të brendshëm të vazhdueshëm të Shpirtit të Shenjtë, e ungjillëzon pareshtur veten. Po cilat

janë implikimet e këtij parimi për predikuesit? Na kujton që Kisha është një nënë dhe që predikon në të njëjtën mënyrë që një nënë i flet fëmijës së saj, duke e ditur se fëmija beson se ajo që i mëson nëna është për të mirën e saj, sepse fëmijët e dinë se duhen. Po ashtu, një nënë e mirë mund të pranojë gjithçka që Hyji po sjell te fëmija i saj, ajo i dëgjon shqetësimet e saj dhe mëson prej tyre. Shpirti i dashurisë që sundon në një familje e udhëheq si nënën ashtu edhe fëmijën në bisedat e tyre. Këtu ata mësojnë e japin mësim, përjetojnë korrigjimin dhe rriten në vlerësimin e asaj që është e mirë. Diçka e ngjashme ndodh në një homeli. I njëjti Shpirt që frymëzoi Ungjijtë dhe që vepron në Kishë e frymëzon predikuesin të dëgjojë besimin e popullit të Hyjit dhe të gjejë udhën e duhur për të predikuar në çdo eukaristi. Predikimi i krishterë gjen në zemrën e njerëzve dhe kulturën e tyre një burim të ujit të gjallë, që e ndihmon predikuesin të dijë se çfarë duhet thënë dhe si duhet thënë. Ashtu si na pëlqen të na flasim në gjuhën tonë amtare, edhe në fe, na pëlqen që të na flasim në “kulturën tonë amtare”, në gjuhën tonë të lindur (krh. 2 Makabenjve 7,21-27) dhe zemra është më e disponuar për të dëgjuar. Kjo gjuhë është një

lloj muzike që frymëzon inkurajim, forcë dhe entuziazëm.

140. Ky mjedis amnor-kishtar, në të cilin ndodh dialogu midis Zotit dhe popullit të tij duhet të inkurajohet nga afërsia e predikuesit, ngrohtësia e tonit të zërit, thjeshtësia në mënyrën e të folurit, gëzimi në gjestet e tij. Edhe nëse homelia mund të jetë ndonjëherë pak e mërzitshme, nëse ky shpirt amnor-kishtar do të jetë i pranishëm, do të japë gjithnjë fryte, ashtu siç japin fryt edhe këshillat e bezdisshme të një nëne në kohën e duhur në zemrat e fëmijëve.

141. Nuk mund të mos admirosh burimet që Zoti ka përdorur në dialogun me popullin e tij, për të zbuluar misterin e tij ndaj të gjithëve dhe për të tërhequr njerëzit e zakonshëm me anë të mësimave e kërkesave të tij fisnike. Unë besoj se e fshehta qëndron në mënyrën sesi i shikonte Jezusi njerëzit, duke parë përtej dobësive dhe dështimeve të tyre: “Mos druaj, o grigjë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t’jua japë Mbretërinë!” (Lk 12,32). Jezusi predikon me këtë shpirt. Plot me gëzim në Shpirtin e Shenjtë, ai e bekon Atin që i

tërheq të vegjlit pranë vetes: “Të madhëroj, o Atë, Zotërues i qiellit e i tokës, pse ua fshehe këto të urtëve e të mençurve e ua zbulove të vegjëlve!” (Lk 10,21). Zoti kënaqet shumë duke folur me popullin e tij dhe predikuesi duhet të përpiqet ta komunikojë këtë kënaqësi te dëgjuesit e tij.

Fjalë që ndezin zemrat zjarr

142. Dialogu është më shumë se komunikimi i një të vërtete. Ai buron nga kënaqësia e të folurit dhe i pasuron ata që e shprehin dashurinë e tyre për njëri-tjetrin përmes fjalëve. Ky është një pasurim që nuk konsiston në objekte por në persona që marrin pjesë në dialog. Një predikim që do të ishte krejt moralist apo doktrinor, ose një që shndërrohet në një leksion mbi ekzegjenzën biblike, e redukton këtë komunikim midis zemrash që ndodh në homeli dhe duhet të ketë një natyrë thuajse sakramentale: “besimi vjen nga predikimi, e predikimi është shpallja e Fjalës së Zotit” (Rom 10,17). Në homeli, e vërteta shkon krah për krah me bukurinë dhe mirësinë. Nuk bëhet fjalë për të vërteta abstrakte apo silogjizma

të ftohta, pasi përcjell edhe bukurinë e imazheve të përdorura nga Zoti për të nxitur praktikën e së mirës. Kujtesa e besimtarëve si ajo e Marisë, duhet të vërshojë me gjërat e mrekullueshme që ka bërë Hyji. Zemrat e tyre, duke u rritur në shpresë nga ushtrimi i gëzueshëm dhe praktik i dashurisë që kanë marrë, do ta ndiejnë që çdo fjalë e Shkrimit është një dhuratë para se të jetë një kërkesë.

143. Sfida e predikimeve të kulturuara konsiston në shpalljen e një sinteze e jo ideve apo vlerave të shkëputura. Aty ku është sinteza jote, aty do të jetë edhe zemra. Ndryshimi midis ndriçimit të një sinteze dhe duke e bërë këtë me ide të shkëputura është si ndryshimi midis mërziqjes dhe zjarrit të zemrës. Predikuesi ka detyrën e mrekullueshme por të vështirë të bashkimit të zemrave të dashura, midis zemrës së Hyjit dhe asaj të popullit të vet. Dialogu midis Hyjit dhe popullit të tij e forcon besëlidhjen midis tyre dhe e konsolidon lidhjen e dashurisë. Gjatë homelisë, zemrat e besimtarëve rrinë në heshtje dhe e lënë Zotin të flasë. Zoti dhe populli i tij flasin me njëri-tjetrin në njëmijë mënyra, drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësues. Por në homeli, ata duan që dikush

të shërbejë si mjet dhe të shprehë ndjenjat në një mënyrë të tillë që në vijim, gjithësecili të zgjedhë si ta vazhdojë bashkëbisedimin. Në thelb fjala është një ndërmjetësuese dhe nuk kërkon vetëm dy dialogues por edhe një predikues që ta paraqesë si të tillë, i bindur se “se ne nuk predikojmë vetveten, por Jezu Krishtin Zot, ndërsa vetveten e shpallim shërbëtorët tuaj për dashuri të Jezusit” (2 Kor 4,5).

144. Të flasësh me zemër do të thotë që zemrat tona nuk duhet thjesht të ndizen zjarr, por edhe të ndriçohen nga plotësia e zbulesës dhe nga shtegu i përshkuar nga Fjala e Hyjit në zemrën e Kishës dhe nga besimtarët tanë përmes historisë. Identiteti i krishterë, si përqaftim i pagëzimit që na dha Ati kur ishim të vegjël, na bën të etur si bij plangprishës dhe bij të favorizuar në Marinë, në një përqaftim tjetër, në atë të Atit të mëshirshëm që na pret në lavdi. Duke i ndihmuar besimtarët tanë që të ndjejnë se jetojnë në mes të këtyre dy përqaftimeve është detyra e vështirë por e bukur e atij që predikon Ungjillin

III. PËRGATITJE PËR PREDIKIM

145. Përgatitja për predikim është një detyrë kaq e rëndësishme saqë i duhet kushtuar një kohë e gjatë studimi, lutje, reflektimi dhe krijimtarie baritore. Me një afeksion të madh do të doja të ndalesha pak e të propozoja një itinerar përgatitjeje për homelinë. Dikujt mund t'i duken këto sugjerime evidente, por e konsideroj të dobishme që t'i ofroj si një mënyrë për theksimin e nevojës për të përkushtuar një kohë cilësore ndaj kësaj shërbese të çmuar. Disa famullitarë janë të mendimit se një përgatitje e tillë nuk është e mundur për shkak të numrit të madh të detyrave që kanë, megjithatë unë e marr guximin që të kërkoj që çdo javë një pjesë nga koha personale dhe ajo e rezervuar ndaj bashkësisë t'i dedikohet kësaj detyre, edhe nëse më pak kohë do t'ju jepet veprimtarive të tjera të rëndësishme. Besimi në Shpirtin e Shenjtë që vepron gjatë homelisë nuk është thjesht pasiv, por veprues dhe krijues. Ai kërkon që ta ofrojmë veten dhe aftësitë tona si mjete që Hyji t'i përdorë (krh. Rom 12,1). Një predikues që nuk përgatitet nuk është “shpirtëror”, por është i pandershëm dhe i papërgjegjshëm me dhuratat që ka marrë.

146. Hapi i parë, pasi ta kesh thirrur Shpirtin e Shenjtë, është t'i kushtojmë tërë vëmendjen tekstit biblik, që duhet të jetë baza e predikimit tonë. Sa herë që ndalojmë dhe përpigemi të kuptojmë mesazhin e një teksti të veçantë, ne praktikojmë "kultin e së vërtetës"¹¹³. Kjo është përlulja e zemrës që e pranon se fjala është gjithnjë përtej nesh, që "ne nuk jemi as zotërinjtë e as padronët e saj, por vetëm kujdestarët, lajmëtarët dhe shërbëtorët e saj"¹¹⁴. Ky qëndrim me nderim të përlulur dhe magjepsje ndaj fjalës shprehet nga përkushtimi për t'i dhënë kohë studimit të saj me vëmendjen më të madhe dhe me një frikë të shenjtë që të mos e deformojmë. Për të interpretuar një tekst biblik, duhet të jemi të durueshëm, të lëmë mënjane çdo shqetësim tjetër dhe t'i japim kohën, interesat tona dhe vëmendjen më të madhe. Duhet të lëmë mënjane çdo shqetësim tjetër dhe të krijojmë një mjedis tjetër të përqendrim të kthjelluar. Është e kotë të përpigesh të lexosh një tekst biblik nëse jemi duke kërkuar vetëm rezultate të shpejta, të lehta

¹¹³ Pali VI, Porosia Apostolike Evangelii Nuntiandi (8 dhjetor 1975), 78: AAS 68 (1976), 71.

¹¹⁴ *Ibid*

dhe të menjëhershme. Përgatitja për predikimin kërkon dashuri. Ne u kushtojmë periudha kohe pa u nxituar gjërave ose njerëzve që duam; ndërsa këtu flitet të duam Hyjin, që dëshiron *të na flasë*. Për shkak të kësaj dashurie, ne mund të kushtojmë aq kohë sa na duhet, si çdo nxënës i vërtetë: "Fol o Zot se shërbëtori yt po të dëgjon" (1 Sam.3:9).

147. Para së gjithash, ne duhet të sigurohemi se e kemi kuptuar kuptimin e fjalëve që lexojmë. Këtu duhet të këmbëngul për diçka që mund të duket e qartë por që nuk merret gjithnjë në konsideratë: teksti biblik që ne studiojmë është dy ose tre mijë vjet i lashtë dhe gjuha e tij është mjaft e ndryshme nga ajo që flasim sot. Edhe nëse mendojmë se i kuptojmë fjalët e përkthyer në gjuhën tonë, kjo s'do të thotë se e kuptojmë si duhet atë që autori i shenjtë ka dashur të thotë. Janë shënuar burime të ndryshme nga analiza letrare; duhet t'i kushtosh vëmendje fjalëve të përsëritura ose të theksuara, duhet të njohësh strukturën dhe lëvizjen specifike të tekstit pastaj të marrësh në konsideratë edhe rolin që luajnë personazhet e ndryshme e kështu me radhë. Por synimi ynë nuk është të kuptojmë çdo detaj të vogël të një teksti, sepse synimi kryesor

është të zbulojmë se cili ` mesazhi themelor, ai që i jep strukturën dhe unitetin tekstit. Nëse predikuesi nuk e bën këtë përpjekje, predikimi i tij nuk do të ketë as unitet e as rregull, por çfarë ka për të thënë do të jetë thjesht një akumulim i ideve të ndryshme të fragmentuara që nuk do të jenë në gjendje të frymëzojnë të tjerët. Mesazhi qendror është çfarë autori ka dashur kryesisht të komunikojë e kjo kërkon pranimin jo vetëm të ideve të autorit por efektin që ka dashur të krijojë. Nëse një tekst është shkruar për të ngushëlluar, nuk duhet të përdoret për të korrigjuar gabime, nëse është shkruar si nxitje nuk duhet të përdoret për të mësuar doktrinë, nëse është shkruar për të mësuar diçka mbi Hyjin, nuk duhet të përdoret për të shtjelluar mendime të ndryshme teologjike e nëse është shkruar si thirrje për lavdërim ose shërbesë misionare, të mos e përdorim për të folur mbi lajmet e fundit.

148. Sigurisht, për të kuptuar si duhet kuptimin e mesazhit qendror të një teksti ne duhet ta lidhim atë me mësimin e tërë Biblës siç na e ka përcjellë Kisha. Ky është një parim i rëndësishëm i interpretimit biblik që e pranon se Shpirti i Shenjtë nuk ka frymëzuar vetëm një pjesë të Biblës, por

Biblën të tërë dhe që në disa vende njerëzit janë rritur në të kuptuarit e vullnetit të Hyjit në bazë të përvojës së tyre personale. Po ashtu shmang interpretime të gabuara ose të pjesshme që bien në kundërshtim me mësimet e tjera të Shkrimeve, por nuk do të thotë që ne mund ta dobësojmë theksimin e veçantë të një teksti të cilin jemi thirrur ta predikojmë. Një nga të metat e një predikimi të mërzitshëm dhe të pasuksesshëm është pikërisht paaftësia e tij për të përcjellë fuqinë e brendshme të tekstit që është shpallur.

Personalizimi i fjalës

149. Predikuesi “duhet para së gjithash të kultivojë një familjaritet të madh personal me fjalën e Zotit. Njohja aspekteve të saj gjuhësore ose ekzegjetike, megjithëse sigurisht e nevojshme, nuk mjafton. Ai duhet t’i afrohet fjalës me një zemër të butë e të fuqishme në mënyrë që të depërtojë thellë në mendimet e ndjenjat e tij dhe të sjellë një perspektivë të re në të”¹¹⁵. Është mirë për ne që

¹¹⁵ Gjon Pali II, Porosi post-sinodale apostolike *Pastores Dabo Vobis* (25 mars 1992), 26: AAS 84 (1992), 698.

ta ripërtërijmë zellin tonë çdo ditë dhe çdo të diel, ndërsa përgatitim homelinë, duke shqyrtuar veten për të parë nëse jemi rritur në dashurinë për fjalën që predikojmë. As nuk duhet të harrojmë se “shkalla e ulët apo e lartë e shenjtërisë së ministrit ka një efekt të vërtetë mbi shpalljen e Fjalës”¹¹⁶. Siç thotë Shën Pali: “jo, sikurse të donim t’u pëlqejmë njerëzve, por Hyjit që i shqyrton zemrat tona” (1 Sel 2,4). Nëse kemi një dëshirë të gjallë që të jemi të parët që dëgjojmë fjalën që duhet të predikojmë, kjo me siguri do t’i komunikohet popullit të Zotit “ç’ka zemra qet goja!” (Mt 12,34). Leximet e së dielës do të jehojnë me tërë shkëlqimin e tyre në zemrat e besimtarëve nëse kanë jehuar më parë në zemrën e Bariut të tyre.

150. Jezusi zemërohej me të ashtuquajturit mësues që u kërkonin shumë të tjerëve, duke mësuar fjalën e Zotit pa qenë ndriçuar prej saj: “Ata lidhin barrë të rënda që mezi mund të barten dhe ua ngarkojnë njerëzve në krahë, kurse vetë as me gisht nuk i luajnë” (Mt 23,4). Apostulli Jakob porosiste: “Vëllezërit e mi, mos u bëni shumë mësues, duke e ditur se do të gjykohemi më rëndë” (Jak

¹¹⁶ *Ibid.*, 25: AAS 84 (1992), 696.

3,1). Kushdo që dëshiron të predikojë duhet të jetë i pari që ta lërë fjalën e Zotit ta prekë thellë dhe të mishërohet në jetën e tij të përditshme. Në këtë mënyrë predikimi do të konsistojë në atë veprimtari intensive dhe të frytshme, çka shërben “t’u komunikojë të tjerëve atë që ka soditur vetë”¹¹⁷. Prandaj, para se të përgatisim atë që do të themi gjatë predikimit, ne duhet ta lëmë veten që të përshkohemi nga fjala që do të përshkojë edhe të tjerët, sepse është një fjalë e gjallë dhe aktive, si një shpatë “Përshkon aq sa ndan frymën dhe shpirtin, gjymtyrët dhe palcin, edhe shqyrton ndjenjat dhe dëshirat e zemrës” (Heb 4,12). Kjo ka një rëndësi të madhe baritore. Edhe sot, njerëzit preferojnë të dëgjojnë dëshmitarët: ata “kanë etje për vërtetësi” dhe “kërkojnë për ungjillëzues që të flasin për një Zot të cilin e njohin dhe që të jetë i njohur për ta, sikur ta shikonin atë që është i Padukshmi”¹¹⁸.

151. Nuk na kërkohet që të jemi të papërlyer, por që të jemi gjithnjë në rritje, që të përjetojmë dëshirën e thellë për të ecur përpara përgjatë shtegut të Ungjillit, e të mos bëhemi të ngathët

¹¹⁷ Sh’ Tomë Akuinati, S. Th. II-II, q. 188, a. 6.

¹¹⁸ Pali VI, Porosia Apostolike *Evangelii Nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 76: AAS 68 (1976), 68.

apo të plogësht. Çfarë është esenciale është që predikuesi të jetë i sigurt se Zoti e do, që Jezu Krishti e ka shpëtuar atë dhe që dashuria e tij e ka gjithnjë fjalën e fundit. Duke u përballur me një bukuri të tillë, ai do të ndjejë shpesh që jeta e tij nuk e lavdëron Hyjin ashtu si duhet dhe ai do të dëshirojë sinqerisht që të përgjigjet më mirë ndaj një dashurie kaq të madhe. Megjithatë nëse ai nuk ndalet që të dëgjojë fjalën e Zotit me një zemër të hapur, nëse nuk e lejon që t'i prekë jetën, ta sfidojë, ta nxisë atë dhe nëse nuk kushton një farë kohe për t'u lutur me atë fjalë, atëherë ai do të jetë një profet i rremë, një mashtrues, apo një sharlatan. Por duke e pranuar varfërinë e tij dhe duke dëshiruar që të përkushtohet edhe më shumë, ai mund të dhurojë gjithnjë Krishtin, duke thënë në fjalët e Pjetrit: "Unë nuk kam as argjend, as ar, por po të jap çka kam" (Vap 3,6). Zoti dëshiron që të na përdorë ne si qenie të gjalla, të lira dhe krijuese që e lënë fjalën të përshkojë zemrat e tyre para se t'ua përcjellin të tjerëve. Mesazhi i Krishtit duhet të përshkojë dhe zotërojë me të vërtetë predikuesin, jo thjesht arsyen e tij apo intelektin por tërë qenien e tij. Shpirti i Shenjtë, që ka frymëzuar Fjalën, është po Ai që "sot, ashtu si në fillimet e Kishës, vepron

në çdo ungjilltar që e lejon veten të zotërohet e të udhëhiqet prej tij, që i sugjeron fjalët të cilat vetë nuk do t'i gjente".¹¹⁹

Leximi shpirtëror

152. Ka një mënyrë të veçantë të dëgjuarit të asaj që Zoti dëshiron të na thotë në fjalën e tij dhe që ta lëmë veten të shndërrohemi nga Shpirti i tij. Kjo është ajo që e quajmë "*lectio divina*". Ajo konsiston në të lexuarit e fjalës së Zotit gjatë një çasti lutjeje dhe në të lejuarit që të na ndriçojë dhe të na ripërtërijë. Ky lexim lutës i Biblës nuk është diçka e shkëputur nga studimi që ka kryer predikuesi për të identifikuar mesazhin qendror të tekstit. Në të kundërtën, ai duhet të nisë me atë studim dhe pastaj të vazhdojë për të dalluar sesi i flet po ky mesazh jetës së tij. Leximi shpirtëror i një teksti duhet të nisë me kuptimin literal të tij. Sepse përndryshe do ta bëjmë tekstin të thotë atë që mendojmë se është e përshtatshme, atë që duhet për të përforcuar vendimet tona, në përputhje me mendësinë tonë. Kjo në fund të fundit do të nënkuptonte përdorimin e diçkaje të

¹¹⁹ Ibid., 75: AAS 68 (1976), 65.

shenjtë për të mirën tonë dhe pastaj t'ia përcillnim këtë konfuzion Popullit të Zotit. Ne nuk duhet të harrojmë kurrë që ndonjëherë “edhe Satani maskohet si engjell i dritës” (2 Kor 11,14).

153. Në praninë e Zotit, gjatë një leximi të qetë të tekstit, është mirë të pyesim, për shembull: “Zot, çfarë po më thotë ky tekst? Çfarë dëshiron të ndryshosh në jetën time me anë të këtij teksti? Çfarë më shqetëson në këtë tekst? Pse kjo nuk më intereson? Ose: “çfarë më pëlqen në këtë tekst? Çfarë ka në këtë fjalë që më nxit e më tërheq dhe pse më tërheq?” Kur ne bëjmë një përpjekje për të dëgjuar Zotin, do të dalin tundime, njëra prej të cilave është të ndjehesh i trazuar apo rënduar dhe të largohesh. Një tjetër tundim i zakonshëm është të mendosh se çfarë do të thotë teksti për të tjerët, për të shmangur zbatimin ndaj jetës sonë. Mund të ndodhë që ne kërkojmë pretekste për të holluar kuptimin e qartë të tekstit. Ose mendojmë se Zoti po kërkon shumë prej nesh, duke kërkuar për një vendim të cilin ne nuk jemi gati ta bëjmë. Kjo bën që shumë njerëz të humbasin gëzimin e takimit me Fjalën, gjë që do të thotë të harrosh se nuk ka më të durueshëm se Hyji Ati ynë, dhe se nuk na

ka asnjë që të na kuptojë dhe të jetë i gatshëm të na presë. Ai na fton gjithnjë që të bëjmë një hap përpara, por nuk kërkon një përgjigje të plotë nëse nuk jemi ende gati. Ai thjesht na kërkon që të shohim sinqerisht në jetën tonë dhe të dalim pa u shtirur para tij, si dhe që të jemi të gatshëm për t'u rritur gjithnjë e më shumë, duke i kërkuar Atij atë që nuk e kemi arritur ende.

Të dëgjosh njerëzit

154. Predikuesi gjithashtu duhet të dëgjojë *popullin* dhe të zbulojë se çfarë besimtarët kanë nevojë të dëgjojnë. Një predikues duhet të sodisë Fjalën, por duhet të sodisë edhe popullin e tij. Në këtë mënyrë ai mëson për “aspiratat, pasuritë dhe kufizimet, mënyrat e të luturit, të të dashurit, këndvështrimin ndaj botës dhe jetës, që dallojnë këtë apo atë grup njerëzor”, duke iu kushtuar vëmendje “njerëzve aktualë, duke përdorur gjuhën e tyre, shenjat dhe simbolet, në përgjigje të pyetjeve që ata kanë” ¹²⁰. Ai duhet të jetë në gjendje që të lidhë mesazhin e një teksti biblik me një situatë njerëzore, me

¹²⁰ *Ibid.*, 63: AAS 68 (1976), 53

një përvojë që ka nevojë për dritën e Hyjit. Ky interesim nuk ka fare të bëjë me pragmatizëm apo diplomaci, por është thellësisht fetar dhe baritor. Kryesisht ai është një “ndjeshmëri shpirtërore e vërtetë për të lexuar mesazhin e Zotit në ngjarje të ndryshme”¹²¹ dhe kjo është shumë më tepër sesa thjesht të gjesht diçka interesante për të thënë. Ne po kërkojmë për “atë që Zoti ka për të thënë në këtë apo atë rrethanë të veçantë”¹²². Pra përgatitja për predikimin bëhet një ushtrim në dallimin ungjillor, në të cilin përpiqemi të dallojmë, në dritën e Shpirtit, atë “thirrje” që Zoti e bën të për t’i bërë jehonë situatës së caktuar historike. Në këtë situatë dhe përmes saj, Zoti e thërret besimtarin”¹²³.

155. Në këtë përpjekje ne mund të mendojmë për ndonjë përvojë të zakonshme njerëzore si një ribashkim i gëzueshëm, një çast zhgënjimi, frika e të qenit vetëm, dhembshuri në vuajtjet e të tjerëve, pasiguri për të ardhmen, shqetësim për një të dashur dhe kështu me radhë. Por ne

¹²¹ *Ibid.*, 43: AAS 68 (1976), 33

¹²² *Ibid.*

¹²³ Gjon Pali II, Porosi post-Sinodale apostolike *Pastores Dabo Vobis* (25 mars 1992), 10: AAS 84 (1992), 672.

duhet të kultivojmë një ndjeshmëri të gjerë dhe të thellë ndaj asaj që i prek me të vërtetë jetët tona. Le të kujtojmë që ne nuk duhet t’u përgjigjemi kurrë pyetjeve që askush nuk na i bën. As nuk është e udhës që të flasim për lajmin më të fundit që të zgjojmë interesimin e njerëzve, pasi kemi programet televizive për këtë. Por është e mundur që të fillojmë me ndonjë fakt apo histori, që fjala e Zotit të kumbojë me forcë në thirrjen e saj për kthim, adhurim, përkushtim ndaj vëllazërisë dhe shërbimit, e kështu me radhë. E megjithatë do të jetë gjithnjë dikush që i dëgjon me ëndje komentet mbi çështje të ndryshme aktuale, pa e lënë veten që të sfidohet personalisht.

Mjete pedagogjike

156. Disa njerëz mendojnë se mund të jenë predikues të mirë sepse dinë se çfarë duhet të thonë, por ata nuk i kushtojnë vëmendje mënyrës sesi duhet thënë, pra mënyrës konkrete sesi duhet hartuar një predikim. Ata ankohen kur njerëzit nuk i dëgjojnë apo nuk i vlerësojnë ata, por ndoshta ata nuk e kanë marrë kurrë mundimin që të gjejnë

mënyrën e duhur për ta paraqitur mesazhin e tyre. Le të kujtojmë se “rëndësia e dukshme e përmbajtjes së ungjillëzimit nuk duhet të fshehë rëndësinë e mjeteve dhe rrugëve”¹²⁴. Preokupimi për mënyrën sesi predikojmë është po ashtu një preokupim thellësisht shpirtëror. Ai nënkupton t’i përgjigjesh dashurisë së Zotit duke i vënë të gjitha talentet dhe krijimtarinë tonë në shërbim të misionit që ai na ka dhënë dhe në të njëjtën kohë është një ushtrim i shkëlqyer i dashurisë ndaj të afërmit, duke refuzuar që t’u ofrojmë të tjerëve një produkt me cilësi të dobët. Për shembull, në Bibël, ne mund të gjejmë këshilla sesi të përgatisim një homeli, që t’i arrijmë sa më mirë njerëzit: “Fol sa më pak, duke thënë shumë gjëra me pak fjalë” (Sir 32,8).

157. Vetëm për të sjellë disa shembuj, le të kujtojmë disa burime praktike që mund të na pasurojnë predikimin tonë dhe ta bëjë sa më tërheqëse. Një nga gjërat më të rëndësishme është të mësosh sesi të përdorësh imazhe gjatë predikimit, pra të flasësh me imazhe. Ndonjëherë shembujt

¹²⁴ Pali VI, Porosia Apostolike *Evangelii Nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 40: AAS 68 (1976), 31.

përdoren për të qartësuar ndonjë pikë të caktuar, por këta shembuj kanë të bëjnë me mendjen, kurse imazhet nga ana tjetër i ndihmojnë njerëzit që të vlerësojnë dhe pranojnë mesazhin që duam të përcjellim. Një imazh tërheqës e bën mesazhin të duket i njohur, diçka e afërt, praktike dhe aktuale. Një imazh i suksesshëm i ndihmon njerëzit që të shijojnë mesazhin, duke zgjuar dëshirat dhe duke e drejtuar vullnetin ndaj Ungjillit. Një homeli e mirë, një siç më ka thënë një mësues i vjetër, duhet të ketë “një ide, një ndjenjë dhe një imazh”.

158. Pali i VI thoshte se “besimtarët presin shumë nga predikimi dhe do të përfitojnë shumë prej këtij, mjafton që të jetë i thjeshtë, i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i përshtatshëm”¹²⁵. Thjeshtësia ka të bëjë me gjuhën që përdorim. Duhet të jetë gjuha që njerëzit kuptojnë, sepse ndryshe do flasim kot. Predikuesit shpesh përdorin fjalë të mësuara gjatë studimeve dhe në mjedise të specializuara që nuk janë pjesë e gjuhës së zakonshme të dëgjuesve. Këto janë fjalët që janë të përshtatshme në teologji, ose katekizëm, por që kuptimi i të cilëve nuk është i kuptueshëm ndaj shumicës së krishterëve. Rreziku më i madh

¹²⁵ *Ibid.*, 43: AAS 68 (1976), 33.

për një predikues është që ai të mësohet sa më shumë me gjuhën e tij saqë të mendojë se të tjerët do ta kuptojnë natyrshëm dhe do ta përdorin. Nëse duam të përdorim gjuhën e njerëzve dhe t'i arrijmë me fjalën e Zotit, ne duhet ta ndajmë atë në jetët e tyre dhe t'u kushtojmë vëmendje të përzemërt. Thjeshtësia dhe qartësia janë dy gjëra të ndryshme. Gjuha jonë mund të jetë e thjeshtë por predikimi ynë nuk është mjaft i qartë. Mund të rezultojë e pakuptueshme sepse është e çorganizuar, pa logjikë progresive ose përpiket të merret me shumë gjëra përnjëherësh. Ne duhet të sigurohemi pra që homelia të ketë unitet tematik, rregull të qartë dhe lidhje midis fjalive, në mënyrë që njerëzit ta ndjekin predikuesin lehtësisht dhe ta kuptojnë logjikën e argumentit të tij.

159. Një tjetër tipar i një homelie të mirë është gjuha pozitive. Nuk merret aq shumë me atë që nuk duhet bërë, por me sugjerimin se çfarë mund të bëjmë më mirë. Sidoqoftë, nëse tërheq vëmendjen ndaj diçkaje negative, do të përpiket gjithashtu të tregojë një vlerë pozitive dhe tërheqëse, që të mos zhytet në ankesa, qarje, kritika dhe qortime. Predikimi pozitiv ofron gjithnjë shpresë, të orienton ndaj të ardhmes, duke mos

na lënë që të na burgosë negativiteti. Sa mirë është kur priftërinjtë, xhakonjtë dhe laikët të mblidhen periodikisht për të zbuluar burimet që mund ta bëjnë predikimin sa më tërheqës!

IV. UNGJILLËZIM NËPRMJET THELLIMIT TË KERIGMËS

160. Mandati misionar i Zotit përfshin një thirrje ndaj rritjes në fe: “Mësojini të zbatojnë gjithçka ju kam urdhëruar!” (Mt 28,20). Prandaj është e qartë se shpallja e parë kërkon gjithashtu një formim dhe maturim të vazhdueshëm. Ungjillëzimi synon një proces rritjeje, duke përfshirë edhe faktin që e merr seriozisht çdo person dhe planin e Zotit për jetën e tij ose të saj. Ne të gjithë kemi nevojë të rritemi në Krishtin. Ungjillëzimi duhet të nxisë një dëshirë për këtë rritje, në mënyrë që secili prej nesh të mund të thotë me gjithë zemër: “jetoj, por jo më unë, në mua jeton Krishti” (Gal 2,20).

161. Nuk do të ishte e drejtë ta shikoje këtë thirrje për rritje ekskluzivisht ose kryesisht në raport me formimin doktrinor. Ka të bëjë me “vëzhgimin” e gjithçkaje që na ka treguar Zoti si

përgjigje ndaj dashurisë së tij, ku nxjerr në pah, bashkë me të gjitha virtytet, atë urdhërim të ri që është urdhërimi i parë dhe më i madhi, ai që më së miri na identifikon si nxënës të Krishtit: “Ky është urdhri im: dua jeni njëri-tjetrin sikurse unë ju desha ju!” (Gjn 15,12). Është e qartë sesa herë që autorët e Besëlidhjes së Re duan të paraqesin zemrën e mesazhit moral, ata paraqesin kërkesën esenciale të dashurisë për të afërmin: “ai që e do tjetrin, e ka plotësuar Ligjin... Dashuria, pra, është zbatimi i përsosur i Ligjit” (Rom 13,8.10). “S’ka dyshim, në qoftë se e zbatoni ligjin mbretëror si thotë Shkrimi i shenjtë: »*Duaje të afërmin tënd si vetveten!*«, atëherë bëni mirë” (Jak 2,8). “Sepse i tërë Ligji përmbledhet në këtë urdhër: “*Duaje të afërmin tënd porsì vetveten!*” (Gal 5,14). Pali u paraqet bashkësive të tij jetën e krishterë si një rrugëtim të rritjes në dashuri: “Bëftë Zoti që të rritet e të shtohet përherë e më tepër dashuria juaj ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj të gjithë njerëzve siç është dashuria jonë ndaj jush!” (1 Sel 3,12).

162. Nga ana tjetër ky proces i reagimit dhe rritjes paraprihet gjithnjë nga kërkesa tjetër e Zotit: “pagëzoni në emër...” (Mt 28,19). Birësimi që Ati

dhuron falas është iniciativa e dhuratës së hirit të tij (krh. Ef 2,8-9; 1 Kor 4,7) përbëjnë kushtin e mundësisë të këtij shenjtërimi të përhershëm që i pëlqen Zotit dhe i jep lavdi. Në këtë mënyrë ne e lëmë veten të shndërrohem në Krishtin përmes një jete të jetuar “sipas Shpirtit” (Rom 8,5).

Katekizmat kerigmatike dhe mistagogjike

163. Edukimi dhe katekizmi janë në shërbim të kësaj rritjeje. Ne tashmë zotërojmë një numër dokumentesh magjisteriale dhe ndihmesash mbi katekizmin, të lëshuara nga Selia e Shenjtë dhe nga Episkopate të ndryshme. E kam fjalën në veçanti për Porosinë Apostolike *Catechesi Tradendae* (1979), *Udhëzuesi apo doracaku i përgjithshëm për katekizmin* (1997) dhe dokumente të tjera përmbajtjen aktuale të të cilave nuk po e përsëris këtu. Por doja të ndalesha vetëm në disa konstatime të shkurtra që besoj se janë të rëndësishme.

164. Edhe në katekizëm, ne kemi zbuluar rolin themelor të kumtimit të parë apo “*kerigmës*”, që duhet të zërë qendrën e çdo veprimtarie

ungjillëzuese dhe të çdo përpjekjeje për ripërtëritjen në Kishë. Kerigma është trinitare. Zjarri i Shpirtit jepet në formën e gjuhëve dhe na nxit të besojmë te Jezui Krishti, i Cili me anë të vdekjes dhe ringjalljes së tij, na zbulon dhe na komunikon mëshirën e pafund të Atit. Në buzët e katekistit duhet të kumbojnë vazhdimisht fjalët e kumtimit të parë: “Jezui Krishti të do, ai e dha jetën e tij për të të shpëtuar dhe tani jeton çdo ditë në kraharorin tënd për të të ndriçuar, forcuar dhe çliruar”. Ky kumtim i parë quhet “i pari” jo sepse ka ekzistuar në fillim dhe mund të harrohet më vonë apo të zëvendësohet me gjëra më të rëndësishme, por është i pari në kuptimin sasior, sepse është kumtimi *kryesor*, ai që duhet të dëgjojmë vazhdimisht në mënyra të ndryshme dhe është ai që duhet ta shpallim në një farë mënyre gjatë procesit të katekizmit, në çdo nivel dhe në çdo çast¹²⁶. Për këtë arsye, edhe “meshtari, si çdo pjesëtar i Kishës, duhet të vetëdijësohet gjithnjë e më shumë për nevojën e vazhdueshme që ka për t’u ungjillëzuar”¹²⁷.

¹²⁶ Shih *Propositio* 9.

¹²⁷ Gjon Pali II, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Pastores Dabo Vobis* (25 mars 1992), 26: AAS 84 (1992), 698.

165. Ne nuk duhet të mendojmë se në katekizëm *kerigma* i lë vendin një formimi që supozohet se është më “solid”. Asgjë nuk është më solide, e thellë, e sigurt, më kuptimplote dhe e urtë sesa kumtimi fillestar. I tërë formimi konsiston para së gjithash në thellimin e kerigmës, që reflektohet dhe ndriçon pareshtur shërbesën katekizmore, duke na aftësuar kështu që të kuptojmë më mirë domethënien e çdo subjekti që trajtohet në të. Është pikërisht mesazhi që i përgjigjet dëshirës për të pafundmen që banon në çdo zemër njerëzore. Epërsia e kerigmës kërkon disa veçori të kumtimit të cilat sot janë mjaft të nevojshme: duhet të shprehë dashurinë shpëtuese të Hyjit që i paraprin çdo detyrimi moral dhe fetar nga ana jonë; nuk duhet të imponojë të vërtetën por t’i bëjë thirrje lirisë; duhet të karakterizohet nga gëzimi, inkurajimi, vitaliteti dhe një balancë e harmonishme që nuk do ta reduktojë predikimin në disa doktrina që janë disa herë më shumë filozofike sesa ungjillore. Kjo kërkon nga ana e ungjillëzuesit disa qëndrime që do të ndihmojnë në pranimin më të mirë të kumtimit, siç janë: afërsia, gatishmëria për dialog, durimi, e mikpritja e përzemërt që nuk gjykon.

166. Një aspekt tjetër i katekizmit që është zhvilluar në dekadat e fundit është fillesa *mistagogjike*¹²⁸. Kjo ka të bëjë kryesisht me dy gjëra: një përvojë progresive e formimit që përfshin tërë komunitetin dhe një vlerësim i ri i shenjave liturgjike të fillesës së krishterë. Shumë manuale dhe programe nuk e kanë marrë mjaftueshëm në konsideratë nevojën për një ripërtëritje mistagogjike, një nevojë që mund të marrë forma mjaft të ndryshme, në përputhje me dallimin e çdo komuniteti edukativ. Katekizmi është një shpallje e fjalës dhe fokusohet gjithnjë te fjala e megjithatë kërkon një mjedis të përshtatshëm dhe një paraqitje tërheqëse, përdorimin e simboleve shprehëse, përfshirjen në një proces më të gjerë rritjeje dhe integrimin e çdo dimensionit të personit brenda një rrugëtimi komunitar të të dëgjuarit dhe reaguarit.

167. Do të ishte mirë që çdo formë e katekizmit t'i kushtojë vëmendje “udhës së bukurisë” (*via pulchritudinis*)¹²⁹. Të shpallësh Krishtin do të thotë të tregosh se të besosh dhe ta ndjekësh Atë nuk është vetëm diçka e drejtë dhe e vërtetë por edhe diçka e

bukur, që mund ta mbushin jetën me shkëlqim të ri dhe gëzim të thellë edhe në mes të vështirësive. Në këtë perspektivë, të gjitha shprehjet e bukurisë së vërtetë mund të pranohen si një shteg që të çon në një takim me Zotin Jezus. Kjo nuk ka të bëjë fare me të ushqyerit e një relativizmi estetik¹³⁰, që mund të errësojë lidhjen e pandashme midis të vërtetës, mirësisë dhe bukurisë, por me një ri-vlerësim të bukurisë si një mjet për të prekur zemrën njerëzore dhe për të shndritur në të mirësinë e Krishtit të ngjallur. Nëse, siç thotë Shën Agustini, ne duam vetëm atë që është e bukur¹³¹, Biri i mishëruar, si zbulesa e bukurisë së pafund është tërësisht i dashur dhe na tërheq pranë vetes me lidhje dashurie. Prandaj bëhet e nevojshme që formimi në *via pulchritudinis* të përfshihet në përcjelljen e fesë. Çdo Kishë e veçantë duhet të nxisë përdorimin e arteve në ungjillëzim, duke ndërtuar mbi thesaret e të kaluarës por edhe mbi gjerësinë e shprehjeve të shumta aktuale, me qëllimin për ta përcjellë besimin në një “gjuhë

¹²⁸ Shih *Propositio* 38.

¹²⁹ Shih *Propositio* 20.

¹³⁰ Shih Konc. Ekum. i II i Vat., Dekreti mbi Mjetet shoqërore të komunikimit *Inter Mirifica*, 6.

¹³¹ Shih *De Musica*, VI, 13, 38: PL 32, 1183-1184; *Confessiones*, IV, 13.20: PL 32, 701.

shëmbëlltyrash” të re.¹³² Duhet pasur kurajë për të zbuluar shenja e simbole të reja, si dhe mish të ri për mishëruar e komunikuar fjalën dhe forma të ndryshme bukurie që vlerësohen në mjedise të ndryshme kulturore, duke përfshirë ato forma jokonvencionale të bukurisë të cilat megjithëse mund të mos kenë shumë domethënie për ungjillëzuesit, rezultojnë veçanërisht tërheqëse për të tjerët.

168. Për sa i përket propozimit moral të katekizmit, që nxit rritje në besnikëri ndaj mënyrës së të jetuarit sipas Ungjillit, është e dobishme që të theksohet vazhdimisht e mira e dëshirueshme, propozimi i jetës, i pjekurisë, i vetëpërmbyshjes dhe pjellorisë, në dritën e të cilave mund të kuptohet mohimi i të këqijave që e rrezikojnë këtë jetë. Në vend që të jemi ekspertë në parashikime apokaliptike apo gjykatës të errët që kënaqen duke zbuluar çdo rrezik ose devijim, ne duhet të shihemi si lajmëtarë të gëzueshëm të propozimeve sfiduese, kujdestarë të së mirës dhe bukurisë që shkëlqejnë në një jetë besnike ndaj Ungjillit.

¹³² Benedikti XVI, Fjalim me rastin e shfaqjes së dokumentarit “*Arti dhe feja*” – Via Pulchritudinis (25 tetor 2012); L’Osservatore Romano (27 October 2012), 7.

Shoqërim personal në proceset e rritjes

169. Në një kulturë që vuan paradoksalisht, e plagosur nga anonimati e në të njëjtën kohë e marrosur pas detajeve të jetës së të tjerëve dhe e sëmure nga një kureshtje patologjike, Kisha duhet të shikojë nga afër dhe me dhembshuri njerëzit, sa herë që është e nevojshme. Në botën tonë, ministrat e vajosur dhe punëtorët e tjerë pastoralë mund ta bëjnë të pranishme aromën e afërsisë dhe vështrimin personal të Jezusit. Kisha duhet t’i përfshijë pjesëtarët e vet: meshtarë, rregulltarë dhe laikë në këtë “art të shoqërimit” që na mëson t’i heqim sandalet përpara tokës së shenjtë të tjetrit (krh. Eksodi 3:5). Kjo ecje duhet të ketë një ritëm të qëndrueshëm e të sigurt, me një vështrim respektues dhe plot dhembshuri, që të sjellë shërim, çlirim dhe të nxisë rritje në jetën e krishterë.

170. Megjithëse duket e qartë, shoqërimi shpirtëror duhet t’i afrojë njerëzit edhe më afër Hyjit, tek i cili mund ta arrijmë lirinë e vërtetë. Disa njerëz mendojnë se janë të lirë duke e shmangur Zotin, pa e kuptuar që janë ekzistencialisht jetimë,

papërkrahje dhe pa një strehë ku të fusin kokën në mbrëmje. Ata pushojnë së qeni shtegtarë por shndërrohen në endacakë, që vetëm sa vijnë vërdallë pa shkuar gjëkund. T'i shoqërosh ata do të ishte antiproduktive nëse do të bëhej një farë terapie që e përkrah mbylljen brenda vetes, pa qenë më shtegtarë së bashku me Krishtin drejt Atit.

171. Sot më shumë se kurrë na duhen burra e gra që në bazë të përvojës së tyre të shoqërimit të tjerëve, të njohin mirë proceset që kërkojnë urtësi, aftësi për të kuptuar, durim e butësi ndaj Shpirtit, në mënyrë që të mbrojnë delet nga ujçërit që duan të shpërndajnë kopenë. Ne duhet të praktikojmë artin e të dëgjuarit që është më shumë se të dëgjuarit. Gjëja e parë në komunikimin me të tjerët është hapja e zemrës që e bën të mundur afërsinë, pa të cilën nuk mund të ketë takim të vërtetë shpirtëror. Të dëgjuarit na ndihmon që të gjejmë gjestin e fjalën e duhur e cila tregon se jemi më shumë se spektatorë të thjeshtë. Vetëm në sajë të një dëgjimi të tillë plot dhembshuri dhe respekt mund të gjenden rrugët për një rritje të vërtetë e mund të zgjohet një dëshirë për idealin e krishterë:

dëshira për t'iu përgjigjur plotësisht dashurisë së Zotit dhe për të përmbushur atë që Zoti ka mbjellë në jetën tonë. Por kjo kërkon gjithnjë durimin e atij që e di mirë atë çfarë na thotë Shën Toma: se çdo njeri mund të ketë hir dhe dashuri dhe megjithatë mund të mos i ushtrojë mirë virtytet për shkak të “prirjeve të kundërta”¹³³. Me fjalë të tjera, uniteti organik i virtyteve ekziston gjithnjë dhe domosdoshmërisht “*in habitu*”, ndonëse kushtëzimet mund të pengojnë veprimet e këtyre zakoneve të virtytshme. Nga kjo buron nevoja për “një pedagogji që do t'i njohë njerëzit hap pas hapi drejt përvetësimit të misterit”¹³⁴. Për të arritur një nivel pjekurie ku individët mund të marrin vendime krejt të lira dhe të përgjegjshme, nevojitet shumë kohë e durim. Siç thoshte i lumi Pjetër Favre: “Koha është lajmëtari i Zotit”.

172. Ai që shoqëron të tjerët duhet të kuptojë se situata e çdo personi para Zotit dhe jetës së tyre është një mister që askush nuk mund ta njohë plotësisht nga jashtë. Ungjilli na thotë që

¹³³ S. Th., I-II, q. 65, a. 3, ad 2: “propter aliquas dispositiones contrarias”.

¹³⁴ Gjon Pali II, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Ecclésia in Asia* (6 nëntor 1999), 20: AAS 92 (2000), 481.

t'i korrigjojmë të tjerët dhe t'i ndihmojmë që të rriten në bazë të pranimi të ligësisë objektive të veprimeve të tyre (krh. Mat 18,15), por pa bërë gjykimë mbi përgjegjësinë dhe fajësinë e tyre (krh. Mat 7,1; Luka 6,37). Dikush që është i mirë me një shoqërim të tillë nuk dorëzohet përpara frikës apo dështimit. I fton gjithnjë të tjerët që të shërohen, të ngrihen, të përqafojnë kryqin, të lënë gjithçka nga pas e të dalin vazhdimisht për të shpallur Ungjillin. Përvoja që kemi personalisht për ta lënë veten të shoqërohem i të shërohem i, duke ia dalë që të shprehim me sineritet jetën tonë përpara atij që na shoqëron, na mëson që të jemi të durueshëm dhe të dhembshur me të tjerët dhe të gjejmë rrugën e duhur për të zgjuar besimin dhe gatishmërinë e tyre për t'u rritur.

173. Shoqërimi i vërtetë shpirtëror fillon gjithnjë dhe ecën përpara në kontekstin e shërbimit ndaj misionit të ungjillëzimit. Marrëdhënia e Palit me Timoteun e Titin na jep një shembull të këtij shoqërimi dhe formimi që ndodh gjatë të veprimit apostolik. Duke iu besuar misionin e të ndaluarit në çdo qytet “çka mbetet për t'u rregulluar” (Tit 1,5; shiko dhe 1 Tim 1,3-5), Pali u jep rregulla për

jetët e tyre personale dhe veprimtarinë baritore. Kjo është mjaft e ndryshme nga çdo lloj shoqërimi i bezdisshëm ose vetë-përmbushje e izoluar. Dishepujt misionarë i shoqërojnë dishepujt misionarë.

Rreth Fjalës së Hyjit

174. Jo vetëm që homelia duhet të ushqehet me fjalën e Hyjit, por i gjithë ungjillëzimi themelohet mbi atë fjalë, të dëgjuar, të medituar, të jetuar, të kremtuar dhe të dëshmuar. Shkrimi i Shenjtë është burimi i ungjillëzimit. Si pasojë, ne duhet të jemi vazhdimisht të përgatitur për të dëgjuar fjalën. Kisha nuk ungjillëzon nëse nuk e lë veten që të ungjillëzohet vazhdimisht. Është e domosdoshme që fjala e Zotit të “bëhet gjithnjë e më shumë zemra e çdo veprimtarie të kishës”¹³⁵. Fjala e Zotit, e dëgjuar dhe e kremtuar, mbi të gjitha në Eukaristi, i ushqen dhe i forcon të krishterët, duke i aftësuar që të japin një dëshmi të vërtetë ndaj Ungjillit në jetën e përditshme. Tashmë kemi kohë që e kemi kapërcyer atë kundërvënie midis fjalës

¹³⁵ Benedikti XVI, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Verbum Domini* (30 shtator 2010), 1: AAS 102 (2010), 682.

dhe sakramentit. Predikimi i fjalës, i gjallë dhe efektiv, të përgatit për marrjen e sakramentit, në të cilin ajo fjalë arrin efektshmërinë e vet maksimale.

175. Studimi i Shkrimeve të Shenjta duhet të jetë një derë e hapur ndaj çdo besimtari¹³⁶. Është esenciale që fjala e zbuluar të pasurojë rrënjësisht katekizmin tonë dhe të gjitha përpjekjet tona për të përcjellë besimin¹³⁷. Ungjillëzimi kërkon familjaritet me fjalën e Hyjit, që kërkon prej dioqezave, famullive dhe shoqatave katolike që të sigurojnë një studim serioz e të vazhdueshëm të Biblës, ashtu si dhe të nxisë një lexim lutës personal dhe komunitar¹³⁸. Ne nuk kërkojmë duke u lëkundur në errësirë, as nuk duhet të presim që të na drejtojë fjalë, sepse “Hyji ka folur tashmë dhe nuk është më, i panjohuri më i madh, por e ka treguar vetveten”¹³⁹. Le ta marrim thesarin sublim të Fjalës së zbuluar.

¹³⁶ Shih *Propositio* 11.

¹³⁷ Shih Konk. Ekum. Vat. II, Kushtetuta Dogmatike mbi Zbuluesin Hyjnore *Dei Verbum*, 21-22.

¹³⁸ Shih Benedikti XVI, Porosia Apostolike Post-Synodale *Verbum Domini* (30 shtator 2010), 86-87: AAS 102 (2010), 757-760.

¹³⁹ Benedikti XVI, *Meditim gjatë Kongregacionit të parë të përgjithshëm të sinodit të ipeshkvijve* (8 tetor 2012): AAS 104 (2012), 896.

KREU IV

PËRMASA SHOQËRORE E UNGJILLËZIMIT

176. Të ungjillëzosh do të thotë ta bësh mbretërinë e Hyjit të pranishme në botën tonë. Por “asnjë përkufizim i pjesshëm dhe fragmentar nuk mund t’i japë arsye realitetit të pasur, kompleks dhe dinamik, si ai i ungjillëzimit, pa u rrezikuar që ta reduktojë apo dhe ta shtrembërojë”¹⁴⁰. Tani dua që të ndaj shqetësimet e mia mbi përmasën shoqërore të ungjillëzimit, pikërisht sepse nëse kjo përmasë nuk del në pah, ekziston një rrezik serioz i deformimit të kuptimit autentik e integral të misionit të ungjillëzimit.

I. NDIKIMET E PËRGJITHSHME DHE ATO SHOQËRORE TË KERIGMËS

177. Kerigma ka një përmbajtje të qartë shoqërore: në zemrën e Ungjillit gjenden jeta në komunitet dhe përkushtimi me të tjerët. Përmbajtja e shpalljes

¹⁴⁰ Pali VI, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Evangelii Nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 17: AAS 68 (1976), 17.

së parë ka një ndikim të drejtpërdrejtë moral të fokusuar pas dashurisë vëllazërore.

Rrëfimi i fesë e zotimi shoqëror

178. Të rrëfesh një Atë që i do të gjithë njerëzit me një dashuri të pafund nënkuptosh se “me këtë veprim i jep atij një dinjitet të pafund”¹⁴¹. Të rrëfesh se Biri i Hyjit e mori trupin tonë njerëzor do të thotë që çdo qenie njerëzore është ngjitur te vetë zemra e Hyjit. Të rrëfesh se Jezusi ka derdhur gjakun e tij për ne, largon çdo dyshim mbi dashurinë e pakufishme që fisnikëron çdo qenie njerëzore. Shëlbimi i tij ka një përmasë shoqërore sepse “Hyji në Krishtin nuk shëlbbon vetëm individin por edhe marrëdhëniet shoqërore midis njerëzve”¹⁴². Të rrëfesh se Shpirti i Shenjtë është në veprim te çdo njeri nënkupton se ai përpiket të depërtojë në çdo situatë njerëzore dhe në çdo lidhje shoqërore: “Shpirti i Shenjtë mund të thuhet se zotëron një pafundësi gjetjeje, pikërisht sipas mendjes

¹⁴¹ Gjon Pali II, *Angelus me invalidët në Kishën Katolike* (16 nëntor 1980): *Insegnamenti*, 3/2 (1980), 1232.

¹⁴² Koncili Pontifikal për drejtësi dhe paqe, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 52.

hyjnore, që di sesi të zgjidhë nyjet e çështjeve njerëzore, madje edhe ato më të ndërlikuarat dhe të papërshkueshmet”¹⁴³. Ungjillëzimi përpiket të bashkëpunojë me këtë vepër çliruese të Shpirtit. Misteri i Trinisë na kujton se jemi krijuar në imazhin e kësaj bashkësie hyjnore dhe prandaj nuk mund të arrijmë përmbushje apo shpëtim me forcat tona. Nga zemra e Ungjillit ne shohim lidhjen e thellë midis ungjillëzimit dhe përparimit njerëzor, që duhet të gjejë shprehje dhe të zhvillohet patjetër në çdo vepër ungjillëzimi. Pranimi i Lajmit të parë, që na fton të marrim dashurinë e Zotit dhe ta duam me dashurinë që vetë Ai na e ka dhënë si dhuratë, sjell në jetën dhe në veprimet tona një përgjigje themelore: të dëshirojmë, të kërkojmë dhe të mbrojmë të mirën e tjetrit.

179. Kjo lidhje e pandashme midis pranimi tonë të mesazhit të shpëtimit dhe dashurisë së vërtetë vëllazërore shfaqet në disa tekste biblike të cilat duhet t’i marrim në konsideratë dhe të meditojmë me kujdes për të nxjerrë të gjitha përfitimet. Bëhet fjalë për një mesazh që ne e marrim si të garantuar

¹⁴³ Gjon Pali II, *Udiencë e Përgjithshme* (24 prill 1991): *Mësime katekizmi*, 14/1 (1991), 853.

dhe të cilin e përsërisim si pa u menduar fare, pa u siguruar që të ketë një efekt të vërtetë në jetët dhe në bashkësitë tona. Sa e rrezikshme dhe e dëmshme është kjo, sepse na bëjnë të humbim mrekullimin, entuziazmin dhe zellin për të jetuar Ungjillin e vëllazërisë dhe të drejtësisë! Fjala e Hyjit mëson se në vëllezërit e në motrat tona gjendet zgjatimi i mishërimit për secilin prej nesh: “çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezërit e mi më të vegjël, e bëtë për mua” (Mt 25,40). Mënyra sesi i trajtojmë të tjerët ka një përmasë transhendente: “me atë masë që matni, me atë edhe juve do t’ju matet” (Mt 7,2), që përputhet me mëshirën hyjnore ndaj nesh: “Bëhuni edhe ju të mëshirshëm sikurse (edhe) Ati juaj është i mëshirshëm.” “Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni! Mos dënoni e nuk do të dënoheni! Falni e do të gjeni falje!”³⁸ Jepni e do t’ju jepet... sepse me atë masë që të matni, do t’ju matet edhe juve në kthim.” (Lk 6:36-38). Çfarë këto pasazhe bëjnë të qartë është përparësia absolute e “të dalurit nga vetja drejt vëllezërve dhe motrave”, si një nga dy urdhërimet e mëdha që përbëjnë themelin e çdo norma morale dhe si shenja më e qartë për dallimin e rritjes shpirtërore në përgjigje të dhuratës së Zotit që është krejt

falas. Për këtë arsye, “edhe shërbesa e dashurisë është një element përbërës i misionit të Kishës dhe një shprehje e domosdoshme e qenies së saj”¹⁴⁴. Duke qenë se nga vetë natyra e saj Kisha është misionare, atëherë nga një natyrë e tillë do të rrjedhë medoemos një dashuri e madhe për të afërmin dhe një dhembshuri që kupton, ndihmon dhe inkurajon.

Mbretëria dhe sfidat e saj

180. Nga leximi i Shkrimeve del qartë se Ungjilli nuk ka të bëjë thjesht me marrëdhënien tonë personale me Hyjin. E as përgjigja nga ana jonë me dashuri nuk duhet të shihet si një mori gjestesh të vogla personale ndaj ndonjë individi në nevojë, një lloj “dashurie në letër”, një sërë veprimesh që synojnë vetëm qetësimin e ndërjegjes sonë. Propozimi është *Mbretëria e Hyjit* (krh. Lk 4:43); bëhet fjalë për të dashur Hyjin që mbretëron në botë. Në po atë masë që Ai do ia dalë të mbretërojë në ne, edhe jeta shoqërore do të jetë një vend ku

¹⁴⁴ Benediketi XVI, *Motu Proprio Intima Ecclesiae Natura* (11 nëntor 2012): AAS 104 (2012), 996.

do të lulëzojë vëllazëria, drejtësia, paqja e dinjiteti për të gjithë. Atëherë si predikimi ashtu edhe jeta apo përvoja e krishterë synojnë të kenë një ndikim mbi shoqërinë. Ne kërkojmë mbretërinë e Hyjit; “Kërkoni, pra, më së pari, Mbretërinë dhe drejtësinë e tij e të gjitha këto do t’ju jepen si shtesë!” (Mt 6,33). Misioni i Jezusit është të vendosë mbretërinë e Atit të tij; ai i kërkon dishepujt e tij që të shpallin lajmin e mirë se “mbretëria e qiellit është afër” (Mt 10,7).

181. Mbretëria, paradhënë dhe në rritje në mesin tonë na përfshin në çdo nivel të qenies sonë dhe na kujton për parimin e shoshitjes që Pali VI-të e referonte në lidhje me zhvillimin e vërtetë: “çdo njeri dhe i tërë njeriu”¹⁴⁵. Ne e dimë se “ungjillëzimi nuk do të ishte i plotë nëse nuk do të merrte në konsideratë apelin reciprok të bashkëveprimit pareshtur të Ungjillit me jetën konkrete, personale e shoqërore”¹⁴⁶. Ky është parimi i universalizmit, që i shkon për shtat dinamikës së Ungjillit, sepse Ati e dëshiron shpëtimin e çdo burri e gruaje dhe

¹⁴⁵ Letra enciklike *Populorum Progressio* (16 mars 1967), 14: AAS 59 (1967), 264.

¹⁴⁶ Pali VI, Porosia Apostolike *Evangelii Nuntiandi* (8 dhjetor 1975), 29: AAS 68 (1976), 25.

plani i tij i shpëtimit përfshin të përmbledhjes së çdo gjëje, të gjitha qeniet që janë në qiell e në tokë, nën një Zot të vetëm, që është Krishti (krh. Ef 1,10). Mandati ynë është: “Dilni në mbarë botën e predikojani Ungjillin të gjithë njerëzve” (Mk 16,15), sepse “vetë krijesa me afsh e pret zbulimin e bijve të Hyjit” (Rom 8,19). Këtu, krijimi ka të bëjë me çdo aspekt të jetës njerëzore; si pasojë “misioni i shpalljes së Lajmit të Mirë të Jezu Krishtit ka një destinacion universal. Mandati i tij i dashurisë i përfshin të gjitha përmasat e ekzistencës, të gjithë individët, të gjitha sferat e jetës komunitare e të gjithë popujt. Asnjë qenie njerëzore nuk mund të jetë e huaj për të”¹⁴⁷. Shpresa e vërtetë e krishterë që kërkon mbretërinë eskatologjike, lind gjithnjë histori.

Mësimi i Kishës mbi çështjet shoqërore

182. Mësimet e Kishës në lidhje me disa situata të mundshme po u nënshtrohen zhvillimeve të reja dhe të mëtejshme dhe mund të jenë të hapura për diskutim, e megjithatë nuk mund të mos jemi

¹⁴⁷ Konferenca e pestë e përgjithshme e ipeshkvijve latino-amerikanë dhe karibeane, *Dokumenti Aparecida*, 29 qershor 2007, 380.

konkretë, pa pretenduar që të hyjmë në detaje, në mënyrë që parimet e mëdha shoqërore të mos mbeten thjesht tregues të përgjithshëm që nuk pyesin akënd. Ekziston një nevojë për të nxjerrë përfundime praktike, në mënyrë që të kenë “një ndikim më të madh mbi situatat e përditshme të ndërlikuara”¹⁴⁸. Barinjte, duke marrë në konsideratë kontributet e shkencave të ndryshme, kanë të drejtë të japin mendime në lidhje me atë që ndikon në jetët e njerëzve, duke qenë se detyra e ungjillëzimit nënkupton dhe kërkon promovimin të gjithanshëm të çdo qenieje njerëzore. Nuk është më e mundur që të pohojmë se besimi duhet të kufizohet ndaj sferës private dhe se ekziston vetëm për të përgatitur shpirtrat për parajsën. Ne e dimë se Hyji do që bijtë e tij të jenë të lumtur edhe në këtë botë, megjithëse ata janë të thirrur ndaj plotësisë së përjetshme, sepse ai i ka krijuar të gjitha gjërat “për t’i gëzuar” (1 Tim 6,17), që të gjithë t’i gëzojnë. Si pasojë kthimi i krishterë kërkon rishikimin e sidomos atyre sferave dhe aspekteve të jetës “të lidhura me rendin shoqëror dhe kërkimin e së mirës së përbashkët”¹⁴⁹.

¹⁴⁸ Koncili Pontifikal për Drejtësi dhe Paqe, *Përmbledhje e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 9.

¹⁴⁹ Gjon Pali II, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Eccelesia in America* (22 janar 1999), 27: AAS 91 (1999), 762.

183. Si rrjedhim askush nuk mund të na kërkojë që ta mbajmë besimin të mbyllur brenda intimitetit të fshehtë të zemrës, pa asnjë ndikim në jetën shoqërore dhe atë të kombit, pa u shqetësuar për gjendjen e institucioneve të shoqërisë civile e pa u shprehur mbi ngjarjet që u interesojnë qytetarëve. Kush do të guxonte që të mbyllej në një tempull dhe të bënte të heshte mesazhi i Shën Françeskut të Asizit apo i së lumes Terezë të Kalkutës? Ata vetë s’do ta kishin pranuar këtë. Një besim i vërtetë, që nuk është kurrë i rehatshëm ose individualist, nënkupton gjithnjë një dëshirë të madhe për të ndryshuar botën, për të përcjellë vlerat, për ta lënë këtë botë më të mirë sesa e kemi gjetur. Ne e duam këtë planet të mrekullueshëm mbi të cilin Zoti na ka vënë dhe ne e duam familjen njerëzore që banon në të, me të gjitha tragjeditë dhe konfliktet, me shpresat e aspiratat, me vlerat e dobësitë e saj. Toka është shtëpia jonë e përbashkët dhe ne të gjithë jemi vëllezër dhe motra. Megjithëse “rendi i duhur i shoqërisë dhe i shtetit është përgjegjësia kryesore e politikës”, Kisha “nuk mundet dhe nuk duhet të qëndrojnë indiferentë në luftën për drejtësi”¹⁵⁰. Të gjithë të krishterët, duke përfshirë

¹⁵⁰ Benedikti XVI, Letra enciklike *Deus Caritas Est* (25 dhjetor 2005), 28: AAS 98 (2006), 239-240.

edhe barinjtë, janë të thirrur që të preokupohen për ndërtimin e një bote më të mirë. Kjo është thelbësore, sepse mendimi shoqëror i Kishës është në radhë të parë pozitiv dhe me vend, dhe që orienton për të sjellë një shndërrim transformues dhe në këtë kuptim nuk pushon së qeni shenjë shprese që lind nga zemra e dashur e Jezu Krishtit. Në të njëjtën kohë, e bashkon “përkushtimin e vet me atë të kishave dhe bashkësive të tjera kishtarë në fushën shoqërore, qoftë në nivelin e reflektimeve doktrino-re, qoftë në atë praktik”¹⁵¹.

184. Ky nuk është çasti apo vendi për të analizuar në detaje çështjet e shumta serioze shoqërore që prekin botën e sotme, disa prej të cilave i kam trajtuar në kapitullin e dytë. Kjo Porosi nuk është një dokument shoqëror dhe për të reflektuar mbi këto tema të ndryshme ne kemi një instrument mjaft të përshtatshme në *Përmbledhjen e Doktrinave Shoqërore të Kishës*, përdorimin dhe studimin e së cilës e këshilloj fuqimisht. Po ashtu, as Papa e as Kisha nuk e zotërojnë monopolin e interpretimit të realiteteve shoqërore ose propozimit për zgji-

¹⁵¹ Koncili Pontifikal për Drejtësi e Paqe, *Përmbledhje e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 12.

dhjen e problemeve bashkëkohore. Unë këtu mund të përsëris konstatimin e urtë të Palit VI-të: “Përpara situatave të tilla të ndryshme, është e vështirë për ne që të shpallim një mesazh unik dhe të propozojmë një zgjidhje që të ketë një vlerë universale, sepse kjo nuk është as qëllimi e as misioni ynë. Varet nga bashkësitë e krishtera për të shqyrtuar me objektivitet situatën përkatëse të vendit të tyre”¹⁵².

185. Në këtë që vjen më pas, synoj që të përqendrohem mbi dy çështje serioze që më duken mjaft të rëndësishme në këtë moment të historisë. Unë do t’i trajtoj më hollësisht sepse besoj se ato do të përcaktojnë të ardhmen e njerëzimit. Bëhet fjalë kryesisht për përfshirjen e të varfërve në shoqëri dhe gjithashtu edhe për paqe dhe dialog shoqëror.

II. PËRFSHIRJA E TË VARFËRVE NË SHOQËRI

186. Feja jonë në Krishti, që u bë i varfër dhe gjendej gjithnjë afër të varfërve dhe të dëbuarve

¹⁵² Letra Apostolike *Octogesima Adveniens* (14 maj 1971), 4: AAS 63 (1971), 403.

përbën bazën e preokupimit tonë për zhvillimin e gjithanshëm të pjesëtarëve më të shpërfillur të shoqërisë.

Në bashkim me Hyjin, ne dëgjojmë një thirrje

187. Çdo invidid dhe çdo bashkësi e krishterë janë të thirrura që të jetë një mjet në duart e Zotit për çlirimin dhe promovimin e të varfërve, me qëllim që të ata të integrohen plotësisht në shoqëri. Kjo kërkon që të jemi të butë e të vëmendshëm ndaj britmave të të varfërve dhe t'u vijmë në ndihmë. Një vështrim i thjeshtë në Shkrimet mjafton që të shohim se Ati ynë i mirë dëshiron të dëgjojë klithmën e të varfërve: "E pashë mjerimin e popullit tim në Egjipt dhe e dëgjova klithjen e tij për ndihmë për shkak të pashpirtësisë së mbikëqyrësve të tyre. Dhe, duke e ditur vuajtjen e tij, zbrita për ta çliruar... Pra, eja se dua të të çoj" (Dal 3,7-8,10) dhe shqetësohet për nevojat e tyre: "Atëherë izraelitët i lëshuan kushtrimin Zotit e Zoti u ngriti shpëtimtarin" (Gjq 3,15). Nëse ne jemi mjete të Zotit për të dëgjuar të varfrit, e bëjmë veshin të shurdhër ndaj kësaj klithme, ne e kundërshtojmë vullnetin e Atit dhe planin e tij,

sepse i varfri "do të këlthasë te Zoti kundër teje, e ky do të jetë mëkat për ty" (Lp 15,9). Mungesa e solidaritetit ndaj nevojave të tij do të ndikojë drejtpërdrejt në marrëdhënien tonë me Hyjin: "Nëse në hidhërimin e shpirtit ai do të të mallkojë, atëherë Krijuesi i tij do ta dëgjojë lutjen e tij" (Sir 4,6). Pyetja e vjetër rikthehet sërish: "Kush i ka të mirat e kësaj bote dhe e sheh vëllain e vet në ngushticë dhe e mbyll zemrën e vet para tij – në ç'mënyrë dashuria e Hyjit qëndron në të?" (1 Gjn 3,17). Le të kujtojmë sesi apostulli Jakob flet për britmën e të shtypurve: "Paga që u hëngrët punëtorëve që u korrenë arat, bërtet dhe – ofshama e korretarëve arriti në veshët e Zotërisë së Ushtrive!" (5,4).

188. Kisha e ka pranuar faktin se nevoja për të dëgjuar këtë britmë lind nga veprimi çlirues i hirit që ndodhet brenda secilit prej nesh, prandaj nuk bëhet fjalë për një mision që u rezervohet vetëm disa vetave: "Kisha, e udhëhequr nga Ungjilli i mëshirës dhe nga dashuria për qenien njerëzore, e dëgjon britmën për drejtësi dhe synon që t'u përgjigjet me gjithë forcën e vet"¹⁵³. Në këtë kontekst ne

¹⁵³ Kongregacioni për Doktrinën e Fesë, Mësimi *Libertatis Nuntius* (6 gusht 1984), XI, 1: AAS 76 (1984), 903.

mund të kuptojmë urdhërimin e Jezusit ndaj nxënësve të tij: “Jepuni ju të hanë”(Mk 6,37), që nënkupton si përpjekjet për të eliminuar shkaqet strukturore të varfërisë dhe për të promovuar zhvillimin e gjithashëm të të varfërve, ashtu edhe gjestet e thjeshta të përditshme të solidaritetit përpara nevojave reale me të cilat ndeshemi. Fjala “solidaritet” është paksa e konsumuar dhe disa herë nuk kuptohet mirë, por ajo ka të bëjë me diçka më shumë se disa akte sporadike bujarie. Ajo kërkon krijimin e një mendësie të re që mendon në raport me bashkësinë dhe me përparësinë e jetës për të gjithë, kundrejt përvetësimit të të mirave materiale vetëm prej disa personave.

189. Solidariteti është një reagim spontan i atyre që e pranojnë funksionin shoqëror të veçorisë dhe destinacionit universal të të mirave materiale si një realitet që u paraprin pronës private. Zotërimi privat i të mirave shfajësohet nga nevoja për t’i mbrojtur dhe shtuar ato, që t’u shërbejnë më mirë të mirës së përbashkët, e për këtë arsye solidariteti duhet të jetohet si vendimi për t’u kthyer të varfërve atë që u përket atyre. Këto bindje dhe zakone të solidaritetit, kur vihen në praktikë, u

hapin rrugën shndërrimeve të tjera strukturore duke i mundësuar ato. Ndryshimi i strukturave pa gjeneruar bindje dhe qëndrime të reja vetëm sa do të bënte të mundur që këto struktura të bëheshin shpejt a vonë të korruptuara, të rënda dhe jo efektive.

190. Disa herë bëhet fjalë për të dëgjuar britmat e popujve të tërë, popujve më të varfër të botës, meqenëse “paqja nuk vendoset mbi respektin e të drejtave të njeriut, por edhe mbi respektin e të drejtave të popujve”¹⁵⁴. Fatkeqësisht, edhe të drejtat e njeriut mund të përdoren si pretekst për një mbrojtje të çrregullt të të drejtave individuale apo të drejtave të popujve më të pasur. Me gjithë respektin e duhur ndaj autonomisë dhe kulturës së çdo kombi, ne nuk duhet të harrojmë kurrë se planeti i përket të gjithë njerëzimit dhe se fakti që vetëm disa njerëz kanë lindur në vende me burime më të pakta apo më pak të zhvilluara nuk e shfajëson faktin që ata të jetojnë me më pak dinjitet. Duhet ritheksuar se “më të privilegjuarit duhet të heqin dorë prej disa të drejtave, në

¹⁵⁴ Koncili Pontifikal për Drejtësi e Paqe, , *Përmbledhje e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 157.

mënyrë që t'i vënë më lirisht zotërimet e tyre në shërbimin e tjetrit"¹⁵⁵. Që të flasim si duhet për të drejtat tona, ne duhet ta zgjerojmë perspektivën tonë dhe të dëgjojmë edhe britmat e popujve ose rajoneve të tjera dhe jo vetëm atyre që vijnë nga vendi ynë. Ne duhet të rritemi në një solidaritet që "do t'i lejonte të gjithë popujt të bëhen me forcat e tyre endësit e fatit të tyre"¹⁵⁶, meqenëse "çdo qenie njerëzore ka të drejtë të zhvillohet apo të përmirësojë gjendjen e vet"¹⁵⁷.

191. Në çdo vend e rrethanë, të krishterët të inkurajuar nga pastorët e tyre, janë të thirrur që të dëgjojnë klithmën e të varfërve, siç e kanë deklaruar më së miri ipeshkvijtë brazilianë: "Ne duam të marrim për çdo ditë gëzimet e shpresat, vështirësitë dhe pikëllimet e popullit brazilian, sidomos të atyre që jetojnë në periferitë urbane dhe zonat rurale, si ata që janë pa tokë, të pastrehët, ata që nuk kanë për të ngrënë dhe asnjë kujdes shëndetësor, të drejtat e të cilëve janë të cënuara.

¹⁵⁵ Pali VI, Letra Apostolike *Octogesima Adveniens* (14 maj 1971), 23: AAS 63 (1971), 418.

¹⁵⁶ Pali 6, Letër enciklike *Populorum Progressio* (26 mars 1967), 65: AAS 59 (1967), 2889.

¹⁵⁷ *Ibid.*, 15: AAS 59 (1967), 265.

Kur shohim varfërinë e tyre, kur dëgjojmë klithjet e tyre dhe kur njohim nga afër vuajtjet që kalojnë, ne skandalizohemi sepse e dimë se ka ushqim të mjaftueshëm për të gjithë dhe se uria është pasojë e një shpërndarjeje të keqe të të mirave materiale dhe e të ardhurave. Problemi rëndohet nga praktika e përgjithësuar e shkapërderdhjes"¹⁵⁸.

192. Por ne dëshirojmë edhe më shumë se kaq, ëndrra jonë fluturon edhe më lart. Ne nuk e kemi fjalën për të siguruar ushqim "apo mjetet dinjitoze të jetesës" për të gjithë njerëzit, por edhe "mirëqenien dhe begatinë e tyre të përkohshme"¹⁵⁹. Kjo nënkupton edukim, mundësi përkujdesi shëndetësor dhe sidomos punë, sepse në punën e lirë, krijuese, pjesëmarrëse dhe mbështetëse, qeniet njerëzore mund të shprehin dhe të pasurojnë dinjitetin e jetëve të tyre. Paga e duhur i aftëson që të kenë mundësi të mirë ndaj të gjitha të mirave të tjera materiale që janë caktuar për përdorimin e përbashkët.

¹⁵⁸ Conferência Nacional Dos Bispos Do Brasil, *Exigências evangélicas e éticas de superação da miséria e da fome* (Prill 2002), Hyrja 2.

¹⁵⁹ Gjoni XIII, Letra enciklike *Mater et Magistra* (15 maj 1961), 3: AAS 53 (1961), 402.

193. Ne e mishërojmë detyrën e të dëgjuarit të britmës së të varfrit kur prekemi thellësisht nga vuajtjet e tjetrit. Le të dëgjojmë atë që na mëson fjala e Zotit për mëshirën dhe ta lëmë këtë fjalë që të jehojë në jetën e Kishës. Ungjilli na thotë: “Lum të mëshirshmit sepse do të gjejnë mëshirë!” (Mt 5,7). Apostulli Jakob mëson që mëshira jonë ndaj të tjerëve do të na bëjë të dalim ngjadhnyjes ditën e gjykimit hyjnor: “Flitni ashtu dhe ashtu veproni, si ata që do të gjykohen me ligjin e lirisë!”¹³ Sepse, gjyqi nuk ka mëshirë për atë që nuk është i mëshirshëm; mëshira ngadhënjën mbi gjyqin” (Jak 2,12-13). Këtu Jakobi i qëndron besnik traditës së pasur post-ekzilike hebraike, që i atribuonin një vlerë të veçantë mëshirës: “shpërbleji mëkatet e tua me lëmoshë e paudhësitë e tua me mëshirë ndaj skamnorëve: kështu do të gëzosh mirëqenie të gjatë.” (Dan 4,27). Në të njëjtën perspektivë, literatura e diturisë e sheh lëmoshën si një ushtrim konkret mëshire ndaj atyre që janë në nevojë: “Lëmosha të shpëton nga vdekja dhe të pastron nga çdo mëkat” (Tob 12,9). Ideja shprehet edhe më qartë te libri i Siracidit: “Ashtu si uji shuan zjarrin,

ashtu edhe lëmosha shlyen mëkatin” (Sir 3,30). E njëjta sintezë shihet edhe në Besëlidhjen e Re: “Para së gjithash kini dashuri të vazhdueshme për njëri-tjetrin, sepse: “Dashuria mbulon një shumicë mëkatesh” (1 Pt 4,8). Kjo e vërtetë ka ndikuar në të menduarit e Etërve të Kishës dhe ka ndihmuar në krijimin e një rezistence profetike dhe kundër-kulturore ndaj hedonizmit individualist të paganizmit. Le të kujtojmë vetëm një shembull: “Ashtu si në rastin e rrezikut nga zjarri, vrapojmë te uji për të shuar zjarrin... në të njëjtën mënyrë, nëse një shkëndijë mëkati ndizet nga kashta jonë dhe ne shqetësohemi për këtë, sa herë që na del një mundësi për të kryer ndonjë vepër mëshire, ne duhet të gëzohemi sikur të na jetë hapur një burim, që të mund të shuajmë zjarrin”¹⁶⁰.

194. Ky mesazh është aq i qartë, i drejtpërdrejtë, i thjeshtë dhe elokuent, që asnjë interpretim kishtar nuk ka të drejtë ta relativizojë atë. Reflektimi i Kishës mbi këto tekste nuk duhet të errësojë apo dobësojë forcën e tyre, por na nxit që t'i pranojmë këto tekste nxitëse me kurajë e zell.

¹⁶⁰ Shën Agustini, *De Catechizandis Rudibus*, I, XIX, 22: PL 40, 327.

Pse ta ndërlikojmë diçka kaq të thjeshtë? Mjetet konceptuale ekzistojnë për favorizimin e kontaktit me realitetin që kërkojnë të shpjegojnë dhe jo për të na larguar prej tyre. Kjo ndodh sidomos me ato nxitje biblike që na thërrasin me forcë ndaj dashurisë vëllazërore, shërbimit të përlulur dhe bujar, ndaj drejtësisë dhe dhembshurisë për të varfrit. Jezusi na e ka mësuar sesi duhet ta shikojmë apo pranojmë të afërmin me anë të fjalëve dhe veprimeve të tij. Pse të errësohet diçka kaq e qartë? Ne nuk duhet të shqetësohemi thjesht për të mos rënë në gabime doktrino-re, por që të mbetemi besnikë ndaj këtij shtegu të ndriçuar jete dhe urtësie. Sepse “mbrojtësit e ortodoksisë disa herë paditen për pasivitet, favorizim apo bashkëpunim të fajshëm në lidhje me situatat e patolerueshme të padrejtësisë dhe regjimeve politike që i zgjasin ato”¹⁶¹.

195. Kur Shën Pali iu drejtua apostujve në Jeruzalem për të dalluar nëse “po ecte më kot” (Gal 2,2), kriteri kryesor i autencitetit që paraqitën ishte që të mos harronte të varfrit (krh. Gal 2,10).

¹⁶¹ Kongregacioni për Doktrinën e Fesë, Mësimi *Libertatis Nuntius* (6 gusht 1984), XI, 18: AAS 76 (1984), 907-908.

Ky parim i rëndësishëm, pra që bashkësitë e themeluara nga Pali të mos binin pre e mënyrës egoiste e të jetuarit të paganëve, qëndron aktuale edhe sot, kur një paganizëm i ri individualist po rritet gjithnjë e më shumë. Ne mund të mos jemi gjithnjë në gjendje që të reflektojmë si duhet ndaj bukurisë së Ungjillit, por ka një shenjë që nuk duhet të na mungojë kurrë: zgjedhja opsioni për ata persona që janë të fundit e që shoqëria i përbuz.

196. Disa herë rezultojmë shumë të fortë në zemër e mendje, harrojmë, hutohemi dhe e humbasim mendjen pas mundësive të panumërta të konsumit dhe gjërave me të cilat shoqëria e sotme na tërheqin vëmendjen. Kjo të shpie në një lloj izolimi të çdo niveli, sepse një shoqëri izolohet kur format e saj të organizimit shoqëror, prodhimit dhe konsumimit e bëjnë të vështirë për ta ofruar dhuratën e vetes dhe për të vendosur solidaritetin midis njerëzve”¹⁶².

¹⁶² Gjon Pali II, Letra Enciklike *Centesimus Annus* (1 maj 1991), 41: AAS 83 (1991), 844-845.

*Vendi i veçantë i të varfërve
në mes të popullit të Zotit*

197. Zemra e Zotit ka një vend aq të veçantë për të varfrit, sa që ai vetë u “bë i varfër” (2 Kor 8,9). E tërë historia e shpengimit tonë karakterizohet nga prania e të varfërve. Shpëtimi na erdhi nga “po-ja” e thënë nga një vajzë e përulur nga një qytet i vogël periferie në perandorinë e madhe. Shpëtimtari lindi në një grazhd, në mes të kafshëve, si një fëmijë që vinte nga familje të varfra, ai u ofrua në Tempull me dy turtuj, që ishte ofrimi që e bënë ata të cilët nuk mund të blinin një qengj (krh. Lk 2,24; Lev 5,7). Ai u rrit në një shtëpi punëtorësh të thjeshtë dhe punoi me duart e veta për të fituar bukën e gojës. Kur nisi të predikojë Mbretërinë, turma të shpronësuarish filluan ta ndiqnin, duke ilustruar fjalët e tij: “*Shpirti i Zotit është mbi mua sepse Ai më shuguroi! Ai më dërgoi t’u kumtoj të vobektëve Ungjillin, t’u shpall robërve çlirimin*” (Lk 4,18). Ai i siguroi të rënduarit me barrën e pikëllimit dhe kërrusur nën peshën e varfërisë se Zoti kishte një vend të veçantë për ta në zemrën e tij: “Të lumët ju, o skamnorë, sepse juve ju përket Mbretëria e Hyjit!” (Lk 6,20); e bëri veten njëri prej

tyre: “kur pata uri ju më dhatë për të ngrënë” dhe u mësoi se dhembshuria ndaj këtyre është çelësi i parajsës (krh. Mt 25,5 e në vijim).

198. Për Kishën, zgjedhja ndaj të varfërve është kryesisht një kategori teologjike sesa kulturore, sociologjike, politike apo filozofike. Hyji u tregon “fillimisht të varfërve dhembshuri”¹⁶³. Kjo preferencë hyjnore ka pasoja për jetën e fesë së të gjithë të krishterëve, meqenëse ne të gjithë jemi thirrur që të kemi “po ato ndjenja që ishin në Krishtin Jezus” (Fil 2,5). E frymëzuar nga kjo, Kisha ka bërë një zgjedhje për të varfrit që është kuptuar si një “formë e veçantë përparësie në ushtrimin e dashurisë së krishterë, të cilën e tërë tradita e Kishës e dëshmon”¹⁶⁴. Kjo zgjedhje, siç na ka mësuar Benedikti XVI-të: “aludohet në fenë tonë të krishterë në një Hyj që u bë i varfër për ne, që të na pasurojë me varfërinë e tij”¹⁶⁵ Prandaj unë dua një Kishë të varfër dhe për të varfrit. Ata kanë shumë

¹⁶³ Gjon Pali II, *Homeli gjatë Meshës me rastin e ungjillëzimit të popujve në Santo Domingo* (11 tetor 1984), 5: AAS 77 (1985), 358.

¹⁶⁴ Gjon Pali II, *Letër enciklike Sollicitudo Rei Socialis* (30 dhjetor 1987), 42: AAS 80 (1988), 572.

¹⁶⁵ Fjalim i mbajtur me rastin e sesionit përurues të konferencës së pesë të përgjithshme të ipeshkvijve nga Amerika Latine dhe Karaibet (13 maj 2007), 3: AAS 99 (2007), 450.

për të na mësuar. Jo vetëm që ata marrin pjesë në *sensus fidei*, por në vështirësitë e tyre ata e njohin Krishtin e përvuajtur. Ne duhet ta lëmë veten të ungjillëzuar prej tyre. Ungjillëzimi i ri është një ftesë për të pranuar fuqinë shpëtuese që vepron në jetët e tyre dhe t'i vërë në qendër të shtegtimit të Kishës. Ne jemi të thirrur që ta gjejmë Krishtin në ta, të jemi zëdhënës të kauzave të tyre, por edhe të jemi miq të tyre, t'i dëgjojmë ata, të flasim për ta dhe të përqafojmë diturinë misterioze që Zoti dëshiron të ndajë me ne përmes tyre.

199. Përkushtimi ynë nuk konsiston ekskluzivisht në veprimtari apo programe promovimi dhe ndihmese. Ajo që Shpirti i Shenjtë vë në veprim nuk është një aktivizëm i tepërt, por mbi të gjitha një vëmendje që e konsideron tjetrin "si i ngjashëm me veten"¹⁶⁶. Kjo vëmendje dashurie është fillimi i një preokupimi të vërtetë për personin e tyre që më frymëzon të kërkoj të mirën e tyre. Kjo përfshin vlerësimin e të varfërve në mirësinë e tyre, në përvojën e jetës, në kulturën dhe në mënyrat e tyre të të jetuarit të fesë. Dashuria e vërtetë është gjithnjë soditëse apo medituese dhe na lejon që

¹⁶⁶ Shën Tomë Akuini, S. Th., II-II, q. 27, a. 2.

t'i shërbejmë të afërmit jo thjesht nga nevoja apo kotësia, por sepse është ai është i bukur përtej çdo pamje të jashtme: "Dashuria me anë të së cilës ne e shohim të afërmin si të kënaqshëm na bën që t'i ofrojmë diçka falas"¹⁶⁷. Kur e duam të varfrin "ai çmohet me një vlerë të madhe"¹⁶⁸ dhe kjo e bën zgjedhjen autentike për të varfrit të ndryshojë nga çdo ideologji tjetër, nga çdo përpjekje për të shfrytëzuar të varfrin për hir të përfitimit personal apo politik. Vetëm në bazë të kësaj afërsie reale dhe të singertë mund t'i shoqërojmë të varfrit në rrugën e tyre të çlirimit. Vetëm kjo do të sigurojë që "në çdo bashkësi të krishterë të varfrit të ndjehen si në shtëpinë e tyre. A nuk është kjo metodë paraqitja më e mirë dhe e suksesshme e lajmit të mirë të mbretërisë?"¹⁶⁹. Pa zgjedhjen preferenciale për më të varfrit, "shpallja e Ungjillit, që është vetë forma kryesore e dashurisë, rrezikon të keqkuptohet ose të fundoset nën një det fjalësh që çdo ditë na gllabëron në shoqërinë e sotme të mjeteve masive të komunikimit"¹⁷⁰.

¹⁶⁷ *Ibid.*, I-II, q. 110, a. 1.

¹⁶⁸ *Ibid.*, I-II, q. 26, a. 3.

¹⁶⁹ John Paul II, Apostolic Letter *Novo Millennio Ineunte* (6 January 2001), 50: AAS 93 (2001), 303.

¹⁷⁰ *Ibid.*

200. Meqenëse kjo Porosi u drejtohet pjesëtarëve të Kishës Katolike, më duhet të them jo pa keqardhje se diskriminimi më i keq që vuajnë të varfrit është mungesa e përkujdesit shpirtëror. Shumica e të varfërve kanë një çiltërsi të madhe ndaj fesë; ata kanë nevojë për Hyjin dhe ne duhet të bëjmë çmos që t'u ofrojmë miqësinë, bekimet, fjalën, kremtimin e sakramenteve dhe një rrugëtim rritjeje e pjekurie në besim. Zgjedhja jonë preferenciale ndaj të varfërve duhet të shndërrohet në një përkujdes të privilegjuar dhe parësor fetar.

201. Askush nuk duhet të thotë se nuk mund të jenë dot afër të varfërve pasi mënyra e të jetuarit i kërkon më shumë vemendje në drejtime të tjera. Ky është një pretekst që dëgjohet zakonisht në qarqet akademike, komerciale, profesionale e madje edhe kishtarë. Megjithëse është e vërtetë që thirrja dhe misioni thelbësor i besimtarëve të thjeshtë është të përpjekurit që realitetet tokësore dhe të gjitha veprimtaritë njerëzore të mund të shndërrohen nga Ungjilli¹⁷¹, askush prej nesh nuk duhet të mendojë se është i përjashtuar nga preokupimi për të varfrit dhe drejtësia shoqërore:

¹⁷¹ Shih *Propositio* 45.

“Kthimi shpirtëror, intensiteti i dashurisë së Zotit i kërkohet kujtdo”¹⁷². Unë kam frikë se këto fjalë mund të nxisin komente apo diskutime që nuk kanë asnjë efekt të vërtetë praktik. Megjithatë, unë besoj në çiltërsinë dhe gatishmërinë e çdo të krishteri dhe ju kërkoj si bashkësi, që të gjeni mënyra sa më të larmishme për ta pranuar këtë thirrje të re.

Ekonomia dhe shpërndarja e të ardhurave

202. Nevoja për të zgjidhur shkaqet strukturore të varfërisë nuk mund të shtyhet, jo vetëm për shkak të arsyes pragmatike të domosdoshmërisë për ruajtjen e rendit të shoqërisë, por edhe për ta shëruar nga një sëmundje që e bën të brishtë dhe të pafuqishme, që vetëm sa do të shkaktojë një krizë të re. Projektet e asistencës shoqërore të cilat plotësojnë disa nga nevojat më të ngutshme duhet të shihen thjesht si reagime të përkohshme. Për aq sa problemet e të varfërve nuk zgjidhen rrënjësisht duke mohuar autonominë absolute

¹⁷² Kongregacioni për Doktrinën e Fesë, Udhëzimi *Libertatis Nuntius* (6 gusht 1984), XI, 18: AAS 76 (1984), 908.

të tregjeve dhe spekulimit financiar dhe duke prekur shkaqet strukturore të pabarazisë¹⁷³, nuk do të gjendet asnjë zgjidhje ndaj problemeve të botës, madje ndaj asnjë problemi në përgjithësi. Pabarazia është rrënja e të këqijave shoqërore.

203. Dinjiteti i çdo personi dhe e mira e përbashkët janë çështje që duhet të modelojnë politikën ekonomike. Por ka raste kur ato duken si një shtojcë e jashtme që shërben për të plotësuar një fjalim politik të cilit i mungon perspektiva apo programi i një zhvillimi të vërtetë integral. Sa fjalë rezultojnë të bezdisshme për këtë sistem! Është e bezdisshme kur shtrohet çështja e etikës, kur flitet për solidaritetin global, kur përmendet shpërndarja e të mirave materiale, kur flitet për mbrojtjen e vendeve të punës dhe dinjitetit të të dobëtëve e kur aludohet për një Zot që kërkon një përkushtim ndaj drejtësisë. Në raste të tjera këto çështje bien pre e manipulimeve që i çnderojnë ato. Indiferenca e shkujdesur përballë çështjeve të tilla e zbraz jetën tonë dhe fjalët tona nga çdo domethënie. Thirrja e një biznesmeni apo

¹⁷³ Questo implica « eliminare le cause strutturali delle disfunzioni della economia mondiale »: Benedetto XVI, Discorso al Corpo Diplomatico (8 gennaio 2007): AAS 99 (2007), 73.

sipërmarrësi është fisnike, mjafton që ata të cilët janë të përfshirë në të ta shohin veten të sfiduar nga një qëllim më i lartë në jetë. Kjo do t'i aftësojë ata që t'u shërbejnë më mirë të mirës së përbashkët, duke u përpjekur që të shtojnë të mirat materiale dhe t'i bëjnë më të arritshme.

204. Ne nuk mund t'u besojmë më forcave të verbra dhe dorës së padukshme të tregut. Rritja në barazi kërkon më shumë se rritja ekonomike, ndërsa e presupozon atë: ajo kërkon vendime, programe, mekanizma dhe procese që janë veçanërisht të orientuara për një shpërndarje më të mirë të të ardhurave, krijimin e burimeve të punësimit dhe një promovim integral të të varfërve që e tejkalon mendësinë e asistencës shoqërore. Unë nuk jam duke sugjeruar një populizëm të papërgjegjshëm, por ekonomia nuk mund t'u kthehet më zgjidhjeve që janë një helm i ri, si përpjekjet për të shtuar fitimet duke reduktuar fuqinë punëtore, duke shtuar kështu numrin e të përgjashtuarve.

205. I kërkoj Zotit që të na japë më shumë politikanë të aftë për një dialog të sinqertë dhe efektiv me synimin për të shëruar rrënjët e thella dhe jo thjesht

dukjen e të këqijave të botës së sotme! Politika, sado që e shohim të denigruar, mbetet një thirrje e lartë dhe një format më i çmuar i dashurisë, sepse kërkon të mirën e përbashkët¹⁷⁴. Ne duhet të jemi të bindur se dashuria “është parim jo vetëm i mikromarrëdhënieve (raportet miqësore, pjesëtarë të familjes ose me persona brenda një grupi të vogël), por edhe i makromarrëdhënieve (raportet shoqërore, ekonomike dhe politike)”¹⁷⁵. I lutem Zotit që të na japë më shumë politikanë që të jenë realisht të preokupuar ndaj gjendjes së shoqërisë, popullit e jetëve të të varfërve! Është jetike që udhëheqësit qeveritarë dhe të botës së financës të hapin sytë e të zgjerojnë horizontin e tyre, duke bërë çmos që të gjithë qytetarët të kenë punë dinjitoze, arsim dhe përkujdes shëndetësor. Pse të mos kthehemi te Zoti dhe t’i kërkojmë që të frymëzojë planet e tyre? Unë jam mjaft i bindur se të qenit të hapur ndaj të përsosurës mund të sjellë një mendësi të re politike dhe ekonomike që do të ndihmojë në shembjen e murit midis ekonomisë dhe së mirës së përgjithshme të shoqërisë.

¹⁷⁴ Shih Commission Sociale de L’épiscopat Français, *Réhabilitier la politique* (17 shkurt 1999); cf. PIUS XI, mesazhi i 18 dhjetorit 1927.

¹⁷⁵ Benedikti XVI, Letër enciklike *Caritas in Veritate* (29 qershor 2009), 2: AAS 101 (2009), 642.

206. Ekonomia, siç na e tregon vetë fjala, duhet të jetë arti i të arriturit të një administrimi të përshtatshëm të shtëpisë sonë të përbashkët, që është e tërë bota. Çdo veprim ekonomik që kryhet në një pjesë të botës ka ndikim në çdo vend tjetër e si pasojë, asnjë qeveri nuk mund të veprojë pa përfillur përgjegjësinë kolektive. Në fakt po bëhet gjithnjë e më e vështirë për të gjetur zgjidhje lokale për probleme shumë të mëdha globale që e mbushin politikën lokale me probleme të vështira të cilat presin zgjidhjen. Nëse duam me të vërtetë që të arrijmë një ekonomi të shëndetshme botërore, në këtë fazë historike nevojitet një mënyrë më efektive ndërveprimi, që duke ruajtur sovranitetin e kombeve të sigurojë mirëqenien ekonomike të të gjitha vendeve.

207. Çdo bashkësi e Kishës, në atë masë që synon të rrijë e qetë, pa u përfshirë në mënyrë krijuese dhe të bashkëpunojë efektivisht për të ndihmuar të varfrit që të jetojnë me dinjitet dhe për përfshirjen e të gjithëve, do të rrezikojë shpërbërjen, sado që të flasë për çështjet shoqërore apo të kritikojë qeveritë. Ajo do të bjerë lehtë pre e mondanitetit shpirtëror, nën maskën e praktikave fetare, me takime shërbërëse ose me fjalime të zbrazëta.

208. Atij që ndjehet i fyer nga fjalët e mia, unë i them se po i shprehem me dashuri dhe me qëllimin më të mirë, larg çdo interesi personal apo ideologjie politike. Fjalët e mia nuk janë ato të një armiku apo një kundërshtari. Unë jam i interesuar vetëm që të ndihmoj ata që janë skllevër të një mendësie individualiste, indiferente dhe egoiste për t'u çliruar nga këto pranga të kota dhe të arrijnë një mënyrë të jetuari dhe të menduari më njerëzore, fisnike dhe të frytshme, që do ta bëjë më dinjitoze shtegtimin e tij në këtë tokë.

Shqetësimi për të dobtët

209. Jezusi, ungjilltari i përkryer dhe Ungjilli i mishëruar në person identifikohet sidomos me të vegjlit (krh. Mt 25,40). Kjo na kujton se të gjithë ne si të krishterë jemi thirrur për t'u kujdesur për më të dobtët e botës. Por modeli ekzistues me theksin ndaj suksesit dhe vetes nuk duket se favorizon një investimet në përpjekjet për të ndihmuar të ngadaltët, të dobtit apo më pak të talentuarit që të gjejnë mundësi në jetë.

210. Është thelbësore t'u kushtosh vëmendje formave të reja të varfërisë dhe dobësisë, në të cilat jemi të thirrur për të dalluar Krishtin e përvuajtur, edhe nëse duket se nuk na sjell asnjë përfitim të dukshëm e të menjëhershëm. Mendoj për të pastrehët, të droguarit, refugjatët, popujt indigjenë, të moshuarit që janë gjithnjë e më të vetmuar e të braktisur dhe shumë të tjerë. Migrantët apo të shpërngulurit paraqesin një sfidë të veçantë për mua, meqenëse jam pastori i një Kishë pa kufi, një Kishë që e konsideron veten si nëna e të gjithëve. Për këtë arsye, i nxis të gjitha vendet që të tregohen bujarë, sepse në vend që të druajnë se do të humbasin identitetin lokal, do të jenë në gjendje që të krijojnë forma të reja sintezash kulturore. Sa të mrekullueshme janë ato qytete që e mposhtin mosbesimin paralizues, i integrojnë ata që janë të ndryshëm dhe e bëjnë këtë integrim një faktor të ri zhvillimi! Sa tërheqëse janë këto qytete të cilat edhe në skemën e tyre arkitekturale janë plot me hapësira që lidhin dhe favorizojnë pranimin e të tjerëve!

211. Gjithnjë më ka shqetësuar fati i atyre që janë viktimat e formave të ndryshme të trafikimit

njerëzor. Sa dëshiroj që të gjithë ne ta dëgjojmë thirrjen e Zotit: “Ku është vëllai yt?” (Zan 4,9). Ku është vëllai yt skllav? Ku është ai që po e vret çdo ditë në atë fabrikën klandestine, në rrjetin e prostitucionit, në fëmijë që përdoren për të lypur e në shfrytëzimin e atyre që duhet të punojnë në punë të zezë? Të mos bëjmë sikur nuk ka ndodhur asgjë. Ka shumë gjëra që na bëjnë bashkëfajtorë. Dhe pyetja është për të gjithë! Ky rrjet i turpshëm krimesh mafioze është rrënjësuar mirë në qytetet tona dhe shumë njerëz kanë gjak në duart e tyre si rezultat i bashkëfajësisë së tyre të heshtur.

212. Dyfish më të varfra janë gratë që duhet të durojnë situata përjashtimi, keqtrajtimi dhe dhune, meqë shpesh nuk janë në gjendje të mbrojnë të drejtat e tyre. Megjithatë, ne shohim në mesin e tyre shembuj të admirueshëm heroizmi të përditshëm në mbrojtjen e kujdesit të familjeve të tyre të brishta.

213. Në mesin e këtyre të dobhtëve për të cilët Kisha dëshiron të përkujdeset me dashuri të veçantë janë fëmijët e palindur, më të pambrojturit dhe të pafajshmit ndër ne. Sot po bëhen përpjekje për t’u mohuar atyre dinjitetin njerëzor e për

të bërë me ta çfarë të duan, duke iu marrë jetën dhe duke miratuar ligje që ia hapin rrugën një abuzimi të tillë. Gjithnjë e më shumë, për t’u tallur me përpjekjet e Kishës për të mbrojtur jetën e tyre, po bëhen përpjekje për ta paraqitur pikëpamjen e saj si ideologjike, obskurantiste dhe konservatore. Megjithatë kjo mbrojtje e jetës së palindur është e lidhur ngushtë me mbrojtjen e jetës së çdo qenieje njerëzore. Ajo përfshin bindjen se një qenie njerëzore është gjithnjë e shenjtë dhe e pacenueshme, në çdo situatë dhe në çdo fazë të zhvillimit. Qeniet njerëzore janë qëllim në vetvete dhe nuk janë kurrë një mjet për zgjidhjen e problemeve të tjera. Sapo kjo bindje të zhduket, po ashtu bien edhe themelet solide për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që janë gjithnjë subjekt i tekave të pushtetarëve të radhës. Vetëm arsyeja është e mjaftueshme për të pranuar vlerën e pacenueshme të çdo qenieje njerëzore, por nëse e shohim çështjen nga këndvështrimi i besimit, “çdo shkelje e dinjitetit të qenies njerëzore i thërret Zotit për hakmarrje dhe është një fyerje kundër Krijuesit të njeriut”¹⁷⁶.

¹⁷⁶ Gjon Pali II, Porosia Apostolike Post-Sinodale *Christifideles Laici* (30 dhjetor 1988), 37; AAS 81 (1989), 461.

214. Pikërisht sepse kjo përfshin konsekuencën e brendshme të mesazhit tonë mbi vlerën e personit njerëzor nuk mund të pritët që Kisha të ndryshojë pikëpamjen e saj mbi këtë çështje. Unë dua që të jem krejtësisht i sinqertë në këtë drejtim. Kjo nuk është diçka që nuk u nënshtrohet reformave të supozuara ose “modernizimeve”. Nuk është “progresive” që të përpiqesh të zgjidhësh problemet duke eliminuar një jetë njerëzore. Nga ana tjetër, është e vërtetë gjithashtu që ne kemi bërë pak që t’i shoqërojmë si duhet gratë që ndodhen në situata mjaft të vështira, ku aborti duket si një zgjidhje e shpejtë ndaj vuajtjeve të tyre të mëdha, sidomos kur jeta që po rritet e zhvillohet brenda tyre është rezultat i një përdhunimi apo i një varfërie të skajshme. Kush mund të qëndrojë i paprekur nga situata të tilla të dhimbshme?

215. Ka dhe qenie të tjera të dobëta dhe të pambrojtura që ndodhen shpesh në mëshirën e interesave ekonomike apo të shfrytëzimit pa kriter. E kam fjalën për krijimin në tërësi. Ne qeniet njerëzore nuk jemi vetëm mirëbërësit por edhe administratorët e krijesave të tjera. Përmes realitetit të trupave tanë, Hyji na ka lidhur aq ngushtë me botën që na rrethon, sa që shkretimi

i tokës është si një sëmundje e zakonshme dhe e vajtojmë zhdukjen e specieve sikur të ishte një shfrytëzim i dhimbshëm. Të mos lëmë në shtegun tonë asnjë gjurmë rrënimi dhe vdekjeje që do të prekin jetët tona dhe ato të brezave të ardhshëm¹⁷⁷. Tani dua të kujtoj vajtimin prekës dhe profetik që e kanë shprehur para disa vitesh ipeshkvijtë e Filipineve: “Në një pyll jetonin një mori e madhe insektesh që merreshin me gjithfarë detyrash... Zogjtë fluturonin në ajër, puplat e tyre të shndritshme dhe cicërimat e llojllojshme e bënë edhe më të larmishëm gjelbërimin e pyllit. Hyji e ka krijuar këtë tokë për ne që jemi krijesat e tij të veçanta, por jo që ta shkatërrojmë e ta kthejmë në një djerrinë... Qoftë dhe vetëm me një natë shi, shikojini lumenjtë në ngjyrë çokollate pranë vendbanimit tuaj dhe kujtohuni se ato po e shpien gjakun e gjallë të tokës në det... Si mund të notojnë peshqit në kanale të tilla si ai i Pasigut e në shumë lumenj të tjerë që ne i kemi ndotur? Kush e shndërroi këtë botë të mrekullueshme të detit në një varrezë nënujore pa jetë dhe ngjyrë?”¹⁷⁸.

¹⁷⁷ Shih *Propositio* 56.

¹⁷⁸ Konferenca e ipeshkvijve katolikë Filipinas, Letër pastorale Çfarë po ndodh me tokën tonë të mrekullueshme? (29 janar 1988).

216. Të vegjël por të fortë në dashurinë e Hyjit, si Shën Francesku i Asizit, ne të gjithë si të krishterë jemi të thirrur për të ruajtur botën e brishtë në të cilën jetojmë.

III. E MIRA E PËRBASHKËT DHE PAQJA NË SHOQËRI

217. Ne kemi folur hollësisht mbi gëzimin e dashurinë, por fjala e Zotit flet edhe për frytin e paqes (krh. Gal 5,22).

218. Paqja në shoqëri nuk mund të kuptohet si pacifizëm apo thjesht mungesë dhune që rezulton nga sundimi i një pjese të shoqërisë mbi pjesën tjetër. Do të ishte po ashtu një paqe e rreme ajo që shërben si pretekst për të shfajësuar një strukturë shoqërore që u mbyll gojën ose i qetëson të varfrit, në një mënyrë të tillë që ata të cilët gëzojnë më shumë përfitime mund ta ruajnë mënyrën e tyre të të jetuarit ndërsa të tjerët të përpiqen të mbijetojnë. Kërkesat shoqërore që kanë të bëjnë me shpërndarjen e të ardhurave, me përfshirjen e të varfërve dhe të drejtat njerëzore nuk mund të shtypen me pretekstin e të ngriturit

të një konsensusi në letër apo arritjes së një paqe kalimtare për një pakicë të kënaqur. Dinjiteti i njeriut dhe e mira e përbashkët qëndrojnë mbi qetësinë apo rehatin e disa njerëzve që nuk duan të heqin dorë nga privilegjet e tyre. Kur këto vlera merren nëpër këmbë, atëherë një zë profetik duhet të ngrihet.

219. Paqja “nuk duhet të reduktohet në mungesën e një lufte, si fryt i një ekuilibri të dyshimtë pushteti. Ajo ndërtohet çdo ditë me përpjekje që synojnë vendosjen e një rendi sipas vullnetit të Zotit, çfarë ka të bëjë me arritjen e një drejtësie më të përkryer në mes njerëzve”¹⁷⁹. Në fund, një paqe që nuk është rezultat i zhvillimit integral do të dështojë e do të jetë gjithnjë burim konfliktesh dhe formash të reja dhune.

220. Popujt e çdo kombi e zgjerojnë dimensionin e jetëve të tyre duke vepruar si qytetarë të përkushtuar dhe të përgjegjshëm, jo si turma nën ndikimin e pushtetarëve. Le të mos harrojmë se “qytetaria e përgjegjshme është një virtyt dhe

¹⁷⁹ Pali VI, Letra Enciklike *Populorum Progressio* (26 mars 1967), 76: AAS 59 (1967), 294-295.

pjesëmarrja në jetën politike është një detyrim moral”¹⁸⁰. Megjithatë të bëhesh një *popull* kërkon diçka më shumë. Është një proces i vazhdueshëm në të cilin duhet të marrë pjesë brezi i ri: një përpjekje e ngadaltë dhe e lodhshme që kërkon një dëshirë për t’u integruar dhe një gatishmëri për ta arritur këtë përmes zhvillimit të kulturës së takimit në një harmoni të shumëllojshme.

221. Për të përparuar në ndërtimin e një populli në paqe, drejtësi dhe vëllazëri, kemi katër parime të lidhur me tensione dypolare të vazhdueshme që janë të pranishme në çdo realitet shoqëror. Këto rrjedhin nga shtyllat e doktrinës shoqërore të Kishës, të cilat shërbejnë si “parametra themelore referimi për interpretimin dhe vlerësimin e fenomeneve shoqërore”¹⁸¹. Në dritën e tyre unë dua të parashtroj tani këto parime specifike që mund të udhëheqin zhvillimin e jetës në shoqëri dhe ndërtimin e një populli në të cilin ndryshimet harmonizohen brenda një projekti të përbashkët.

¹⁸⁰ Konferenca e ipeshkvijve katolikë amerikanë, Letër pastorele *Forming Conscience for Faithful Citizenship* (nëntor 2007), 13.

¹⁸¹ Konkili Pontifikal për Drejtësi e Paqe, *Compendium of the Social Doctrine of the Church*, 161.

Unë e bëj këtë nga bindja se zbatimi i tyre mund të jetë një shteg i vërtetë drejt paqes në çdo komb dhe në mbarë botën.

Koha është më e madhe sesa hapësira

222. Një tension i vazhdueshëm ekziston midis plotësisë dhe kufizimit. Plotësia nxit dëshirën për një zotërim të plotë, ndërsa kufizimi është muri që kemi përpara. Në kuptimin e gjerë të fjalës, “koha” ka të bëjë me plotësinë si një shprehje të horizontit që hapet vazhdimisht para nesh, ndërsa çdo çast i veçantë ka të bëjë me kufizimin si një hapësirë e rrethuar apo e mbyllur. Qytetarët jetojnë në tension midis rrethanave të momentit dhe dritës së kohës, të horizontit më të gjerë e të utopisë që hapet ndaj të ardhmes si shkaku përfundimtar që na tërheq. Këtu ne shohim një parim të parë në përparimin drejt ndërtimit të një populli: koha është më superiore nga hapësira.

223. Ky parim na aftëson që të punojmë me një perspektivë afat-gjatë, pa maninë për të arritur rezultate të menjëhershme. Na ndihmon që të

durojmë situatat e vështira dhe të pafavorshme, ose ndryshimet e paevitueshme të planeve tona. Na fton që të pranojmë tensionin midis plotësisë dhe kufizimeve dhe t'i japim përparësi kohës. Një nga gabimet që shohim herë pas here në veprimtarinë socio-politike është që hapësirat dhe pushteti preferohen ndaj kohës dhe proceseve. T'i japësh përparësi hapësirës do të thotë të përpiqesh me çdo kusht që të zgjidhësh gjithçka në të tanishmen, duke u përpjekur për të zotëruar të gjitha hapësirat e pushtetit dhe të vetëpohimit dhe do të thotë të kristalizosh procese e të përpiqesh t'i ndalosh. T'i japësh përparësi kohës do të thotë të merresh më shumë me *nisjen e proceseve sesa me zotërimin e hapësirave*. Koha i qeveris hapësirat, i ndriçon dhe i bën si hallka në një zinxhir që vjen duke u zmadhuar, pa u kthyer prapa. Pra ne kemi nevojë që t'u japim përparësi veprimeve që lindin procese të reja në shoqëri dhe përfshijnë persona të tjerë dhe grupe të cilat mund t'i zhvillojnë derisa të japin fryte në ngjarjet domethënëse historike. Pa ankth, por me bindje të qartë dhe të prerë.

224. Disa herë pyes veten nëse ka njerëz në botën e sotme të cilët janë më shumë të shqetësuar për

proceset gjeneruese të ndërtimit të një populli, sesa për të arritur rezultate të menjëhershme që prodhojnë fitime të lehta dhe afat-shkurtra politike, por pa e zgjeruar plotësinë njerëzore. Historia do t'i gjykojë ata ndoshta me kriterin që përmend Romano Guardini: "E vetmja masë për vlerësimin e duhur të një epoke është të pyesësh se në ç'masë e ushqen zhvillimin dhe arritjen e një *ekzistence të plotë dhe autentike njerëzore*, në përputhje me natyrën e veçantë dhe aftësitë e kësaj moshe"¹⁸².

225. Ky kriter zbatohet edhe ndaj ungjillëzimit, që kërkon të pasurit parasysh të tablosë më të gjerë, të hapurit ndaj proceseve të përshtatshme dhe shqetësimit afatgjatë. Vetë Zoti, gjatë jetës së tij tokësore, shpesh i paralajmëronte nxënësit e tij se kishte disa gjëra që nuk mund t'i kuptonin ende por duhet të prisnin për Shpirtin e Shenjtë (krh. Gjn 16,12-13). Shëmbëlltyra e egjrit në mes të grurit (krh. Mt 13,24-30) ilustron qartë një aspekt të rëndësishëm të ungjillëzimit: armiku mund të futet në territorin e mbretërisë dhe të shkaktojë dëm, por në fund ai mposhtet nga mirësia e grurit.

¹⁸² Das Ende der Neuzeit, Würzburg, 1965, 30-31.

226. Konflikti nuk mund të shpërfilllet apo të fshihet, por duhet të pranuar. Por nëse mbetemi të mbërthyer nën konflikt, ne e humbasim perspektivën, horizontet kufizohen dhe vetë realiteti fillon të fragmentohet. Në mes të konfliktit, ne humbim ndjenjën e unitetit të thellë të realitetit.

227. Kur konflikti shfaqet, disa njerëz vetëm sa e shikojnë dhe vazhdojnë punën e tyre sikur asgjë të mos ketë ndodhur. Ata i lajnë duart prej kësaj dhe vazhdojnë me jetën e tyre. Kurse disa të tjerë përfshihen aq shumë në të, sa që kthehen në të burgosur të tij, duke humbur horizontin, duke projektuar në institucione konfuzionin e pakënaqësinë e tyre, duke e bërë kështu të pamundur unitetin. Por ka dhe një rrugë të tretë, që është mënyra më e mirë për trajtimin e konfliktit: gatishmëria për t'u përballur hapur me konfliktin, për ta zgjidhur atë dhe për ta kthyer atë në një hallkë lidhëse në zinxhirin e një procesi të ri. "Lum pajtuesit" (Mt 5,9).

228. Në këtë mënyrë bëhet i mundur ndërtimi i bashkësisë në mes të pikëpamjeve të ndryshme, që mund të arrihet vetëm nga ato persona fisnikë të cilët janë të gatshëm për ta kapërcyer sipërfaqen e konflikteve dhe t'i shohin të tjerët në dinjitetin e tyre më të thellë. Kjo kërkon pranimin e një parimi të domosdoshëm për ndërtimin e miqësisë shoqërore: që është postulati se uniteti është më i madh se konflikti. Solidariteti, në kuptimin më të thellë dhe sfidues, bëhet kështu një mënyrë e të bërit të historisë në një mjedis jetësor ku konfliktet, tensionet dhe kundërshtimet mund të arrijnë një unitet të shumëllojshëm që gjeneron jetë të re. Kjo s'do të thotë të synosh sinkretizmin, apo përvetësimin e njërit apo tjetrit, por për një zgjidhje që ndodh në një plan më të lartë dhe e ruan atë që është e vlefshme dhe e dobishme në të dyja anët.

229. Ky kriter që buron nga Ungjilli, na kujton se Krishti i ka unifikuar të gjitha gjërat në Vetvete: qiellin e tokën, Zotin e njeriun, kohën e përjetësinë, mishin dhe shpirtin, personin dhe shoqërinë. Shenja e këtij uniteti dhe pajtimi i të gjitha gjërave në të, është paqja. Krishti është "paqja

jonë” (Ef 2,14). Mesazhi i Ungjillit fillon gjithnjë me një përshëndetje paqeje dhe paqja kurorëzon dhe përforcon në çdo kohë marrëdhëniet midis dishepujve. Paqja është e mundur sepse Zoti e ka mposhtur botën dhe konfliktin e saj të vazhdueshëm “duke vendosur paqen me anë të gjakut të kryqit [të Tij]” (Kol 1,20). Por nëse i shohim më imtësisht këto tekste biblike, vërejmë që vendi i parë në të cilin jemi të thirrur për ta fituar këtë zbutje të mospajtimeve gjendet në brendësi të vetes, në jetët tona, të cilat janë gjithnjë të kërcënuara nga copëzimi dialektik¹⁸³. Me zemrat e thërrmuara në mijëra copëza, do të jetë e vështirë të ndërtohet paqen e vërtetë në shoqëri.

230. Mesazhi i paqes nuk ka të bëjë me një marrëveshje të negociuar por me bindjen se uniteti që sjell Shpirti mund të harmonizojë çdo diversitet. Ai mposht çdo konflikt duke krijuar një sintezë të re dhe premtuese. Diversiteti është diçka e mrekullueshme kur mund të përfshihet vazhdimisht në një proces pajtimi dhe të vulosë një farë besëlidhje kulturore që rezulton në

¹⁸³ Shih I. Quiles, S.J., *Filosofia de la educación personalista*, Buenos Aires, 1981, 46-53.

një “diversitet të pajtuar”, siç e kanë shprehur ipeshkvijtë kongolezë: “Diversiteti ynë etnik është pasuria jonë... Vetëm në unitet, përmes kthimit të zemrave dhe pajtimit, që do të mund ta ndihmojmë vendin tonë që të zhvillohet në çdo drejtim”¹⁸⁴.

Realitetet janë më të rëndësishme sesa idetë

231. Ekziston gjithashtu një tension i vazhdueshëm midis ideve dhe realiteteve. Realitetet thjesht ekzistojnë, ndërsa idetë zhvillohen apo kultivohen. Duhet të ketë një dialog të vazhdueshëm midis të dyjave, në mënyrë që idetë të mos shkëputen nga realitetet. Është e rrezikshme të jetosh në një botë ku ka vetëm fjalë, imazhe dhe retorikë. E kështu një parim i tretë del në skenë: realitetet janë më të mëdha se idetë. Kjo kërkon për refuzimin e mjeteve të ndryshme të fshehjes së realitetit: forma engjëllore pastërtie, diktatura e relativizmit, retorika e zbrazët, objektiva që janë më shumë ideale sesa reale, lloje të ndryshme të

¹⁸⁴ Comité Permanent De La Conférence Épiscopale Nationale Du Congo, *Message sur la situation sécuritaire dans le pays* (5 dhjetor 2012), 11.

një fundamentalizmi jo historik, sisteme etike të privuar nga mirësia dhe fjalime intelektuale të privuar nga urtësia.

232. Idetë, përpunimet konceptuale janë në shërbim të mbledhjes, kuptimit dhe drejtimit të realitetit. Idetë e shkëputura nga realitetet prodhojnë forma jo efektive të idealizmit dhe nominalizmit, të cilat më së shumti mund të klasifikojnë apo të përkufizojnë por nuk të përfshijnë në veprim. Ajo që na vë në veprim është realiteti i ndriçuar nga arsyeja. Nominalizmi formal duhet t'i lërë vendin objektivitetit të harmonishëm. Përndryshe, e vërteta manipulohet, kozmetika i zë vendin kujdesit të mirëfilltë ndaj trupave tanë¹⁸⁵. Ne kemi politikanë, madje edhe udhëheqës fetarë të cilët habiten pse njerëzit nuk i kuptojnë dhe i ndjekin ata, meqenëse propozimet e tyre janë mjaft të qarta dhe logjike. Ndoshta kjo ndodh sepse ata duke qenë të mbërthyer në sferën e ideve e kanë reduktuar politikën apo besimin në një retorikë të thjeshtë. Të tjerët e kanë lënë thjeshtësinë nga pas dhe kanë importuar një racionalizëm që është i huaj për shumë njerëz.

¹⁸⁵ Shih Plato, *Gorgias*, 465.

233. Realiteti është më i madh se idetë. Ky kriter lidhet me mishërimin e Fjalës dhe me zbatimin e saj në praktikë: “Me këtë mund ta njihni shpirtin që vjen prej Hyjit: çdo shpirt që dëshmon se Jezu Krishti ka ardhur në trup, është prej Hyjit” (1 Gjn 4,2). Kriteri i realitetit, i një Fjale tashmë të mishëruar dhe që përpiket vazhdimisht të mishërohet është thelbësor në ungjillëzim. Kjo na ndihmon nga një anë që të vlerësojmë historinë e Kishës si një histori shpëtimi, për të ruajtur në kujtesë shenjtërit që e kulturuan Ungjillin në jetën e popujve tanë dhe për të mbledhur frytet e traditës së pasur dymijë-vjeçare të Kishës, pa pretenduar përpunimin e një sistemi idesh të shkëputura nga ky thesar, sikur të donim të sajnim Ungjillin. Nga ana tjetër, ky parim na shtyn që ta vëmë fjalën në praktikë, të kryejmë veprat e drejtësisë dhe dashurisë që e bëjnë këtë fjalë të frytshme. Duke mos e vënë në praktikë, duke mos e bërë realitet do të thotë të ndërtosh mbi rrëzë, të qëndrosh në sferën ku sundojnë vetëm idetë dhe të përfundosh në një agnosticizëm dhe egocentrizëm të pajetë dhe të pafrytshëm.

E tëra është më e madhe se pjesa e veçantë

234. Edhe midis globalizimit dhe lokalizimit ekziston një tension. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje përmasës globale për të mos rënë në kurthin e meskinitetit e banalitetit të përditshëm. Por duhet të shikojmë edhe atë lokal, në mënyrë që të ecim me këmbët në tokë. Së bashku, të dyja na ndihmojnë që të mos biem pre e njërit prej këtyre dy ekstremeve. Në njërin, qytetarët bien pre e një universi abstrakt e të globalizuar, si pasagjerë të fshehur në vagonin e fundit, të cilët admirojnë fishekzjarrët e botës që u takon të tjerëve, duke u habitur dhe në të njëjtën kohë edhe duke dhënë duartrokitje të programuara. Kurse në ekstremin tjetër, ata kthehen në një muze folkloristik, eremitësh lokalë, të dënuar me përsëritjen e të njëjtave gjëra, pa qenë në gjendje që të sfidohen nga risia apo të vlerësojnë bukurinë që Zoti jep përtej kufijve të tyre.

235. E tëra është më e madhe se një pjesë e veçantë, por është gjithashtu më e madhe se shumta e pjesëve të saj. Prandaj nuk kemi pse të merremi aq shumë me çështje të kufizuara dhe të

veçanta. Ne na duhet vazhdimisht që ta zgjerojmë horizontin dhe të shohim të mirën më të madhe që do të na sjellë dobi të gjithëve. Por kjo duhet bërë pa u shmangur dhe pa çrrënjosje. Ne duhet të përthellojmë rrënjët tona në tokën pjellore dhe në historinë e vendlindjes sonë, që është dhurata e Zotit. Ne mund të punojmë edhe në një shkallë të ulët, si në vendin ku banojmë, por duhet ta bëjmë këtë me një perspektivë të gjerë. Në të njëjtën mënyrë, një person që e ruan individualizmin dhe nuk e fsheh identitetin e tij, kur integrohet përzemërsisht në jetën e një komuniteti, nuk ndrydhet por vetëm sa merr një shtytje të re për rritje personale. Sfera globale nuk ndrydh dhe njëanshmëria e izoluar nuk sterilizon.

236. Këtu modeli ynë nuk është sfera, që nuk është më e madhe se pjesët e saj, ku çdo pikë është e baraslarguar nga qendra dhe nuk ka ndryshime midis tyre. Modeli është në fakt polihedroni, që reflekton konvergjencën e të gjitha pjesëve të tij e secila prej tyre e ruan dallueshmërinë e vet. Si veprimtaria politike ashtu edhe ajo pastorale përpiqen të mbledhin në këtë polihedron më të mirën e secilit. Ka një vend për të varfrit dhe

kulturën e tyre, aspiratat dhe potencialin e tyre. Edhe njerëzit që mund të kritikohen për gabimet e tyre kanë diçka për të ofruar që nuk duhet nënvleftësuar. Është bashkimi ose konvergjenca e popujve të cilët brenda rendit universal, e ruajnë individualitetin e tyre; është tërësia e personave në një shoqëri që kërkon të mirën e përbashkët e cila me të vërtetë i përfshin të gjithë.

237. Për ne të krishterët ky parim flet edhe për tërësinë apo integritetin e Ungjillit që Kisha na e përcjell dhe na e jep për ta predikuar. Plotësia dhe pasuria përfshijnë profesorë dhe punëtorë, biznesmenë dhe artistë, me një fjalë çdo njeri. “Mistika popullore” e merr në mënyrën e vet të tërë Ungjillin dhe e mishëron në shprehje lutjesh, vëllazërie, drejtësie, konfliktesh dhe kremtimi. Lajmi i mirë është gëzimi i një Ati që nuk dëshiron të humbasë asnjë nga të vegjlit e vet. Ungjilli është tharmi që e bën brumin të fryhet dhe qyteti i ngritur mbi kodër, që i ndriçon me dritën e vet të gjithë popujt. Ungjilli zotëron në vetvete një kriter tërësie që është i qenësishëm: nuk pushon së qeni Lajm i Mirë derisa t’u kumtohet të gjithëve, derisa të japë fryte duke shëruar e forcuar çdo aspekt të njeriut dhe derisa t’i ketë bashkuar të gjithë

njerëzit në tryezën e Mbretërisë. E tëra është më e madhe se e pjesshmja.

IV. DIALOGU SHOQËROR SI KONTRIBUT NDAJ PAQES

238. Ungjillëzimi përfshin gjithashtu shtegun e dialogut. Për Kishën, në kohën e sotme ekzistojnë tre sfera të dialogut ku duhet të jetë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e plotë njerëzor dhe për të ndjekur të mirën e përbashkët: dialogun me shtetet, dialogun me shoqërinë- duke përfshirë dialogun me kulturat dhe shkencat dhe dialogun me besimtarët e tjerë të cilët nuk janë pjesë e Kishës Katolike. Në secilin rast, “Kisha flet nga drita që ofron feja”¹⁸⁶, duke i kontribuar përvojën e dymijë viteve dhe duke mbajtur të gjallë në mendje jetën dhe vuajtjet e qenieve njerëzore. Kjo dritë e tejkalon arsyen njerëzore dhe ka një domethënie që mund të pasurojë ata që nuk besojnë dhe e fton arsyen të zgjerojë perspektivën e saj.

239. Kisha shpall “Ungjillin e paqes” (Ef 6,15) dhe dëshiron të bashkëpunojë me të gjitha

¹⁸⁶ Benedikti XVI, *Fjalim drejtuar Kurias Romane* (21 dhjetor 2012): AAS 105 (2013), 51.

autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare për t'u kujdesur për të mirë të madhe universale. Duke predikuar Jezu Krishtin që është vetë paqja (krh. Ef 2,14), ungjillëzimi i ri i bën thirrje çdo të pagëzuari për të qenë një pajtues dhe një dëshmitar i besueshëm ndaj jetës së pajtuar¹⁸⁷. Në një kulturë që e privilegjon dialogun si një formë takimi, ka ardhur koha për të gjetur një mjet për ndërtimin e konsensusit dhe marrëveshjes, pa e ndarë nga preokupimi për një shoqëri të drejtë, plot kujtesë dhe pa përjashtime. Autori kryesor, subjekti historik i këtij procesi është populli në tërësi dhe kultura e tyre dhe jo një klasë e vetme, pakicë, grup apo elitë. Ne nuk kemi nevojë për plane të hartuara nga pak veta të cilat u drejtohen pak vetave apo për një pakicë të shkolluar që pretendon se flet për të gjithë. Por është fjala për të rënë dakord që të jetohet së bashku, për një pakt shoqëror dhe kulturor.

240. Është përgjegjësia e Shtetit për të ruajtur dhe promovuar të mirën e përbashkët të shoqërisë¹⁸⁸.

¹⁸⁷ Shih *Propositio* 14.

¹⁸⁸ Shih *Katekizmi i Kishës Katolike*, 1910; Koncili Pontifikal për Drejtësi dhe Paqe, *Përmbledhje e Doktrinës shoqërore të Kishës*, 168.

Bazuar në parimet e suplementares dhe solidaritetit dhe tërësisht e përkushtuar ndaj dialogut e konsensusit politik, luan një rol themelor, që nuk mund të delegohet në arritjen e zhvillimit integral të të gjithëve. Ky rol, në rrethanat e tanishme, kërkon një përpulje të thellë shoqëror.

241. Në dialogun e saj me shtetin e shoqërinë, Kisha nuk ofron zgjidhje për çdo çështje specifike. Së bashku me sektorët e ndryshëm të shoqërisë, ajo mbështet ato programe që i përgjigjen më së miri dinjitetit të çdo personi dhe të mirës së përbashkët. Duke e bërë këtë, ajo propozon në një mënyrë të qartë vlerat themelore të jetës njerëzore dhe bindjet që mund të gjejnë shprehje në veprimtarinë politike.

Dialogu midis fesë, arsyes dhe shkencës

242. Dialogu midis shkencës dhe fesë i përket gjithashtu shërbesës së ungjillëzimit në shërbim të paqes¹⁸⁹. Ndërsa pozitivizmi dhe besiminë metodën shkencore "refuzojnë të pranojnë vlefshmërinë e

¹⁸⁹ Shih *Propositio* 54.

formave të njohjes që janë të ndryshme nga ato të shkencave pozitive”¹⁹⁰, Kisha propozon një tjetër rrugë që kërkon një sintezë midis përdorimit të përgjegjshëm të metodave që u shkojnë për shtat shkencave empirike dhe sferave të tjera të njohjes si filozofia, teologjia, ashtu si dhe vetë besimi, që e ngre qenien njerëzore deri te misteri që e tejkalon natyrën dhe inteligjencën njerëzore. Besimi nuk ka frikë nga arsyeja, përkundrazi e kërkon dhe i beson arsyes, duke qenë se “drita e arsyes dhe drita e fesë vijnë të dyja nga Zoti”¹⁹¹ dhe nuk mund të kundërshtojnë njëra-tjetrën. Ungjillëzimi është i vëmendshëm ndaj përparimeve shkencore dhe dëshiron të derdhë mbi ta dritën e fesë dhe atë të dritës natyrore, në mënyrë që të respektojnë vlerën supreme të qenies njerëzore në çdo fazë të jetës. E tërë shoqëria mund të pasurohet falë këtij dialogu, që hap horizonte të reja mendimi dhe i zgjeron mundësitë e arsyes. Edhe ky është një shteg harmonie dhe paqeje.

243. Kisha nuk ka dëshirë që ta zmbrapsë përparimin e mahnitshëm të shkencës. Përkundrazi,

¹⁹⁰ Gjon Pali II, Letër enciklike *Fides et Ratio* (14 shtator 1998), 88: AAS 91 (1999), 74.

¹⁹¹ Shën Tomë Akuinati, *Summa contra Gentiles*, I, 7; shih edhe Gjon Pali II, Letër enciklike *Fides et Ratio* (14 shtator 1998), 43: AAS 91 (1999), 39.

ajo gëzohet dhe madje kënaqet duke e pranuar potencialin e jashtëzakonshëm që Hyji i jep mendjes njerëzore. Sa herë që përparimi shkencor, duke iu përmbajtur me përpikëri akademike sipas fushës së objektit të tyre specifik, arrin në një përfundim që arsyeja nuk mund ta refuzojë, besimi nuk e kundërshton atë. Po ashtu edhe besimtarët nuk mund të pretendojnë se një opinion shkencor që është tërheqës por që nuk është vërtetuar mjaftueshëm ka të njëjtën peshë me një dogmë feje. Por në disa raste, shkencëtarët i kanë kapërcyer kufijtë e kompetencës së tyre shkencore duke bërë disa deklaratatë të caktuara. Por këtu problemi nuk është me vetë arsyen por me promovimin e një ideologjie të veçantë që e pengon dialogun e mirëfilltë, paqësor dhe produktiv.

Dialogu ekumenik

244. Përkushtimi ndaj ekumenizmit i përgjigjet lutjes së Zotit Jezus “që të gjithë të jenë një” (Gjn 17,21). Besueshmëria e mesazhit të krishterë do të ishte më i madh nëse të krishterët do t’i kapërcenin ndarjet e tyre dhe Kisha do të arrinte “plotësinë

e katolicitetit të tyre që i takon asaj në ata fëmijë të saj të cilët megjithëse janë të bashkuar me anë të pagëzimit, janë ende të ndarë nga bashkësia e plotë me të"¹⁹². Ne s'duhet ta harrojmë kurrë se jemi shtegtarë që shtegtojmë pranë njëri-tjetrit. Kjo do të thotë se duhet të kemi një besim të sinqertë të bashkështegtarët tanë, duke flakur mënjanë çdo dyshim apo mosbesim dhe ta kthejmë vështrimin tonë në atë që kërkojmë të gjithë: paqen rrezatuese të fytyrës së të vetmit Hyj. T'i besosh tjetrit është një art dhe po ashtu edhe paqja. Jezusi na ka thënë: "Lum pajtuesit" (Mt 5,9). Duke përmbushur këtë detyrë edhe në mes nesh, përmbushet profecia e lashtë: "shpatat e veta do t'i kthejnë në plorë" (Is 2,4).

245. Në këtë perspektivë, ekumenizmi mund të shihet si një kontribut ndaj unitetit të familjes njerëzore. Prania në sinod, e Patriarkut të Kostandinopojës, Hirësia e tij Bartolemeut I-rë dhe arqipeshkvit të Kanterbërit, Hirësisë së tij Rouan Uliams¹⁹³, ka qenë një dhuratë e vërtetë nga Zoti dhe një dëshmi e çmuar e krishterë.

¹⁹² Koncili i Dytë i Vat. Dekreti mbi ekumenizmin *Unitatis Redintegratio*, 4.

¹⁹³ Cfr Propositio 52.

246. Për shkak të seriozitetit të kundër-dëshmisë së ndarjeve ndër të krishterët, sidomos në Azi dhe Afrikë, kërkitimi i shtigjeve të unitetit bëhet edhe më i ngutshëm. Misionarët në këto kontinente shpesh përmendin kritikën, ankesat dhe talljet që vijnë si pasojë e skandalit të shkaktuar nga përçarjet e të krishterëve. Nëse përqendrohemi në bindjet që na bashkojnë dhe nëse kemi parasysh parimin e hierarkisë së të vërtetave, do të jemi një gjendje që të përparojmë shpejt drejt shprehjeve të përbashkëta të kumtimeve, shërbesave dhe dëshmimeve. Numri i pafund i njerëzve që nuk e kanë pranuar Ungjillin e Jezu Krishtit nuk mund të na lërë indiferentë. Si rrjedhim, përkushtimi ndaj një uniteti që i ndihmon për të pranuar Jezu Krishtin nuk mund të jetë më një çështje që ka të bëjë thjesht me diplomacinë apo me një përmbushje të detyrueshme të detyrës, por një shteg i domosdoshëm drejt ungjillëzimit. Shenjat e ndarjes midis të krishterëve në vende të rrënuara nga dhuna shtojnë raste dhune nga ana e atyre që duhet të ishin një tharm i paqes. Janë të shumta dhe mjaft të çmuara gjërat që na bashkojnë! Nëse besojmë me të vërtetë në veprimin e lirë të Shpirtit

të Shenjtë, ne mund të mësojmë shumë prej njëri-tjetrit! Nuk është fjala thjesht për të marrë informacion për të tjerët, që t'i njohim më mirë, por për të mbledhur atë që Shpirti ka mbjellë në ta, si një dhuratë edhe për ne. Për t'ju dhënë një shembull, në dialogun me vëllezërit e motrat tona ortodokse, ne Katolikët kemi mundësinë që të mësojmë më shumë mbi kuptimin e kolegjalitetit ipeshkvnor dhe përvojën e tyre sinodale. Përmes shkëmbimit të dhuratave, Shpirti mund të na udhëheqë gjithnjë e më shumë te e vërteta dhe mirësia.

Marrëdhëniet me judaizmin

247. Ne kemi një konsideratë të veçantë ndaj popullit hebre sepse besëlidhja e tyre me Hyjin nuk është anuluar, “sepse dhuratat dhe grishja e Hyjit nuk tërhiqen” (Rom 11,29). Kisha që ndan me hebrejntë një pjesë të rëndësishme të Shkrimeve të Shenjta, e shikon popullin e besëlidhjes dhe besimin e tyre si një nga rrënjët e shenjta të identitetit të tyre të krishterë (krh. Rom 11,16-18). Si të krishterë, ne nuk mund ta konsiderojmë

judaizmin si një fe të huaj, e as nuk i përfshijmë çifutët në mesin e atyre që duhet të kthehen nga idhujt për t'i shërbyer Hyjit të vërtetë (krh. 1 Sel 1,9). Bashkë me ta, ne besojmë në Hyjin e vetëm që vepron në histori dhe me ta e pranojmë Fjalën e përbashkët të zbuluar.

248. Dialogu dhe miqësia me bijtë e Izraelit janë pjesë e jetës së nxënësve të Jezusit. Miqësia që është zhvilluar në mes nesh na bën që të na vijë keq me hidhërim dhe sinqeritet për përndjekjet e tmerrshme që ata kanë hequr, dhe vazhdojnë të heqin, sidomos ato prej të krishterëve.

249. Hyji vazhdon të veprojë në popullin e Besëlidhjes së Vjetër dhe të sjellë thesare diturie që burojnë nga takimi i tyre me Fjalën hyjnore. Për këtë arsye edhe Kisha pasurohet kur merr vlerat e judaizmit. Megjithëse është e vërtetë se disa besime të krishtera janë të papranueshme ndaj judaizmit, dhe që Kisha nuk mund të heqë dorë nga të shpallurit e Jezusit si Zot dhe Mesi, ekziston edhe një plotësueshmëri që na lejon t'i lexojmë tekstet e Shkrimeve Hebraike së bashku dhe të

ndihmojmë njëri-tjetrit për të rrënuar pasuritë e Fjalës së Hyjit. Ne mund të ndajmë së bashku edhe shumë bindje etike dhe një preokupim të përbashkët për drejtësi dhe zhvillim të popujve.

Dialogu ndërjetar

250. Një qëndrim i hapur në të vërtetën dhe dashurinë duhet të karakterizojë dialogun me pasuesit e besimeve jo të krishtera, pavarësisht nga pengesat dhe vështirësitë e ndryshme, sidomos fundamentalizmat në të dyja krahët. Ky dialog ndërjetar është një kusht i domosdoshëm për paqen në botë, prandaj është detyrë për të krishterët, ashtu si dhe për komuniteteve të tjera fetare. Ky dialog është së pari një bisedë midis ekzistencës njerëzore ose thjesht, siç e kanë shprehur ipeshkvijtë indianë: “një qëndrim i hapur ndaj tyre, duke ndarë gëzimet dhe pikëllimet e tyre”¹⁹⁴. Në këtë mënyrë ne mësojmë të pranojmë të tjerët dhe mënyrat e tyre të ndryshme të të jetuarit, të menduarit dhe të folurit. Me këtë metodë, mund të ndërmarrim së bashku detyrën

¹⁹⁴ Konferenca e ipeshkvijve indianë, Deklarim përfundimtar i Asamblesë së 30-të të përgjithshme: *Roli i Kishës për një Indi më të mirë* (8 Mars 2013), 8.9.

e të shërbyerit të drejtësisë dhe paqes, që duhet të bëhet një parim bazë i të gjitha shkëmbimeve tona. Një dialog që kërkon paqen shoqërore dhe drejtësinë është në vetvete, përtej çdo aspekti pragmatik, një përkushtim etik që sjell një situatë të re shoqërore. Përpjekjet që bëhen kur trajtojmë një temë specifike mund të shndërrohen në një proces në të cilin, me anë të dëgjuarit të tjetrit, të dyja palët mund të pastrohen dhe pasurohen. Prandaj edhe këto përpjekje mund të shprehin dashurinë për të vërtetën.

251. Në këtë dialog, gjithnjë të përzemërt dhe të singertë, nuk duhet nënvleftësuar kurrë lidhja esenciale midis dialogut dhe kumtimit, që e çon Kishën ta ruajë dhe intensifikojë marrëdhënien e saj me jo të krishterët¹⁹⁵. Një sinkretizëm pajtues do të ishte një totalitarizëm nga ana e atyre që pretendojnë të realizojnë pajtimin duke shpërfillur vlerat e mëdha, të cilat nuk i zotërojnë. Hapja e vërtetë kërkon të qëndrosh i patundur në bindjet e tua më të thella, me një identitet të qartë dhe të gëzueshëm, ndërkohë duke qenë edhe “i hapur ndaj bindjeve të palës tjetër” dhe “duke e ditur

¹⁹⁵ Shih *Propositio* 53.

se dialogu mund të pasurojë secilin¹⁹⁶. Nuk na vlen hapja diplomatike që i thotë “po” githçkaje me qëllim që të shmangë problemet, sepse kjo do të ishte një mënyre e të mashtruarit të tjetrit, duke i mohuar të mirën që na është dhënë për ta ndarë bujarisht me të tjerët. Ungjillëzimi dhe dialogu ndërfitar, në vend që të jenë në kundërshtim me njëri-tjetrin, e përkrahin dhe ushqejnë njëri-tjetrin¹⁹⁷.

252. Marrëdhënia jonë me pasuesit e islamizmit ka marrë një rëndësi të madhe në kohën tonë, meqenëse ata janë sot mjaft të pranishëm në shumë vende tradicionalisht të krishtera, ku mund të kremtojnë lirisht kultin e vet dhe të jetojnë të integruar në shoqëri. Ne nuk duhet të harrojmë kurrë se ata “shpallin se besojnë fenë e Abrahamit dhe së bashku me ne adhurojnë të vetmin Hyj të mëshirshëm që do ta gjykojë njerëzimin ditën e fundit”¹⁹⁸. Shkrimet e shenjta të Islamit i kanë

¹⁹⁶ Gjon Pali II, Letër enciklike *Redemptoris Missio* (7 dhjetor 1990), 56: AAS 83 (1991), 304.

¹⁹⁷ Shih Benedikti XVI, *Fjalim i mbajtur përpara Kurias Romane* (21 dhjetor 2012): AAS 105 (2006), 51.

¹⁹⁸ Koncili II ekumenik i Vat., Kushtetuta dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 16.

ruajtur disa prej mësimëve të krishtera; Jezusi dhe Maria nderohen shumë dhe është e admirueshme që të shohësh shumë e shumë myslimanë të rinj e pleq, burra e gra, që të kushtojnë kohë për lutje të përditshme dhe të marrin pjesë besnikërisht në shërbesat fetare. Shumë prej tyre kanë një bindje të thellë se jeta e tyre në tërësi vjen nga Zoti dhe është për të. Ata e pranojnë gjithashtu nevojën për t’iu përgjigjur Zotit me një përkushtim etik dhe me dhembshuri ndaj më të varfërve.

253. Për të mbajtur gjallë dialogun me myslimanët, është i padiskutueshëm formimi i bashkëbiseduesve, jo vetëm që të jenë të rrënjësor fort dhe me gëzim në identitetin e tyre, por në mënyrë që edhe të pranojnë vlerat e të tjerëve e të çmojnë shqetësimet që kanë të bëjnë me kërkesat e tyre dhe të nxjerrin në pah besimet e përbashkëta. Ne të krishterët duhet t’i mirëpresim me dashuri e respekt emigrantët myslimanë në vendet tona, ashtu siç edhe shpresojmë dhe lutemi që të mirëpritemi dhe respektohemi në vendet me traditë islamike. Unë u kërkoj përlësisht këtyre vendeve që t’u sigurojnë të krishterëve lirinë për të kremtuar dhe jetuar besimin e tyre, duke pasur parasysh lirinë që besimtarët e Islamit gëzojnë

në vendet perëndimore! Përballë me episodet e fundamentalizmit të dhunshëm, që na preokupojnë, afeksioni ndaj myslimanëve autentikë duhet të na çojë në shmangien përgjithësimeve të urryera, sepse myslimanizmi i vërtetë dhe leximi i duhur i Kuranit bien ndesh me çdo formë dhune. 254. Jo të krishterët, me anë të iniciativës së hirshme të Zotit, kur janë besnikë ndaj ndërgjegjes së tyre, mund të jetojnë “të shfajësuar nga hiri i Zotit”¹⁹⁹ dhe si rrjedhim mund “të lidhen me misterin pashkor të Jezu Krishtit”²⁰⁰. Por për shkak të dimensionit sakramental të hirit shenjtërues, veprimi i Zotit në ta priret të prodhojë shenja dhe rite, shprehje të shenjta që nga ana e tyre i sjellin të tjerët te një përvojë komunitare e rrugëtimit drejt Hyjit²⁰¹. Megjithëse iu mungojnë qëllimi dhe efektiviteti i sakramenteve të themeluara nga Krishti, ata mund të bëhen vegla që Shpirti i Shenjtë i përdor për të çliruar jo të krishterët nga imanentizmi ateist ose nga përvoja fetare krejt individuale. I njëjti Shpirt ngre kudo forma

¹⁹⁹ Komisioni ndërkombëtar teologjik, *Krishtërimi dhe fetë e botës* (1996), 72: Enchiridion Vaticanum 15, No. 1061.

²⁰⁰ *Ibid.*

²⁰¹ Shih edhe *ibid.*, 81-87: *Enchiridion Vaticanum* 15, n. 1070-1076.

të ndryshme urtësie praktike që i ndihmojnë njerëzit të durojnë vuajtjet dhe të jetojnë në paqe e harmoni më të madhe. Edhe ne të krishterët, mund të përfitojmë nga këto thesare të ngritura përgjatë shekujve, që mund të na ndihmojnë për t'i jetuar më mirë bindjet karakteristike.

Dialogu shoqëror në kontekstin e lirisë fetare

255. Etërit sinodalë kanë folur për rëndësinë e respektimit të lirisë fetare, duke e konsideruar si një të drejtë themelore të njeriut²⁰². Kjo përfshin “lirinë për të zgjedhur besimin që dikush e gjykon të vërtetë dhe për ta shfaqur publikisht fenë”²⁰³. Një pluralizëm i shëndoshë që i respekton realitetet ndryshimet dhe vlerat si të tilla, nuk kërkon privatizimin e besimeve në një përpyetje për t'i reduktuar në heshtjen dhe errësirën e ndërgjegjes së individit ose t'i kufizuar ato ndaj hapësirës së mbyllur të kishave, sinogagave apo xhamive. Kjo do të përbënte në fakt një formë të re diskriminimi dhe autoritarizmi. Respekti që i takon pakicës gnostike apo jobesimtare nuk duhet të imponohet

²⁰² Shih *Propositio* 16.

²⁰³ Benedikti XVI, Porosia Apostolike Postsinodale në Lindjen e Mesme (14 shtator 2012), 26: AAS 104 (2012), 762.

arbitrarisht në një mënyrë të tillë që i bën të heshtin bindjet e shumicës besuese ose e shpërfill pasurinë e traditave fetare. Në perspektivën afatgjatë, kjo do të ushqente më shumë ndjenjën e inatit sesa atë të tolerancës dhe të paqes.

256. Kur konsiderohet efekti i besimit në jetën publike, duhet të dallohet midis mënyrave të ndryshme në të cilat praktikohet. Si intelektualët dhe komentet gazetareske bien në përgjithësim trashanike dhe të sipërfaqshme kur flasin për të metat e besimit dhe shpesh nuk janë në gjendje që të kuptojnë se jo të gjithë besimtarët apo udhëheqësit fetarë janë njësoj. Disa politikanë e shfrytëzojnë këtë konfuzion për të shfajësuar aktet e diskriminimit. Në raste të tjera, shfaqet përbuzje ndaj shkrimeve që pasqyrojnë bindjet fetare, duke harruar që tekstet fetare klasike mund të ofrojnë një domethënie të destinuar ndaj çdo epoke e zotërojnë një fuqi motivuese që hap gjithnjë horizonte të reja, nxit të menduarit, zgjeron mendjen dhe perceptueshmërinë. Kjo përbuzje ndodh për shkak të miopisë së një farë racionalizmi. A është e arsyeshme dhe inteligjente

që të përjashtosh disa shkrime vetëm sepse janë shfaqur në kontekstin e një besimi fetar? Këto shkrime përfshijnë parime që janë thellësisht humaniste dhe pavarësisht se janë të përshkuar nga simbole dhe mësimet fetare, ato kanë një farë vlere racionale.

257. Si besimtarë, ne ndjehemi afër edhe atyre që nuk e konsiderojnë veten pjesë e asnjë tradite fetare, ndonëse e kërkojnë sinqerisht të vërtetën, mirësinë dhe bukurinë që ne besojmë se e kanë shprehjen e burimin më të lartë në Zotin. Ne i konsiderojmë ata si partnerë të çmuar në përku-shtimin e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, në ndër-timin e bashkekzistencës paqësore midis popujve dhe në mbrojtjen e krijimit. Një vend i veçantë takimi ofrohet nga të ashtuquajturit *Aeropagitët* e rinj, siç është “Oborri i joçifutëve” ku “besimtarë dhe jo besimtarë mund të përfshihen në dialog mbi çështjet themelore të etikës, artit dhe shkencës dhe mbi kërkimin e të përsosurës”²⁰⁴. Edhe ky është një shteg paqeje në botën tonë të trazuar.

258. Duke u nisur nga disa çështje të caktuara shoqërore me rëndësi të madhe për të ardhmen

²⁰⁴ Shih *Propositio* 55.

e njerëzimit, jam përpjekur që ta bëj sa më të qartë dimensionin e pashmangshëm shoqëror të mesazhit të Ungjillit dhe për t'i nxitur të gjithë të krishterët që ta shfaqin atë me anë të fjalëve, qëndrimeve dhe veprave të tyre.

KREU V

UNGJILLËZUES ME SHPIRTIN E SHENJTË

259. Ungjillëzues me Shpirtin e Shenjtë do të thotë ungjillëzues që janë të hapur pa u trembur ndaj veprimit të Shpirtit të Shenjtë. Ditën e Rrëshajave, Shpirti i shtyu Apostujt që të dilnin nga vetja dhe i shndërroi ata në lajmëtarë të veprave madhështore të Hyjit, të aftë për t'i folur secilit në gjuhën e vet. Shpirti i Shenjtë sjell kurajën për të shpallur risinë e Ungjillit me guxim (*parresia*) në çdo kohë dhe vend, edhe kur ndeshet me kundërshtimin. Le t'i lutemi atij sot, të rrënjosur fort në lutje, sepse pa lutje çdo lloj veprimtarie rrezikon të jetë shterpë dhe mesazhi ynë të jetë i zbrazët. Jezusi kërkon ungjilltarë që e shpallin lajmin e mirë jo vetëm me fjalë, por mbi të gjitha me anë të një jete të shpërfytyruar nga prania e Zotit.

260. Në këtë kapitull të fundit, nuk synoj që të paraqes një sintezë të përshtypshme të krishterë, ose që të trajtoj tema të rëndësishme si lutja, adhurimi eukaristik apo kremtimi liturgjik i besimit, mbi të cilat disponojmë tekste të çmuara

të magjisterit dhe shkrime të njohura të autorëve të shquar. Nuk pretendoj që të zëvendësoj ose të përmirësoj këto thesare. Thjesht do të propozoj disa reflektime mbi shpirtin e ungjillëzimit të ri.

261. Sa herë që themi se diçka “ka shpirt”, zakonisht i referohemi ndonjë impulsi të brendshëm që nxit, motivon, ushqen dhe i jep kuptim veprimtarisë sonë individuale dhe komunitare. Një ungjillëzim me shpirt nuk është i njëjtë me një mori detyrash që përjetohen si një detyrim i rëndë që duhet kaluar si diçka që bie ndesh me dëshirat apo prirjet e dikujt. Sa do të doja të gjej fjalët e duhura për të nxitur një fushatë ungjillëzimi më të zellshme, më të gëzueshme, bujare, të guximshme dhe plot dashuri të pakufishme dhe joshje të parezistueshme! Megjithatë unë e kuptoj se asnjë fjalë inkurajimi nuk do të jetë e mjaftueshme nëse zjarri i Shpirtit të Shenjtë nuk do të digjet në zemrat tona. Një ungjillëzim me shpirt është ungjillëzim me Shpirtin Shenjtë, sepse ai është shpirti i Kishës ungjillëzuese. Para se të propozoj motivime dhe sugjerime shpirtërore, unë po e lus edhe një herë Shpirtin e Shenjtë. E lus që të vijë dhe të na ripërtërijë, që të na shkundë, për t’i

dhënë impuls Kishës, me guxim për të dalë jashtë vetvetes për të ungjillëzuar të gjithë popujt.

I. ARSYET PËR NJË IMPULS TË PËRTËRIRË MISIONAR

262. Ungjillëzues me Shpirt do të thorrë ungjillëzues që luten dhe punojnë. Nga pikëpamja e ungjillëzimit, nuk vlejnë as propozimet mistike pa një impenjim të fortë shoqëror dhe misionar. E po ashtu s’vlejnë as diskutimet e as praktikat shoqërore apo baritore të cilave u mungon një përshtypshmëri që mund të ndryshojnë zemrat. Këto propozime të njëanshme dhe gjysmake arrijnë vetëm të disa grupe dhe rezultojnë të paafta për të depërtuar gjerësisht, pasi e gjymtojnë Ungjillin. Çfarë nevojitet është aftësia për të kultivuar një hapësirë të brendshme që mund t’i japë përkushtimit dhe veprimtarisë ndjenjën e krishterë²⁰⁵. Pa çaste të zgjatura adhurimi, takimi lutës me fjalën dhe i një dialogu apo bisede të singertë me Zotin, puna jonë do ta humbasë menjëherë kuptimin dhe do të dobësohemi për shkak të lodhjes dhe vështirësive dhe kështu

²⁰⁵ Shih *Propositio* 36.

zelli do të na shuhet. Kisha nuk mund të bëjë asgjë pa mushkëritë e lutjes dhe më gëzon shumë fakti që në institucionet kishtare të shtoheshin gupet e lutjes, të ndërmjetësimit, të leximit lutës të Fjalës dhe ndaj adhurimet e vazhdueshëm të Eukaristisë. Megjithatë, “ne duhet të refuzojmë tundimin e një përshpirtmërie intimistike dhe të individualizuar, që nuk përputhet me kërkesat e dashurisë, për të mos thënë që është përtej logjikës së mishërimit”²⁰⁶. Ekziston gjithnjë rreziku që disa çaste lutjeje mund të bëhen një pretekst për të mos ofruar jetën ndaj misionit, sepse një stil të jetuari i privatizuar mund t’i shtyjë të krishterët që të strehohen në ndonjë formë përshpirtmërie të rremë.

263. Ne duhet të kemi parasysh të krishterët e hershëm dhe vëllezërit e shumtë gjatë historisë të cilët kanë qenë plot gëzim, të mbushur me guxim dhe zell në shpalljen e Ungjillit dhe të aftë me një rezistencë të madhe në veprim. Ka dhe nga ata që ngushëllohen duke thënë se sot gjërat nuk janë si më parë, por ne e dimë se perandoria romake nuk

²⁰⁶ Gjon Pali II, Letra Apostolike *Novo Millennio Ineunte* (6 janar 2001), 52: AAS 93 (2001), 304.

e favorizonte mesazhin e Ungjillit, e as luftës për drejtësi apo mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Çdo periudhë e historisë karakterizohet nga dobësia njerëzore, kërkimi i sëmurë për vetëpërbushje, egoizmi dhe vetëkënaqësia, pa thënë asgjë për lakminë që na kërcënon të gjithëve. Një realitet i tillë është gjithnjë i pranishëm, nën një formë apo një tjetër, duke buruar më shumë nga kufizimi njerëzor sesa nga rrethanat. Të mos themi pra, se sot është më e vështirë; thjesht është më ndryshe. Të mësojmë nga shenjtërit që kanë shkuar përpara nesh, të cilët u përballën me vështirësitë e kohës së tyre. Prandaj propozoj që të ndalojmë pak për të zbuluar disa nga arsyet që mund të na ndihmojnë për t’i imituar ata në ditët e sotme²⁰⁷.

Takimi personal me dashurinë shëlbuese të Jezusit

264. Arsyeja kryesore për ungjillëzimin është dashuria e Jezusit që ne e kemi marrë, përvoja e të qenit të shëlbuar prej Tij, cfarë na nxit që të

²⁰⁷ Shih V.M. Fernández, “Espiritualidad para la esperanza activa. Discurso en la apertura del I Congreso Nacional de Doctrina Social de la Iglesia (Rosario 2011)”, in *UCActualidad*, 142 (2011), 16.

duam edhe më shumë. Por ç'është ajo dashuri që nuk e ndjen nevojën për të folur mbi personin që është i dashur për të, për ta prezantuar e për ta bërë të njohur atë? Nëse nuk ndjejmë një dëshirë të fortë për ta ndarë këtë dashuri, duhet të lutemi me ngulm që të na prekë zemrat. Ne duhet ta kërkojmë hirin e tij për çdo ditë, duke i kërkuar që të na hapë zemrat e ftohta dhe të na shkundë jetën tonë të vakët dhe të sipërfaqshme. Duke qëndruar para tij me zemra të hapura, që Ai të na vështrojë, ne shohim atë vështtrim dashurie që Natanaeli pa atë ditë kur Jezusi i tha "Para se të të thërriste Filipi, të pashë nën fik!" (Gjn 1,48). Sa mirë është të qëndrosh përpara një figure të Krishtit të kryqëzuar, ose në gjunjë përpara të shenjtërueshmit sakrament dhe të rrimë thjesht në praninë e tij! Sa mirë na bën kur ai na prek jetën tonë dhe na nxit që të ndajmë jetën e tij të re! Atëherë çfarë ndodh është që "çka pamë e dëgjuam po jua kumtojmë" (1 Gjn 1,3). Shtytja më e mirë për të ndarë Ungjillin është ta sodisësh atë me dashuri, duke qëndruar gjatë mbi faqet e tij dhe duke e lexuar me gjithë zemër. Nëse i afrohem në këtë mënyrë, bukuria e tij do të na mahnitë vazhdimisht. Por që kjo të ndodhë, ne

duhet të ripërtërijmë një shpirt *soditës* që mund të na ndihmojë për të zbuluar sërish faktin se na është besuar një thesar që na bën më njerëzore dhe na ndihmon që të bëjmë një jetë të re. Nuk ka gjë më të çmuar që mund t'ua japim të tjerëve.

265. E tërë jeta e Jezusit, mënyra sesi i trajtonte të varfrit, veprimet e tij, ndershmëria e tij, aktet e tij të përditshme të bujarisë dhe së fundi përkushtimi i tij i plotë, janë të çmuara dhe na flasin për jetën tonë personale. Sa herë që ne e ndeshim këtë, ne bindemi se është pikërisht ajo që u nevojitet të tjerëve, megjithëse ata mund të mos ta vënë re: "Pra, Atë, të cilin ju e nderoni pa e njohur, unë jua kumtoj" (Vap 17,23). Ndonjëherë ne e humbim entuziazmin ndaj misionit sepse harrojmë që Ungjilli u përgjigjet nevojave tona më të thella, duke qenë se ne jemi të krijuar për atë që Ungjilli na ofron: miqësinë me Jezusin dhe dashurinë për vëllezërit e motrat. Nëse ia dalim mbanë që ta shprehim bukur dhe si duhet përmbajtjen esenciale të Ungjillit, me siguri ky mesazh do t'u flasë dëshirave më të thella të zemrave të njerëzve: "Misionari është i bindur se me anë të veprimit të Shpirtit të Shenjtë, ekziston në individë dhe popuj

një pritje, madje e pavetëdijshe, për të njohur të vërtetën mbi Hyjin, njeriun dhe mënyrën sesi mund të çlirohem nga mëkati dhe vdekja. Entuziazmi misionar në shpalljen e Krishtit vjen nga bindja se ai po i përgjigjet kësaj pritjeje²⁰⁸. Entuziazmi për ungjillëzimin bazohet mbi këtë bindje. Ne kemi një thesar jete dhe dashurie që nuk mund të mashtrojë dhe një mesazh që nuk mund të manipulojë apo zhgënjejë. Ai përshkon thellë zemrat tona, duke na mbajtur gjallë dhe duke na fisnikëruar. Është një e vërtetë që nuk vjetrohet kurrë sepse depërton në atë pjesë të qenies sonë ku asgjë tjetër nuk mund të depërtojë. Trishtimi ynë i pakufishëm mund të shërohet vetëm nga një dashuri e pakufishme.

266. Por kjo bindje duhet të ruhet nëpërmjet përvojës personale, të përtërirë në vazhdimsi, të të shijuarit të miqësisë dhe mesazhit të tij. Është e pamundur që të ngulmohet në një ungjillëzim plot zell nëse nuk mbetesh i bindur, në virtytin e përvojës tënde, se nuk është e njëjta gjë që ta kesh njohur Jezusin apo të mos e njohësh, nuk është e

²⁰⁸ Gjon Pali II, Letra enciklike *Redemptoris Missio* (7 dhjetor 1990), 45: AAS 83 (1991), 292.

njëjta gjë të ecësh me të, ashtu siç dhe mund të ecësh verbërisht, se nuk është njëlloj dëgjosh fjalën e tij, ashtu si të mos e dëgjosh, se nuk është njëlloj ta sodisësh atë, siç të mos e sodisësh, ta adhurosh, të gjesh paqen në të, si të mos ta adhurosh apo të gjesh paqen në të. Është ndryshe të përpiqesh ta ndërtosh botën me Ungjillin në vend që të përpiqesh ta bësh këtë me logjikën tënde. Ne e dimë mirë se jeta me Jezusin bëhet më e pasur dhe me të është më e lehtë të gjesh qëllimin në çdo gjë. Prandaj ne ungjillëzojmë. Një misionar i vërtetë që nuk pushon së qeni një nxënës, e di se Jezusi ecën me të, i flet atij, merr frymë me të e punon me të. Ai e ndjen Jezusin që jeton me të në mes të shërbesës misionare. Nëse nuk e shohim atë të pranishëm në qendër të përkushtimit tonë misionar, entuziazmi do na shuhet dhe nuk do të jemi më të sigurt për atë që po përcjellim, sepse na mungon vrulli dhe pasioni. Një person që nuk është i bindur, entuziast, i sigurt dhe i dashuruar nuk mund të bindë askënd.

267. Të bashkuar me Jezusin, ne kërkojmë atë që ai do dhe kërkon. Në fund, ne kërkojmë lavdinë e Atit, jetojmë dhe veprojmë “për nder të lavdisë së

hirit të tij” (Ef 1,6). Nëse duam të përkushtohemi plotësisht dhe me ngulmim, duhet të lëmë nga pas çdo motivim tjetër. Ky është motivimi përfundimtar, më i thelli dhe më i madhi, arsyeja dhe kuptimi më i lartë në gjithçka që bëjmë: lavdia e Atit që Jezusi kërkonte në çdo çast të jetës së tij. Ai është Biri përjetësisht i lumtur me tërë qenien e tij “në gjirin e Atit” (Gjn 1,18). Nëse ne jemi misionarë, jemi kryesisht sepse Jezusi na ka thënë se “Me këtë gjë lavdërohet im Atë: nëse jepni shumë fryt” (Gjn 15,8). Përtej preferencave dhe interesave tona, të të kuptuarit dhe motivimeve tona, ne ungjillëzojmë për lavdinë më të madhe të Atit që na do.

Aroma shpirtërore e të qenit një popull

268. Fjala e Zotit na fton gjithashtu që të pranojmë se jemi një popull: “Ju që dikur *nuk ishit Popull* e tani jeni *Popull i Hyjit*” (1 Pt 2,10). Për të qenë ungjillëzues shpirttrash, ne duhet të zhvillojmë një shije shpirtërore për të qenë afër njerëzve dhe për të zbuluar se kjo bëhet një burim gëzimi i madh. Misioni është një pasion për Jezusin dhe

në të njëjtën kohë një pasion për popullin e tij. Kur ne qëndrojmë përpara Jezusit të kryqëzuar, shohim thellësinë e dashurisë së tij që na ngre dhe na mban, por në të njëjtën kohë, përveçse të jemi të verbër, ne fillojmë të kuptojmë se vështrimi i Jezusit, i përvëluar nga dashuria, shtrihet drejt tërë popullit të tij. Ne kuptojmë përsëri se ai dëshiron të na përdorë, në mënyrë që të afrohet më shumë te populli i tij i dashur. Ai na merr nga mesi i popullit të vet dhe na dërgon te populli i vet, me qëllim që identiteti ynë të mos kuptohet pa këtë përkatësi.

269. Jezusi vetë është modeli i kësaj zgjedhje ungjillëzuese që na sjell te zemra e popullit të tij. Sa mirë është që të sodisim afërsinë që i shfaq secilit! Nëse i flet dikujt, ai e shikon në sy me një dashuri dhe preokupim të thellë: “Atëherë Jezusi e shikoi ëmbël, i pëlqeu dhe i tha” (Mk 10,21). Ne e shohim sa i hapur është për t’u takuar me njerëzit kur i afrohet të verbrit në mes të rrugës (krh. edhe Mk 10,46-52) dhe ha e pi me mëkatarët (krh. Mk 2,16) pa u shqetësuar se do ta marrin për grykës dhe pijanec (krh. Mt 11,19). Ne shohim sa i gatshëm është kur e lejon një prostitutë që t’i vajosë këmbët

(krh. Lk 7,36-50) dhe kur pranon Nikodemin që e viziton natën (krh. Gjn 3,1-15). Flija e Jezusit në kryq nuk është asgjë tjetër sesa kulmi i mënyrës sesi e kishte jetuar gjithë jetën e tij. Të nxitur nga shembulli i tij, ne duam që të hyjmë plotësisht në fabrikën e shoqërisë, duke e ndarë jetën me të gjithë, duke dëgjuar shqetësimet e tyre, duke i ndihmuar në ndihmat materiale dhe shpirtërore, duke u gëzuar me ata që gëzohen, duke qarë me ata që qajnë, dhe përkushtohemi krah për krah me njëri-tjetrin për ndërtimin e një bote të re. Por ne e bëjmë këtë jo nisur nga një ndjenjë detyrimi, e as si detyrë të rëndë, por si rezultat i një vendimi personal që na sjell gëzim dhe i jep kuptim jetës sonë.

270. Disa herë ndjehemi të tunduar që të jemi nga ata të krishterë të cilët qëndrojnë në një farë largësie nga plagët e Zotit. Por Jezusi dëshiron që ne ta prekim mjerimin njerëzor, të prekim mishin e përvuajtur të të afërmit. Ai shpreson që të mos kërkojmë për ato vendet e ngrohta personale apo komunitare që na strehojnë nga vorbullat e fatkeqësive njerëzore, por përkundrazi të hyjmë në realitetin e jetëve të njerëzve dhe të njohim fuqinë

e butësisë. Sa herë që e bëjmë këtë, jetët tona do të ndërlikohen në mënyrë të mrekullueshme dhe do të përjetojmë përvojën intensive të të qenit popull.

271. Është e vërtetë që në marrëdhëniet tona me botën, jemi të ftuar për t'i dhënë arsyen e shpresës sonë, por jo si armiq që tregojnë me gisht dhe dënojnë. Ne na thuhet shumë qartë: “me butësi dhe me nderimin e duhur” (1 Pt 3,15) dhe “Nëse është e mundur - aq sa varet prej jush - jini në paqe me të gjithë njerëzit!” (Rom 12,18). Ne na thuhet që “Mos lejo të të mundë e keqja” (Rom 12,21) dhe “Mos të lodhemi kurrë duke bërë mirë” (Gal 6,9) dhe pa pretenduar se jemi më të mirë se të tjerët, ne duhet “ta mbajmë njëri-tjetrin më të madh se veten” (Fil 2,3). Vetë apostujt e Zotit gëzonin “i kishte fort për hir” (Vap 2,47; 4,21,33; 5,13). Është e qartë se Jezusi nuk do që të jemi si princër që i shikojnë të tjerët me përbuzje, por si burra dhe gra të popullit. Kjo nuk është një ide e Papës, ose një zgjedhje baritore ndër të tjerat por urdhër që gjendet në Fjalën e Zotit e që është aq i qartë, i drejtpërdrejtë dhe bindës, sa që nuk ka nevojë për interpretime të tilla që do ta pakësonin fuqinë për të na sfiduar. Të jetojmë “*sine glosa*”, pa komente.

Duke jetuar kështu, do të provojmë gëzimin misionar të të ndarët e jetës me popullin besnik ndaj Zotit, ndërsa përpiqemi që të ndezim zjarrin në zemrën e botës.

272. Dashuria për të afërmin është një forcë shpirtërore që na tërheq drejt bashkimit me Zotin deri aty sa, ai që nuk e do vëllanë e vet “ecën në errësirë” (1 Gjn 2,11), “mbetet në vdekje” (1 Gjn 3,14) dhe “nuk e ka njohur Hyjin” (1 Gjn 4,8). Benedikti XVI-të ka thënë se “t’i mbyllësh sytë ndaj të afërmit na bën të verbër përpara Zotit”²⁰⁹ dhe kjo dashuri është në fund të fundit e vetmja dritë që “ndriçon gjithnjë një botë të errët dhe të jep guximin për të jetuar e vepruar”²¹⁰. Kur ne jetojmë përshpirtmërinë e të afërmit tek të tjerët dhe kërkojmë të mirën e tyre, zemrat tona janë krejt të hapura ndaj dhuratave më të bukura të Zotit. Sa herë që përballemi me një person tjetër në dashuri, ne mësojmë diçka të re mbi Zotin. Sa herë që i hapim sytë për të pranuar tjetrin, ne rritemi në dritën e fesë dhe njohjen e Hyjit. Nëse duam të përparojmë në jetën shpirtërore,

²⁰⁹ Benedikti XVI, Letra enciklike, *Deus Caritas Est* (25 dhjetor 2005), 16: AAS 98 (2006), 230.

²¹⁰ *Ibid.*, 39: AAS 98 (2006), 250.

atëherë duhet të jemi misionarë të vazhdueshëm. Shërbesa e ungjillëzimit e pasuron mendjen dhe zemrën dhe hap horizonte shpirtërore dhe na bën gjithnjë e më të ndjeshëm ndaj veprimit të Shpirtit të Shenjtë dhe na shpie përtej skemave tona të kufizuara shpirtërore. Në të njëjtën kohë, një misionar tërësisht i përkushtuar ndaj shërbesës së tij provon kënaqësinë e të qenit një burim që vërshon duke freskuar të tjerët. Vetëm personi që ndjehet i lumtur në kërkimin e së mirës së tjetrit, duke dëshiruar lumturinë e tij, mund të jetë një misionar. Kjo hapje e zemrës është një burim gëzimi, meqenëse “Më i lum është ai që jep se ai që merr.” (Vap 20,35). Ne nuk jetojmë më mirë kur arratisemi, fshihemi, refuzojmë të ndajmë, nuk japim më duke u mbyllur brenda rehatisë sonë. Një jetë e tillë nuk është asgjë më pak se një vetëvrasje e ngadaltë.

273. Misioni në zemër të popullit nuk është një pjesë e jetës sime ose një zbukurim që mund ta heq, nuk është një shtojcë, apo një nga çastet e zakonshme të jetës. Por është diçka që nuk mund ta çrrënjos nga qenia ime pa e rrënuar veten. *Unë jam një mision* në këtë tokë dhe për këtë arsye gjendem

në këtë botë. Duhet ta shohim veten si të vulosur me zjarr, nga një mision i tillë që kemi marrë për të sjellë dritë, bekim, jetë, inkurajim, shërim dhe çlirim. Vetëm kështu zbulohet infermierja në shpirtin e saj, mësuesi në shpirtin e tij, politikani në shpirtin e tij dhe njerëzit që kanë vendosur në thellësi të zemrës së tyre që të jenë me e për të tjerët. Por sapo e ndajmë detyrën tonë nga jeta private, çdo gjë zbehet dhe do të kërkojmë vetëm që të na pranojnë dhe do kërkojmë të plotësohen nevojat tona. Nuk do të jemi më një popull.

274. Që të mund t'i ndajmë jetët tona me të tjerët dhe të japim veten bujarisht, ne duhet të pranojmë se çdo person është i denjë për përkushtimin tonë. Jo për shkak të pamjes së jashtme, ose aftësive, gjuhës, mënyrës së të menduarit, apo ndonjë kënaqësie që mund të marrim, por sepse njerëzit janë vepra e Zotit dhe krijesa të tia. Hyji e ka krijuar këtë person në shëmbëllimin e tij dhe ai ose ajo reflekton diçka nga lavdia e tij. Çdo qenie njerëzore është objekt i butësisë së pafund të Zotit dhe vetë Ai është i pranishëm në jetën e kësaj qenie. Jezusi e ka ofruar gjakun e tij të çmuar në kryq për çdo njeri. Pavarësisht nga pamja e

jashtme, çdo njeri është *jashtëzakonisht i shenjtë dhe meriton dashurinë*. Si pasojë, nëse mund ta ndihmoj së paku një person që të ketë një jetë më të mirë, kjo e shfajëson dhurimin e jetës sime. Është diçka e mrekullueshme që të jesh populli besnik i Hyjit. Ne e arrijmë përmbushjen kur i shembim muret dhe zemrat na mbushen me fytyra e emra!

*Veprimi misterioz i Krishtit të ngjallur
dhe i Shpirtit të Tij*

275. Në kreun e dytë, ne reflektuam mbi mungesën e përsëritshmërisë së madhe që kthehet në pesimizëm, fatalizëm dhe mosbesim. Disa njerëz nuk i kushtohen misionit sepse mendojnë se asgjë nuk do të ndryshojë dhe se nuk ia vlen barra qiranë. Ata mendojnë: “Pse duhet t'i mohoj vetes rehatinë dhe kënaqësitë nëse nuk shoh ndonjë rezultat të rëndësishëm?” Me këtë qëndrim është e pamundur të jesh misionar. Ky qëndrim është një pretekst i lig për të ndenjur në rehati, dembelizëm, në trishtim pakënaqësie dhe egoizëm të zbrazët. Është një qëndrim vetëshkatërrues, sepse “njeriu nuk mund të jetojë

pa shpresë: jeta do të bëhej e paqëllimtë dhe e padurueshme”²¹¹. Nëse mendojmë se gjërat nuk do të ndryshojnë, ne duhet të kujtojmë se Jezu Krishti ka ngadhënjyer mbi mëkatën e vdekjes dhe është tani i gjithëpushtetshëm. Jezu Krishti jeton me të vërtetë. Le ta themi ndryshe: “në qoftë se Krishti me të vërtetë nuk është ngjallur, [atëherë] i kotë është predikimi ynë” (1 Kor 15,14). Ungjilli na thotë se kur dishepujt e parë shkuan për të predikuar “Zoti bashkëpunonte me ta dhe e përforconte Fjalën” (Mk 16:20). E njëjta gjë ndodh edhe sot. Ne jemi të ftuar që ta zbulojmë e ta përjetojmë. Krishti i ringjallur dhe i përlëvduar është burimi i shpresës sonë dhe nuk do të na mungojë ndihma e tij për të kryer misionin që na ka besuar.

276. Ringjallja e tij nuk është një ngjarje e së kaluarës, por përmban një fuqi jetike që e përshkon botën. Aty ku çdo gjë duket e vdekur, nga çdo anë kthehen për t’u shfaqur papritur sythet e ringjalljes. Është një forcë që nuk ka të dytë. Është e vërtetë që shpesh duket se Hyji nuk ekziston:

²¹¹ Asambleja e dytë e posaçme për Europën e sinodit të ipeshkvijve, *Mesazhi përfundimtar*, 1: *L’Osservatore Romano*, Weekly English-language edition, 23 tetor 1999, 5.

kudo rrethohemi nga padrejtësi, ligësi, indiferecë dhe mizori. Por është e vërtetë edhe që në mes të errësirës diçka e re shfaqet dhe që shpejt a vonë do të japë fryt. Në tokat e rrafshuara rishfaqet jeta, kokëfortë dhe e pamposhtur. Sado të errëta të jenë gjërat, mirësia prapë do të rishfaqet e do të përhapet. Çdo ditë në botë bukuria rilind dhe shndërrohet përmes stuhive të historisë. Vlerat gjithnjë priren të rishfaqen në forma të reja dhe qeniet njerëzore kanë arritur të rilindin shumë herë nga situata që më parë dukeshin të pakthyeshme. Kjo është fuqia e ringjalljes dhe çdo ungjillëzues është një instrument i këtij dinamizmi.

277. Në të njëjtën kohë, vështirësi të reja dalin vazhdimisht: përvoja dështimesh dhe dobësish njerëzore që sjellin shumë dhimbje. Ne të gjithë e dimë nga përvoja se disa herë një detyrë nuk na e jep kënaqësinë që kërkojmë e rezultatet janë të pakta, ndryshimet janë të ngadalta dhe ne tundohemi që të mërzitemi. Megjithatë këto tundime që vijnë nga lodhja nuk janë njësoj me ato që vijnë nga pakënaqësia e vazhdueshme dhe nga një topitje apo apati që e than shpirtin. Ndodh gjithashtu që zemra mund të lodhet nga

betejat sepse përfundimisht kërkon vetveten në një karrierizëm të etur për pranim, duartrokitje, shpërblim dhe poste. Në këtë rast jo se dikush do të moliset por nuk do ta ketë atë vendosmëri, pasi i mungon ringjallja. Në raste të tilla, Ungjilli, që është mesazhi më i bukur në këtë botë, mbetet i varrosur nën një piriq justifikimesh.

278. Besimi nënkupton edhe të besosh te Ai dhe të besosh me të vërtetë se na do, se është i gjallë, se është në gjendje që të ndërhyjë në mënyrë të mistershme, se nuk na braktis dhe se e nxjerr të mirën prej së keqes me anë të pushtetit të vet dhe me anë të krijueshmërisë së tij të pafund. Të besosh, do të thotë se Ai përparon fitimtar në histori me “ata që mbeten me të... të grishurit, të zgjedhurit, besimtarët” (Zb 17,14). Le t’i besojmë Ungjillit kur na thotë se Mbretëria e Hyjit është e pranishme në këtë botë dhe duke u rritur aty këtu, në mënyra të ndryshme: si fara e vogël që rritet e bëhet një pemë e madhe (krh. Mt 13,31-32), si masa e tharmit që e bën brumin të mbruhet (krh. edhe Mt 13,33) dhe si fara e mirë që rritet në mes të egjërës (krh. edhe Mt 13,24-30) dhe që mund të na

befasojë këndshëm gjithmonë. Është e pranishme, kthehet përsëri dhe lufton që të rilulëzojë sërish. Ringjallja e Krishtit nxjerr kudo sythet e kësaj bote të re, të cilat edhe nëse priten dalin rishtas, sepse ringjallja e Zotit e ka depërtuar parcelën e fshehur të historisë, pasi Jezuisi nuk është ringjallur më kot. Të mos qëndrojmë të papërfshirë në këtë marshim të shpresës së gjallë!

279. Duke qenë se nuk i shohim gjithnjë këto sythe të lulëzojnë, na duhet një siguri e brendshme, një bindje se Hyji është në gjendje të veprojë në çdo situatë, edhe në mes të dështimeve të jashtme: “Por ne e mbajmë këtë visar në enë argjile” (2 Kor 4,7). Kjo siguri shpesh quhet “ndjenja e misterit”, që do të thotë të dish me siguri se të gjithë ata që ia japin veten apo i dhurohen Hyjit për dashurinë, sigurisht do të japin shumë fryte (krh. Gj 15,5). Këto fryte janë shpesh të padukshme, të pakapshme dhe të papërcaktueshme. Ne mundemi që ta dimë se jetët tona janë të frytshme, por pa pretenduar të dimë se si, se ku apo se kur. Ne mund të jemi të sigurt se asnjë nga aktet tona të dashurisë, apo aktet tona të preokupimit të sinqertë për të tjerët nuk do të humbasë. Asnjë akt i vetëm dashurie ndaj Hyjit nuk

do të humbasë, asnjë përpjekje bujare nuk është e kotë, e nuk shkon kot asnjë çast durimi i përjetuar me dhimbje. E gjitha kjo qarkullon përmes botës, si një forcë vitale. Ngandonjëherë duket sikur nuk kemi arritur asnjë rezultat nga përpjekjet tona, por misioni nuk është një marrëveshje apo një ose një plan biznesi e nuk është as ndonjë veprimtari humanitare. Nuk mund të jetë as një spektakël ku ne numërojmë sesa njerëz vijnë si rezultat i reklamave apo propagandës që kemi bërë, por është diçka më e thellë që nuk mund të matet. Ndoshta Zoti i përdor sakrificat tona për të derdhur bekime në ndonjë pjesë tjetër të botës të cilën ne mund të mos ta vizitojmë kurrë. Shpirti i Shenjtë vepron sipas dëshirës, kur dhe ku dëshiron dhe ne përkushtohemi pa pretenduar që të shohim rezultate të jashtëzakonshme. Dimë vetëm se të dhuruarit e vetes sonë është i nevojshëm. Le të mësojmë që të qëndrojmë në butësinë e krahëve të Atit në mes të përkushtimit tonë krijues dhe të përzemërt. Le të ecim përpara, duke i dhënë gjithçka, duke e lënë atë që t'i bëjë të frytshme përpjekjet tona ashtu siç i duket më mirë Atij.

280. Për ta mbajtur gjallë zellin misionar duhet një besim i patundur te Shpirti Shenjtë, sepse “Shpirti Shenjt na ndihmon në paaftësinë tonë” (Rom 8,26). Por ky besim i gjallë duhet të ushqehet, prandaj ne duhet ta kërkojmë vazhdimisht Shpirtin Shenjtë. Ai mund të na shërojë nga e tëra kjo që na dobëson në impenjimin misionar. Është e vërtetë që ky besim te e padukshmja mund të na shkaktojë një farë marramendje: është sikurse të jemi zhytur thellë në një det ku nuk dimë se çfarë do të gjejmë. Unë vetë e kam provuar shumë herë. Megjithatë nuk ka liri më të madhe sesa ajo e të lejuarit që të udhëhiqemi nga Shpirti Shenjtë, duke hequr dorë nga orvatjet për të planifikuar dhe kontrolluar deri në detajet më të imta dhe duke e lënë që Ai të na ndriçojë, të na udhëheqë dhe orientojë sipas vullnetit të Tij. Shpirti Shenjtë e di mirë se çfarë nevojitet në çdo çast dhe në çdo epokë. Kjo do të thotë të jesh i frytshëm në mënyrë të mistershme!

Fuqia misionare e ndërmjetësimit

281. Është një formë lutje që na shtyn veçanërisht të përkushtohemi në ungjillëzimin dhe që na

motivon për të kërkuar të mirën e të tjerëve: është ndërmjetësimi. Vëzhgojmë për një çast aspektin e brendshëm të një ungjillëzuesi të madh si Shën Pali, për të parë nga afër sesi ishte lutja e tij. Ajo ishte plot me njerëz: "...Gjithherë e në çdo lutje që bëj, lutem me gëzim për ju të gjithë... unë ju mbaj në zemrën time" (Fil 1,4,7). Këtu shohim që ndërmjetësimi nuk na shkëput nga adhurimi i vërtetë, meqenëse adhurimi që i lë jashtë të tjerët është një gënjeshtëri.

282. Ky qëndrim bëhet një lutje mirënjohjeje ndaj Zotit për të tjerët: "Më së pari e falënderoj Hyjin tim me anë të Jezus Krishtit për të gjithë ju" (Rom 1,8). Bëhet fjalë për një falënderim të vazhdueshëm: "Përherë i falem nderit Hyjit tim për ju që ju dha hirin hyjnor me anë të Krishtit Jezus" (1 Kor 1,4); "Gjithmonë, sa herë më bie ndër mend për ju, falënderoj Hyjin tim" (Fil 1,3). Nuk është një vështrim dyshues, negativ dhe dëshpërues, por një vështrim që lind nga besimi i thellë që e pranon se çfarë është duke bërë Zoti në jetën e të tjerëve. Në të njëjtën kohë, është mirënjohja që rrjedh nga një zemër e vëmendshme ndaj të tjerëve. Kur ungjillëzuesit ngrihen nga lutja, zemrat e tyre janë më të hapura; të lirë nga vetëfokusimi, ata kanë

dëshirë që të bëjnë të mirën dhe të ndajnë jetën e tyre me të tjerët.

283. Burrat dhe gratë e shquara të Hyjit kanë qenë ndërmjetësues të mëdhenj. Ndërmjetësimi është si një "tharm" në zemrën e Trinisë. Është një mënyrë e të depërtuarit në zemrën e Atit dhe të zbuluarit e dimensioneve të reja që mund të derdhin dritë mbi situata konkrete dhe t'i ndryshojnë ato. Mund të themi se zemra e Hyjit preket nga ndërmjetësimi, por në realitet Ai gjithmonë na pret, dhe ajo që mund të bëjmë me ndërmjetësimin tonë është që pushteti, dashuria e besnikëria e tij të manifestohen më qartësi më të madhe në popull.

II. MARIA, NËNA E UNGJILLËZIMIT

284. Me Shpirtin e Shenjtë, Maria është gjithnjë e pranishme në mes të popullit. Ajo i mblidhte dishepujt në lutje për ardhjen e Shpirtit Shenjtë (Vap 1,14) duke mundësuar kështu vërshimin misionar që ndodhi ditën e Rrëshajave. Ajo është Nëna e Kishës që ungjillëzon dhe pa të, ne nuk do ta kuptonim si duhet shpirtin e ungjillëzimit të ri.

285. Në kryq, kur Jezusi vuante në mishin e vet përballjen dramatike të mëkatit të botës me mëshirën e Hyjit, mundi ta ndjente në këmbët e tij praninë ngushëlluese të Nënës dhe të shokut. Në atë çast kritik, para se të përmbushte plotësisht veprën që i kishte besuar Ati, Jezusi i tha Marisë: “Grua, ja, yt bir!” Pastaj i tha nxënësit: “Ja, nëna jote!” (Gjn 19,26-27). Këto fjalë të Jezusit që po jepte shpirt nuk janë kryesisht shprehje të përkushtimit dhe preokupimit ndaj nënës së tij, por janë një formulë zbuluese që shfaq misterin e një misioni të veçantë shëlbues. Jezusi na ka lënë nënën e tij për të qenë nëna jonë. Vetëm pasi e bëri këtë, Jezusi e ndjeu “Gjithçka u krye!” (Gjn 19,28). Në këmbët e kryqit, në orën supreme të krijimit të ri, Krishti na shpuri te Maria. Na drejton për tek ajo sepse nuk donte që ne të ecnim në rrugëtimin tonë pa një nënë dhe populli lexoi në këtë imazh amnor të gjitha misteret e Ungjillit. Zoti nuk dëshironte ta linte Kishën pa këtë ikonë të femrës. Maria, që e solli atë në botë me besim të madh, shoqëron gjithashtu edhe “pjesën tjetër të pasardhjes së saj, ... ata që që mbajnë urdhërimet e Hyjit dhe e ruajnë

dëshminë e Jezusit” (Zb 12,17). Lidhja e ngushtë midis Marisë, Kishës dhe secilit prej besimtarëve, bazuar në faktin se secili në mënyrën e vet lind Krishtin, është shprehur bukur nga i lumi Isaku i Stelës: “Në Shkrimet e hyjnisht të frymëzuara, çfarë kuptohet në përgjithësi nga Kisha, për Virgjër e Nënë, kuptohet veçanërisht Virgjëra Mari [...] Në mënyrë të barabartë mund të thuhet se çdo shpirt besimtar është nusja e Fjalës së Zotit, nënë e Krishtit, bijë dhe motër, virgjër dhe nënë e frytshme [...] Krishti qëndroi për nëntë muaj në barkun e Marisë dhe do të mbetet deri në fund të shekujve në tabernakullin e fesë së Kishës; e në njohjen dhe dashurinë e shpirtit besnik, në shekuj të shekujve”²¹².

286. Maria është ajo që diti të shndërrojë një stallë për kafshët në një shtëpi për Jezusin, me pelena të rreckosura dhe me një dashuri të pakufishme. Ajo është shërbëtorja e vogël e Atit që dridhet nga gëzimi në lavde. Është ajo, e cila shqetësohet që vera të mos mungojë në jetët tona. Është ajo që e ka zemrën të shpuar nga shpata, që i kupton të gjitha dhimbjet tona. Si nëna e të gjithëve, ajo është një shenjë shprese për ata që vuajnë dhimbjet e lindjes

²¹² Isaku i Stelës, Sermo 51: PL 194, 1863, 1865.

derisa të lindë drejtësia. Ajo është misionaria që na afrohet dhe na shoqëron përgjatë jetës, duke na hapur zemrat ndaj fesë me anë të dashurisë së saj prej nëne. Si një nënë e vërtetë, ajo ecën përkrah nesh, merr pjesë në betejat tona dhe na rrethon vazhdimisht me dashurinë e Hyjit. Përmes titujve të saj të shumtë, të cilët janë shpesh të lidhura me shenjtëroret e saj, Maria ndan historinë e çdo populli që ka pranuar Ungjillin dhe bëhet pjesë e identitetit të tyre historik. Shumë prindër të krishterë kërkojnë që fëmijët e tyre të pagëzohen në një shenjtërore mariale, si shenjë të besimit të tyre në mëmësinë e saj që lind fëmijë të rinj për Hyjin. Atje në këto shenjtërore, mund të shohim sesi Maria i mbledh rreth vetes fëmijët e saj të cilët me mundime vijnë si shtegtarë për ta shikuar atë dhe që të shihen prej saj. Aty ata gjejnë forcë të Zoti për të duruar lodhjen dhe vuajtjet në jetën e tyre. Ashtu si në Juan Diegon, Maria u jep ngushëllim dhe dashuri amnore, duke iu pëshpëritur në vesh: “Mos e lini zemrën t’ju trazohet...A nuk jam unë me ju, që jam Nëna juaj?”²¹³.

²¹³ *Nican Mopohua*, 118-119.

Ylli i Ungjillëzimit të ri

287. I kërkojmë Nënës së Ungjillit të gjallë që të ndërmjetësojë në mënyrë që kjo ftesë për një fazë të re ungjillëzimi të pranohet nga e tërë bashkësia e kishës. Maria është grua e besimit që jeton e përparon në fe²¹⁴ dhe “shtegtimi i saj i jashtëzakonshëm në besim simbolizon një pikë të vazhdueshme referimi për Kishën”²¹⁵. Maria e lë veten të udhëhiqet nga Shpirti Shenjtë, përmes rrugëtimit të fesë, drejt fatit të shërbesës dhe lindshmërisë. Sot ne e hedhim vështrimin te ajo që të na ndihmojë për t’u shpallur të gjithëve mesazhin e shëlbimit dhe që dishepujt e rinj të bëhen ungjillëzues veprues²¹⁶. Në këtë rrugëtim ungjillëzues nuk do të na mungojnë edhe çastet e thatësirës, errësirës dhe madje rraskapitjes, si ajo që ka përjetuar Maria në vitet e Nazaretit, ndërsa Jezusi rritej: “Është ky fillimi i Ungjillit, i lajmit të mirë e të gëzueshëm. Megjithatë, nuk është e vështirë të shohësh në atë fillim një lodhje

²¹⁴ Shih Konc. II Ekum. i Vat.Kushtetuta Dogmatike mbi Kishën *Lumen Gentium*, 52-69.

²¹⁵ Gjon Pali II, Letra Enciklike *Redemptoris Mater* (25 mars 1987), 6: AAS 79 (1987), 366-367.

²¹⁶ Shih *Propositio* 58.

të veçantë të zemrës, të bashkuar me një shans të “natës së besimit”, nëse mund të shprehemi me fjalët Shën Gjonit të Kryqit, një lloj ‘veli’ përmes të cilit mund t’i afrohem të Padukshmit dhe të jetojmë në intimitet me misterin. Dhe në fakt, kjo është mënyra sesi ka jetuar për shumë vite Maria, në intimitet me misterin e Birit të saj, por edhe ka përparuar në itenerarin e fesë”²¹⁷.

288. Ekziston një stil marial në shërbesën e ungjillëzimit të Kishës. Sa herë që shikojmë te Maria, ne besojmë përsëri në natyrën revolucionare të dashurisë dhe butësisë. Në të shohim se përlulja dhe butësia nuk janë virtyte të të dobët por të të fortit që nuk ka pse t’i trajtojë të tjerët keq me qëllim që të ndjehet vetë i rëndësishëm. Duke soditur Marinë, ne kuptojmë se ajo që e lavdëronte Hyjin sepse “i rrëzoi princat prej froneve të tyre” dhe “të pasurit i nisi duarthatë” (Lk 1,52-53) është po ashtu, po ajo që “i shoshiste në zemrën e vet” (Lk 2,19). Maria është në gjendje që të dallojë gjurmët e Shpirtit të Hyjit në ngjarje të mëdha e të vogla që duken të paperceptueshme. Ajo sodit vazhdimisht

²¹⁷ Gjon Pali II, Letër enciklike *Redemptoris Mater* (25 mars 1987), 17: AAS 79 (1987), 381.

misterin e Hyjit në botën tonë, historinë njerëzore dhe në jetët tona të përditshme. Ajo është një grua nazarenase punëtore dhe e devotshme në lutje dhe është gjithashtu Zoja Ndhimëtare, që nisat nga qyteza e saj “me të shpejtë” (Lk 1,39) për t’u vënë në shërbim të tjerëve. Ky bashkëveprim drejtësie dhe butësie, soditjeje dhe preokupimi për të tjerët, është çfarë e bën bashkësinë kishtarë që ta shikojë Marinë si model ungjillëzimi për kishën. I kërkojmë ndërmjetësimin amnor me qëllim që Kisha të bëhet shtëpi për shumë njerëz, nënë për të gjithë popujt dhe të bëjë të mundur lindjen e një bote të re. Është I Ringjalluri i cili na thotë me një fuqi që na mbush me shpresa të patundur: “Ja, unë i bëj të reja të gjitha gjërat!” (Zb 21,5). Me Marinë ne përparojmë me besim të plotë drejt përmbushjes së këtij premtimi dhe asaj i lutemi:

*Virgjër e Nënë Mari,
ti që e shtyrë nga Shpirti Shenjtë,
mirëprite Fjalën e jetës
në thellësitë e fesë tënde të përlulur:
krejtësisht që i je dhënë Amshimit,
ndihmona të themi “po”-në tonë,
në thirrjen tepër të ngutshme,
bëj që të jehojë Lajmi i Mirë i Jezusit.*

Ti, e mbushur me praninë e Krishtit,
i solle gëzimin Gjon Pagëzorit,
Duke bërë që të ngazëllehej në barkun e nënës së tij.
Ti, plot hare,
këndove mrekullitë e Zotit.
Ti që qëndrove e patundur para Kryqit
me një fe të palëkundshme,
e me të marrë ngushëllimin e hareshëm të ringjalljes,
mblodhe dishepujt në pritjen e Shpirtit
që të lindte Kisha ungjillëzuese.

Përfto tani një vrull të ri të ringjallurish,
për ta çuar tek të gjithë Ungjillin e jetës
që ngadhënjën mbi vdekjen.
Jepna guximin e shenjtë për të kërkuar shtigje të reja,
që të arrijë tek të gjithë
dhurata e bukurisë së pavenitur.

Ti, Virgjër e dëgjimit dhe e adhurimit,
nëna e dashurisë, nuse e dasmës së amshueshme,
ndërmjetëso për Kishën, ikonë e papërlyer e së cilës je,
që kurrë të mos mbyllet e kurrë të mos ndalet
në pasionin për të vendosur Mbretërinë

Ylli i ungjillëzimit të ri,
ndihmona që të shkëlqejmë në dëshminë e bashkimit,

të shërbesës, të fesë së zjarrtë e të përzemërt,
të drejtësisë e të dashurisë për të varfërit,
që gëzimi i Ungjillit
të arrijë deri në skajet e botës
e asnjë periferi të mos privohet nga drita e saj.

Nëna e Ungjillit të gjallë,
Burim lumturie për të vegjlit,
lutu për ne.

Amen. Aleluja.

Mbajtur në Romë, në sheshin e Shën Pjetrit,
në përmylljen e Vitit të Fesë, më 24 nëntor, në
solemnitetin e “Zotit tonë Jezu Krisht Mbret të
Gjithësisë”, në vitin 2013 para Pontifikatit tim.

Franciscus

PËRMBAJTJA

GËZIMI I UNGJILLIT	7
I. NJË GËZIM PËRHERË I RI, NJË GËZIM QË NDAHET.	7
II. GËZIMI I ËMBËL E LEHTËSUES I UNGJILLËZIMIT.	14
<i>Një risi e përjetshme.</i>	16
III. UNGJILLËZIMI I RI PËR PËRCJELLJEN E FESË.	19
<i>Pikësnyimi dhe kufizimet e kësaj nxitjeje.</i>	23

KREU I

SHNDËRRIMI MISIONAR I KISHËS

I. NJË KISHË QË DEL NËPËR BOTË.	25
<i>Të marrësh iniciativën, të përfshihehesh, të jesh përkrahës, të japësh frytë dhe të gëzohesh</i>	28
II. VEPRIMTARIA BARITORE DHE KTHIMI	30
<i>Një ripërtëritje kishtare që nuk mund të shtyhet</i>	32
III. NGA ZEMRA E UNGJILLIT.	39
IV. NJË MISION I MISHËRUAR BRENDË KUFIJVE NJERËZORË	43
V. NJË NËNË ME NJË ZEMËR TË HAPUR	49

KREU II

NË MES TË KRIZËS

SË PËRKUSHTIMIT KOMUNITAR

I. DISA SFIDA TË BOTËS SË SOTME	53
<i>Jo një ekonomie përjashtimi</i>	55

<i>Jo ndaj kësaj idhujtarie të re të parasë.</i>	56
<i>Jo, ndaj një sistemi financiar që më shumë sundon sesa shërben.</i>	60
<i>Jo pabarazisë që pjell dhunë.</i>	61
<i>Disa sfida kulturore.</i>	64
<i>Sfida ndaj kulturimit të besimit.</i>	71
<i>Sfida nga kultura urbane.</i>	74
II. TUNDIME TË VEPRIMTARËVE BARITORË	78
<i>Po ndaj sfidës së një spiritualiteti misionar</i>	80
<i>Jo ndaj egoizmit dhe dembelizmit shpirtëror</i>	82
<i>Jo ndaj një pesimizmi steril</i>	85
<i>Po ndaj marrëdhënieve të reja që sjell Krishti</i>	89
<i>Jo ndaj mondanitetit shpirtëror</i>	95
<i>Jo ndaj luftës në mes nesh</i>	100
<i>Sfida të tjera kishtarë</i>	103

KREU III

SHPALLJA E UNGJILLIT

I. E TËRË BASHKËSIA E HYJIT SHPALL UNGJILLIN.	111
<i>Një bashkësi për secilin.</i>	112
<i>Një bashkësi me persona nga më të ndryshëm.</i>	115
<i>Ne jemi të gjithë dishepuj misionarë.</i>	120
<i>Fuqia ungjillëzuese e besimit popullor.</i>	123
<i>Dialog personal.</i>	128
<i>Karizma në shërbim të një bashkësie që ungjillëzon.</i>	130
<i>Kultura, idetë dhe formimi.</i>	132

II. HOMELIA.	134
<i>Konteksti liturgjik</i>	136
<i>Biseda e një nëne</i>	137
<i>Fjalë që ndezin zemrat zjarr</i>	140
III. PËRGATITJE PËR PREDIKIM	143
<i>Kulti i së vërtetës</i>	144
<i>Personalizimi i fjalës</i>	147
<i>Leximi shpirtëror</i>	151
<i>Të dëgjosh njerëzit</i>	153
<i>Mjete pedagogjike</i>	155
IV. UNGJILLËZIM NËPRMJET THELLIMIT TË KERIGMËS	157
<i>Katekizmat kerigmatike dhe mistagogjike.</i>	167
<i>Shoqërim personal në proceset e rritjes.</i>	166
<i>Rreth Fjalës së Hyjit.</i>	171

KREU IV

PËRMASA SHOQËRORE E UNGJILLËZIMIT

I. NDIKIMET E PËRGJITHSHME

DHE ATO SHOQËRORE TË KERIGMËS.	172
<i>Rrëfimi i fesë e zotimi shoqëror.</i>	174
<i>Mbretëria dhe sfidat e saj.</i>	177
<i>Mësimi i Kishës mbi çështjet shoqërore.</i>	179
II. PËRFSHIRJA E TË VARFËRVE NË SHOQËRI.	183
<i>Në bashkim me Hyjin, ne dëgjojmë një thirrje</i>	184
<i>Besnikëri ndaj Ungjillit që të mos rendim më kot</i>	190
<i>Vendi i veçantë i të varfërve në mes të popullit të Zotit.</i> . 194	

<i>Ekonomia dhe shpërndarja e të ardhurave</i>	199
<i>Shqetësimi për të dobtët</i>	204
III. E MIRA E PËRBASHKËT DHE PAQJA NË SHOQËRI	210
<i>Koha është më e madhe sesa hapësira</i>	213
<i>Uniteti mbizotëron ndaj konfliktit</i>	216
<i>Realitetet janë më të rëndësishme sesa idetë</i>	219
<i>E tëra është më e madhe se pjesa e veçantë</i>	222
IV. DIALOGU SHOQËROR SI KONTRIBUT NDAJ PAQES	225
<i>Dialogu midis fesë, arsyes dhe shkencës</i>	227
<i>Dialogu ekumenik</i>	229
<i>Marrëdhëniet me judaizmin</i>	232
<i>Dialogu ndërjetar</i>	234
<i>Dialogu shoqëror në kontekstin e lirisë fetare</i>	239

KREU V

UNGJILLËZUES ME SHPIRTIN E SHENJTË

I. ARSYET PËR NJË IMPULS TË PËRTËRIRË MISIONAR	243
<i>Takimi personal me dashurinë shëlbuese të Jezusit</i>	245
<i>Aroma shpirtërore e të qenit një popull</i>	252
<i>Veprimi misterioz i Krishtit të ngjallur</i> <i>dhe i Shpirtit të Tij</i>	259
<i>Fuqia misionare e ndërmjetësimit</i>	265
II. MARIA, NËNA E UNGJILLËZIMIT	267
<i>Dhurata e Jezusit ndaj popullit të tij</i>	268
<i>Ylli i Ungjillëzimit të ri</i>	271

